

BIBLIOTEKA

854-32

2 92



Dritat  
nuk u shuan

PETRAQ ZOTO

8-JH-32  
791

PETRAQ ZOTO

# DRITAT NUK U SHUAN

— TREGIME —

3535

~~43084~~

SHKURTËRA E SHËTËTË  
D. 1977-1814

SHËTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»



## DRITAT NUK U SHUAN

Miçua ish shtrirë në krevat dhe po dëgjonte radion. Ish kredhur në një dëgjim të këndshëm si një njeri i kënaqur nga jeta, të cilit punët i shkojnë mbarë. Edhe pjesëtarët e tjerë të familjes dëgjonin në heshtje, sikur të mos deshnin ta prishnin qetësinë e kënaqësisë që ndjente ai. Edhe ata dukeshin të kënaqur. Llamba elektrike zbardhte dhomën. Në një dritë të tillë të bardhë e të fortë njerëzit duken të çelur, plot shëndet e të bukur.

Miçua qe çentralisti i fshatit. Kur dritat elektrike ishin të mira, ai ndodhej në një gjendje gëzimi e kënaqësie të plotë. Atëhere kish qejf të bisedonte me zjarr ose të rrinte shtrirë e të dëgjonte radion, siç po bënte në këtë mbrëmje vjeshte.

Dy vjet më parë ish bërë çentralist. Kjo kish ndodhur fare papritur. Një mbrëmje, si zakonisht, disa burra po bisedonin në sallën e leximit. Atje ish edhe Thomi, çentralisti i parë, edhe Miçua. Ish fillimi i tetorit.

— Kur dó të na i lëshosh dritat, o Thomi?

— Tashti vaditjet mbaruan, — tha njeri. Në verë, kur kooperativistët vaditnin ditë e natë, çentrali i fshatit nuk punonte nja dy muaj.

— Zor të kemi drita sivjet, — tha Thomi. —

Dinamoja u vjetërua, s'bën më. Ajo mund të digjet nga nata në natë.

Dikush i tha mënjanë Miços: Më duket se e ka hallin gjetkë ky, kërkon t'ja shtojnë ditët e punës për çentralin.

Njeri e tha hapur këtë mendim:

— Po të të japin tridhjetë ditëpune s'besoj të ketë rrezik që të digjet dinamoja!

Thomi u nxeh. Muhabeti u ndez.

Nga tërë ajo bisedë e ngatërruar Miçua kup-toi se Thomi vërtetë e kish hallin te ditët e punës, po edhe frikë kish nga dinamoja e vjetër.

Hë për hë dinamoja e vjetër nuk mund të zëvendësohej me një tjetër. Pra, fshati do të mbetej pa dritë elektrike. Dhe kjo sikur nuk e shqetësonte fare Thomin, çentralistin e vjetër.

Miçua e shikoi me inat. Si rrinte aq i qetë e mospërfillës kur ish fjala për dritën elektrike të një fshati të tërë?

— Dinamoja e vjetër mund të vejë edhe mjaft kohë, — tha ai. — Fundja, sa të vejë!

Thomi i hodhi një vështrim përçmues.

— Me fjalë, të tërë trima bëhi ju! Kur është kaq lehtë, merre dhe të shohim ç'mund të bësh ti me të! — i tha atij.

— Pse, do të më trembësh, thua? E marr dhe të shohësh!

— Posi, posi! Këput fiq e ha! Ja, kështu të duket ty.

Miçua nuk desh ta shpinte më tej këtë bisedë të kotë.

— Fshati s'ka drita dhe fajin e ke ti, — i tha prerë Ndinit.

Këtij i erdhi rëndë dhe, aty për aty, e gjeti



kryetarin dhe i tha se nuk do ta mbante më detyrën që kish.

Dy ditë më pas këtë detyrë e mori Miçua. Atij, si çdo të riu tjetër, i pëlqente që fshati të kish dritë elektrike. Nga kjo ish nisur kur kish marrë pjesë në atë bisedën e sallës së leximit. Po, kur i thanë të bëhej centralist, ai ish stepur i hutuar. Ai kish punuar ca pas jazit e për rregullimin e linjës së korentit brenda në fshat. E dinte edhe ç'veprime bënte çdo mbrëmje Thomi për të lëshuar dritat. Po a ish mjaft me kaq? Në fillim ai qe trembur, pastaj kish thënë me vete: «E ç'janë ata që e bëjnë këtë punë? Njerëz të veçantë? Jo! Nëqoftëse s'di sa duhet, do të mësoj!» Dhe kish pranuar. Miçua kërkoi që Thomi t'i jepte ndonjë udhëzim, po ky, që dukej qartë se ish shumë i prekur ngaqë s'ja kishin kundërshtuar kërkesën, i tha me shpoti:

— Ai që hyn në valle, di edhe ta heqë! — dhe kish ikur i krekosur, i bindur se Miçua nuk do ta bënte dot e do t'i luteshin prapë atij.

Kur mbeti vetëm në ndërtesën e ftohtë të hidrocentralit të fshatit, Miços iu duk sikur s'dinte asgjë e sikur kish hyrë atje për të parën herë. Shikonte më frikë herë dinamon, herë rripin e transmisionit, herë maskat e lidhjeve dhe truri sikur s'i punonte fare. Pastaj menjëherë e mblodhi veten. E hapi kapakun dhe i dha një shtytje me dorë pendës së hekurt. Ajo u vërtit dhe vuri në lëvizje edhe rripin e gjerë. Pas pak ai doli me lopatën në krah. Vajti tek rema<sup>1)</sup> dhe i

---

1) Remë = digë e thjeshtë, bërë me gardh në vend të gurëve.

zuri tërë vrimat gjersa u bind se poshtë nuk rridhte asnjë pikë uji. Pastaj shkoi pas jazit bashkë me ujin duke i zënë vrimat e gërryera aty këtu.

Tërë uji që rridhte në atë grykë mali, i pakësuar nga vera e nxehtë, u grumbullua në kadet e hidroçentralit të fshatit.

Miçua priste me ankth. Zemra i rrihte si çekan. A do të jepte dritë? A do të punonte dinamaja? Miçua i mbante sytë te llamba elektrike. Ja, fija e hollë brenda saj u skuq. Pastaj u shua menjëherë, u ndez përsëri, këtë radhë me më shumë dritë, dhe prap u shua. Kjo gjë vazhdoi një copë herë.

Tubat e hekurta ishin mbushur. Më tej uji s'ngjitej, sepse aq ish. Po drita pse nuk ishte e qendrueshme?

Miçon e mbuluan djersët. Përfytyronte se si tallej Thomi në ato çaste dhe skuqej e i vinte turp prej vetes. Ç'të bënte? Ai e shikoi edhe njëherë mashën e lidhjes së linjës. Ajo kish vajtur deri në fund. Rripi punonte normalisht. Pra, fajin e kish dinamaja. Po sikur të digjej, siç kish thënë Thomi? E si mund të digjej? Mos që prej druri? Kjo frikë s'ish me vend Po ç'kish ajo, ç'kish? Çfarë s'punonte mirë brenda saj? Iu afrua, u ul më bisht dhe po e vështronte me kujdes. Duke e vërejtur e kontrolluar me kujdes, befas e diktoi difektin. Kolektori ish holluar mjaft e karbonçinat, edhe ato të konsumuara, herë takonin e herë jo. Midis kolektorit e trupit të hekurit të dinamos kish një boshllëk të vogël. Aty, në të dy anët, kishin mbe-tur pas metalit lëvozhga druri. Dukej që aty ish shtrënguar fort një copë druri. Pse vallë? Ç'mund të bënte një copë druri në atë vend? Duke e shikuar,



ai e kuptoi se druri e shtrëngonte kolektorin dhe ky takohej mirë me karbonçinat.

Këtë «sekret» paskej ditur Thomi! Mbas kësaj kleçke ish kapur ai, që kujtonte se ish i pazëvendësueshëm!

Miçua ndjeu neveri për të. Më pas kurrë nuk mendoi më për atë njeri, me të cilin e ndante një hendek i thellë e i gjerë.

Ai mori një pykë dhe e shtrëngoi paq në të ndarën midis kolektorit e trupit të dinamos. Kontakti u bë i qendrueshëm. Drita u shtua edhe ca. Ai e mbylli derën me kyç dhe shkoi në shtëpi. Mirëpo nuk e zinte gjumi. Sa mbyllte sytë, i kujtohej që i kish hyrë një pune të madhe dhe dyshimi se vallë ja delte mbanë, ja largonte gjumin. Hidhte tej jorganin, vishej e shkonte prapë në hidrocentral. Shikonte me vëmendje të madhe, kontrollonte punën e çdo detali, u hynte të fshehtave të prodhimit të korentit.

Hidrocentrali jepte aq dritë, sa edhe kur e kish Thomi. Vështirësitë e para i kish kapërcyer. Thomi që më parë e tallte nëpër fshat, tani s'fliste më e askush s'ja vinte veshin. Mirëpo a duhej të kënaqej me kaq centralisti i ri? Thomin e gjykonte si njeri të një bote tjetër, të perënduar. E pra, edhe rezultati i punës së tij le t'i mbetej së kaluarës.

Miçua kish vajtur disa herë në centralin e fshatit fqinjë dhe centralisti i atij fshati i kish mësuar plot gjëra. Kish qejf të dinte sa më tepër për zanatin e tij dhe pyeste e interesohej ku t'i qëllonte. Tani dinte aq sa duhet të dijë një centralist fshati. Po ai s'kënaqej me atë që kish arrihur. Drita elektrike nuk ishte më e mirë se ajo

e llambave me vajguri. Radiot mezi merrnin vetëm mbas orës nëndë të mbrëmjes.

A të priste edhe ai sa të merrnin dinamo të re? Apo sa të shtohet uji prej shirave? E ç'i mbe-tej centralistit pastaj? Të lëshonte e të zinte ujin?

Ai s'e gjykonte kaq të thjeshtë detyrën e tij.

Një ditë, duke shikuar ujin që delte poshtë, ai mendoi: «Po sikur ta ngushtoj ca cifunin?» Dhe u muarr një copë herë me këtë mendim. Do të delte më pak ujë, po më me presion, se do të mbusheshin edhe kadet e gjera që qendronin si rezervuarë mbi tubat e hekurta. Veç kësaj, po të kish më pak ngarkesë, dinamoja do t'i plotësonte xhirot e do të jepte korentin maksimal. Ngarkesa rregullohej. Çdo shtëpi t'i kish llambat me çelës dhe të mos mbaheshin kot hapur të gjitha.

Cifunin e bëri vetë që të nesërmen, se i vinte doresh edhe për punë marangozësh. Që atë natë e provoi. Pastaj vajti shtëpi më shtëpi dhe u tha t'i mbyllnin llambat e tepërta.

Kur u kthye në shtëpi, dhoma zbardhte nga drita elektrike.

— Tashti po, — i tha e gëzuar e ëma, — kësaj i thonë dritë!

Atij iu bë qejfi. Hodhi sytë përballë dhe pa në pasqyrën e madhe të garderobës një djalë flokëverdhe, me fytyrë të shëndetshme e sy plot gjallëri. Vetiu nxori nga xhepi krehrin dhe ua shkoi flokëve të ngatërruar, që e prishnin bukurinë e fytyrës së tij. Kurrë ndonjëherë, as edhe ditën, nuk e kish parë veten aq qartë në pasqyrë! U gëzua si fëmijë. Pastaj hapi radion dhe u shtri në krevat. Ish i lodhur, por i kënaqur si asnjëherë tjetër.



...Ndërsa po dëgjonte radion shtrirë në krevat, bardhësia në dhomë u zbeh, zëri i radios u ul. Ai brofi në këmbë dhe shikoi llambën elektrike: drita e saj po vinte duke u ulur. Dhoma u kredh në gjysmë errësirë. Drita u ul shumë, po nuk u shua fare. Miçua u vesh me nxitim, mori fenerin dhe doli.

Jashtë binte shi. Ish një shi vjeshte, i ngadalshëm, po i njëjlojtë kudo. Rrugët ishin plot ujra. Një shi i tillë, monoton, «shiu i budallait», siç i thonë në fshat, hyn thellë në tokë dhe pastaj, kur ajo ngopet, ujët rrjedh në të gjitha anët e përrrenjtë fryhen e vërviten tatëpjetë me furi.

Miçua shkelte nëpër ujra. Kish mbathur çizmet e s'kish pse të ruhej. Veç kësaj, nxitonte. Errësira qe e madhe. Feneri mezi mundte të largojë dy — tri metra prej saj. Pikat e shiut, që binin brenda këtyre dy-tri metrave, ishin të ndritshme, si prej argjendi.

«Do të ketë zbritur Përroi i Vogël dhe do ta ketë mbushur jazin me rërë» tha me vete Miçua ndërsa nxitonte, por mund të kish ndodhur ndonjë gjë tjetër, ndonjë e papritur tjetër e rrezikshme. Kur u afrua te hidrocentrali, dëgjoi ujin që bënte një zhurmë të llahtarshme duke rënë nëpër kadet, dhe e kuptoi se ato qenë përgjysmë. U ngjit te korita dhe pa se jazi sillte fare pak ujë të turbullt.

«Prandaj u ulën dritat. Ai djall përrua e ka fajin!» — tha Miçua dhe sikur u shkarkua nga një barrë e rëndë. Vërtet ish natë e binte shi, po kjo s'qe ndonjë punë e madhe: brenda një ore ai mund ta pastronte rërën me të cilën e kish mbushur jazin Përroi i Vogël. Dhe përroi në fillim

sjell gurë e rërë, pastaj rëra sikur mbarohet, kësh-tu që s'kish rrezik të mbushej prapë.

Miçua mori lopatën e kazmën në hidrocentral dhe vazhdoi të ecë pas kanalit të ujit. Nuk mendonte më asgjë.

Me të tilla gjëra ai ish mësuar. Ja, pas një ore do të kthehej duke sjellë ujë me bollëk. Dhe dritat përsëri do të forcoheshin.

Ai u ndal te e përpjeta e malit, atje ku delte Përroi i Vogël. Vërtet përroi e kish mbushur jazin me rërë. Këtë radhë nga ana e hidrocentralit ai kish rrukullisur ca gurë të mëdhenj. Pas tyre ish ngjeshur rëra dhe masa e ujit zbriste poshtë, nëpër rrugë, ndërsa në kanal rridhte pak, sa për të mbajtur me shpirt hidrocentralin.

Miçua e vendosi fenerin në një vend të lartë dhe iu përvesh punës. I hoqi gurët dhe një pjesë të rërës. Thuajse tërë uji rrodhi tatëpjetë jazit. Po atëhere vuri re se më lart jazi ish i thatë. Uji vinte vetëm prej përroit.

«Do të jetë këputur në ndonjë vend», tha dhe nxitoi për lart, mbasi e dinte se, çdo minutë, uji gërryente një sasi të madhe dheu e pastaj nuk do ta zinte dot vendin e këputur.

Nxitonte këtë radhë duke shkuar brenda në kanal, sepse kishte frikë mos shkiste dhe i druhej vithimës, që shpinte në Përroin e Madh, i cili buçiste për llahtarë.

«Tek ara e Lonit vendi nuk qe forcuar mirë, — tha me vete: — Atje do të jetë këputur, — dhe vriste mendjen për të kujtuar në kish gurë e plisa aty, që ta zinte sa më shpejt.

Kur vajti te ara e Lonit, pa se jazi s'kish pë-



suar gjë. Edhe aty ai kish më pak ujë të ndenjtur, që trazohej prej pikave të shiut.

«Ku mund të jetë këputur atëhere? Ndoshta tek kthesa. Dhe ai nxitoi për te kthesa. Kur pa se edhe atje kanali ish pa ujë, si koritë boshe, u kujtua:

«Ah, ta marrë djalli! Është këputur rema! Po që kur vallë?»

Kur mendoi kështu, ai mbeti në vend sikur t'i kish ndodhur një fatkeqësi e madhe. Remës nuk kish ç't'i bënte. Kur këputet ajo, do shumë punë. Le që s'bën dot asgjë pa u ulur ujrë e rrëmbyera të lumit.

Megjithatë vajti të shihte deri atje. Këtë radhë vërtet s'qe gabuar. Kur zgjati fenerin përpara, nën dritën e tij të dobët u duk shtrati i braktisur i jazit dhe uji i turbullt e i shkumëzuar, që nxitonte tatëpjetë lumit.

Një masë e tillë uji të turbullt, ku lundrojnë dru e kalbësira të ndryshme, që duket sikur e shpejton vrapin kur zbret diku, që buçet për tmerr e për më tepër në një natë të tillë të errët, të fut frikën. Miços kjo masë uji i ngjau si një gjarpër i madh, që i shkonte fare pranë. Bile ai u tërhoq i trembur, sepse iu duk sikur po binte në të, ngaqë iu muarën mëntë. Pastaj i fërkoj sytë, eci me kujdes deri afër remës dhe u mundua të dallonte ku qe këputur. Rema qe e ngushtë e dukej pak zbetë deri në bregun tjetër. Ajo iu duk si buza e një kusie të stërmadhe, prej së cilës qumështi zbrazet në një enë tjetër. Por kjo buzë nuk vinte e tëra njësh dhe kështu krijohet një si kanal uji brenda masës së lëngshme.

Atje ku krijohet ky kanal në masën e ujit të

turbullt, atje ish këputur rema. Ky qe një vend i ngushtë, afër një metër dhe ndodhej nga ana e tij, thuajse rrëzë jazit. Mbi ujë, në atë të çarë, delnin dy hunj, të cilët lëkundeshin, por ende i qëndronin sulmit të furishëm të ujit. Duket atje qe krijuar në fillim ndonjë vrimë dhe ajo vinte duke u zgjeruar. Kështu, si qe tani, ajo mund të zihet lehtë, po deri në mëngjez?

«Deri në mëngjez do të bëhet për të punuar një javë në të, — tha Miçua me vehtë. — Të qe ditë, do ta zija shpejt këtë të çarë, po tani?..»

Disa net me radhë fshati duhet të mbetet pa dritë gjersa të rregullohet rema. Dhe rema desh shumë ditëpunë, ditë të harxhuara kot, të cilat do t'ua rrëmbente kooperativistëve. Ata bënë çmos për ta vlerësuar sa më tepër ditën e punës, kurse këtu...

A kish faj Miçua për këtë? A mund t'i thosh ndonjëri: «Ti, Miço, po na i shton shumë ditët joproductive?»

Jo, ai s'kish faj, E ç'mund t'i bënte ai lumit të mbushur buzë më buzë? Po ditë të kota, ama, do të harxhoheshin. Atij i vinte keq për këto ditë. Vërtet që s'mbante përgjegjësi, po derisa harxhoheshin për hidrocentralin...

Pastaj, a mund të kthehet prapë në fshat me lopatën në krahë e me jazin bosh? Me kokë ulur si i mundur? A do t'i shihte dot pa i sëmbar në zemër ato dritat elektrike të zbeta si shkëndijë? Jo, kurrë! Për të kursyer kooperativën e, ajo që ka më tepër rëndësi, që dritat të mos shuheshin, ai vendosi të vepronte në çast. Ish një punë jo e zakonshme vërtet, po, me ç'a përpjekje, do t'ja delte.



«Shkarpa kam këtu pranë, gurë po ashtu. Do ta zë që tani, duhet pa tjetër ta zë që tani!» tha me vete djali guximtar dhe e shikoi më mirë vendin që të dinte nga t'ja niste.

Duhej të vinte të merrte dy vandakë me shkarpa aty, në korien pranë, ku kish bërë pas-trim kooperativa. Ato do t'i hidhte në vendin e këputur të remës. Hunjtë do t'i pengonin. Mbi to do të hidhte gurë... Veç të mos këputeshin hunjtë! Veç të duronin ata edhe ndonjë gjysmë ore!

Ai vrapoi e solli dy vandakë me shkurre dhe ca gurë. Pastaj nguli një purtekë me kërrabë aty pranë dhe mbi të vuri fenerin. Në këtë vend të ri feneri ndriçonte tamam atje ku duhej, sikur ta mbante njeri.

Miçua u afrua me kujdes, duke mbajtur ndër duar vandakun e parë. Ai e hodhi atë në «kanalin» brenda ujit. Uji e ngriti lart, si të qe vandak kashte dhe do ta kish flakur poshtë, po të mos qe penguar një shkurre e tij në njërin prej hunjve. Por vala e ujit godiste me tërbim në vandakun; ai po hepohej e shkurrja po lirohej. Po të shkëputej ajo prej vandakut, ai do të fluturonte tutje si cingël. Çentralisti nuk humbi kohë; e hodhi edhe vandakun tjetër. Por edhe ky mbeti mbi ujë. Uji shkante poshtë tij dhe e lëkundte sa andej këtej, siç i lëviz një gjarpër gurët e vegjël, kur shkon nëpërmes tyre. Miçua hodhi një gur mbi vandak. Guri shkau anash dhe ra në ujë. Vandaku u ngrit më lart. Ai hodhi një gur tjetër, por edhe këtë lëkundja e valëve e rrëzoi poshtë.

Miçua e kuptoi se gurët nuk do të mbaheshin mbi vandak që ta ulnin atë. Tani uji gjente pen-

gesë më të madhe. Dhe kur gjen pengesë më të madhe, sa bëhet më i fuqishëm, kreshpërohet e sulmon më me tërbim. Po të priste edhe pak, goditjet e valëve do t'i thyenin hunjtë dhe, bashkë me vandakët e shkarpave, do të rrëmbeheshin prej tij. Ç'të bënte? Po sikur të hidhej mbi vandakun e shkarpave, ta ngjishte poshtë me peshën e tij dhe pastaj të radhiste një sasi gurësh?

A kish rrezik në këtë punë?

Jo, ai nuk ish cingël që vala ta hidhte tej. Mjaft që të mos i merreshin mentë. Po sytë e tij tani ishin mësuar me ujin e turbullt e të rrëmbyeshëm. Apo të shkonte? Atë natë hidrocentrali mund të mbetej për një kohë me ujët e Përroit të Vogël, po më pas? Miçua e përfytyroi remën krejt të shkatërruar, se ai e dinte që rema do të shkatërrohej. E përfytyroi fshatin pa drita elektrike, rrugët të errëta, shtëpitë me llambat e zbeta të vajgurit, mërzitjen e tij dhe të fshatarëve, që ishin çmësuar me llambat e vajgurit — le që shumë prej tyre s'kishin, ndoshta, fare vajguri — i përfytyroi këto dhe zemra i pikoi helm.

«Njerëzit kanë bërë edhe gjëra të tjera më të mëdha», tha me vete ai dhe pa humbur kohë afroi rrëzë përroit plot gurë e me kujdes shkeli mbi vandakun e shkarpave. Vandaku fundosi poshtë bashkë me këmbët e tij. Uji i vajti deri mbi gju-njët. Ai drejtoi trupin që të mbante ekuilibrin. Atëhere shikoi pa dashur përpara dhe u rrëqeth: drejt tij vinte një det i tërë i shkumëzuar. Nuk e besonte kurrë se mund të dukej aq i gjerë një lumë kur futesh në të. Pati frikë se do t'i merreshin mentë dhe ktheu kokën nga bregu i afërt. Poshtë dëgjonte atë zhurmën e llahtarshme, si-



për ndjente ndër këmbët e tij tërbimin e valëve. Shiu vazhdonte me atë ritmin e ngadalshëm, po ai s'pyeste fare për të. Ai ish futur i tëri në ujë.

Atje, në breg, ndriçonte, dobët feneri, i vetmi shok dhe ndihmës i tij në atë natë të errët. Feneri i vogël, sadoqë me mundim të madh, e shpërndante errësirën. Ai qeshi me fenerin e tij. Feneri sikur e ngrohu, sikur i buzëqeshi, i dha forcë e besim. Ai sikur i thosh: «Ja, unë qendroj këtu i vogël, i vetmuar, përballë errësirës, erës e shiut, por s'dua t'ja di!»

Me përpjekje të mëdha, duke u munduar të ruante ekuilibrin, të mos shihte as në një anë e të mos e dëgjonte atë zhurmën e llahtarshme, ai e tërhoqi edhe vandakun tjetër, e shtroi para tij, ngriti me kujdes njerën këmbë dhe e vuri mbi të, pastaj edhe tjetrën. Kjo qe puna më e rrezikshme. Ai psherëtiu i lehtësuar. Këmbët tani i kish të mbuluara me ujë vetëm nga noçka e poshtë. Vala e ujit nuk përplasej më me furi mbi të. Ai s'ndjente më tronditje prej saj. Vala takohej me këmbët e tij, pastaj, si e trembur, bënte më tutje dhe ndahej: një pjesë shkonte në jazin e centralit, një pjesë, nëpër boshllëqet, derdhej poshtë dhe pjesa tjetër kthehej prapa e bënte anash, duke u derdhur poshtë, nga ana e shëndoshë e remës.

Miçua u kënaq sidomos kur pa këtë pjesë të kthehej pas.

«E munda, e ktheva prapa, — tha me vete i gëzuar, — shih si kthehet me bishtin ndër shalë! E sheh, o fener?»

Ai i mori gurët njerin pas tjetrit dhe i lëshoi ndër këmbët e tij, mbi vandakun me shkarpa. Tani mjaft që ai të delte në breg me kujdes, se,

po të lëkundej shumë, do ta ndihmonte dallgën e dobësuar për t'i rrukullisur gurët poshtë. Dhe atëhere mundimi shkonte kot.

Kur doli në breg, psherëtiu edhe njëherë i lehtësuar, u shkund, përplasi këmbët në tokën e lagur dhe mori lopatën. Punoj më tepër se një orë me rrëmbim, duke hedhur plisa e dhé dhe ndaloi vetëm kur pa se pjesa e këputur ish zënë dhe qe siguruar mirë. Atëhere fshiu djersën, mori fenerin dhe shkoi tatëpjetë.

...I lagur, i lodhur, por i kënaqur, ai ndoqi jazin deri te hidrocentrali. Uji kish shkuar më parë. Kadet qenë mbushur plot. Duke u derdhur në të, uji nuk bënte më zhurmë të frikshme. Këtë zhurmë e mposhte ajo e dinamos, të cilën e ndihmonte rrapëllima e rripit të transmisionit. Lampa elektrike, që kish vënë te dera e hidrocentralit, ndriçonte tërë vendin përreth me një dritë të bardhë e të fortë. Miçua hodhi vështrimin përpara. Në gjithë fshatin dukej po ajo dritë e bardhë, në rrezet e së cilës pikat e shiut vinin të dobësuar, si pa fuqi, dhe, të nënshtruara, rridhnin butë-butë e në qetësi, duke ndjekur njera-tjetrën.



## NË UDHËTIM

Ish mëngjez herët. Dielli sapo kish dalë e s'e kish zënë mirë qytetin.

Llazi, bashkë me tre fëmijët e tij, po shkonte në stacionin e trenit. Dy fëmijët e rritur, Tefta dhe Ylli, njera tetë vjeç e tjetri dhjetë, shkonin përpara, ndërsa Llazi me Agimin pesë vjeçar, që e mbante herë për dore e herë në krah, vente pas.

Ora po vente gjashtë. Llazi e shihte dhe pshe-rëtinte:

«Eh, do mos arrijmë dot, ta marrë djalli!»

Atëhere e rrëmbente të voglin në krahë, sa-doqë ish mjaft i rëndë, dhe nxitonte e nxitonte.

Kur hynë në sheshin e stacionit, treni ende s'qe nisur.

— Shkoni e zini vend në një kabinë ju sa të marr biletat unë, — u tha babai fëmijëve të rri-tur, duke u drejtuar te sporteli.

Po sporteli ish mbyllur.

«Do të paguaj gjobë e do t'i marr biletat prej konduktorit,» mendoi ai. «Fundja, s'ka gjë, mjaft që arritëm.»

Mirëpo atë çast u dëgjua fishkëllima e mpreh-

3535

4591

SHKËRIMET E SHKËRITËS  
D. M. M. M.

të e lokomotivës, e cila u pasua nga bilbilat e konduktorëve.

Duke e marrë përsëri në krahë të voglin, që e pengonte, Llazi vrapoi të hipte në tren.

— Këtu, babi, këtu! — i thërrisnin fëmijët që nga dritarja e një vagoni. — Shpejt, hip shpejt, se u nis!

Treni vërtet u nis. Llazin s'e ndanin as katar hapa nga vagoni ku kishin zënë vend fëmijët e tij. Ai i bëri edhe këto hapa dhe u kap pas parmakut të hekurt të hyrjes. Treni s'e kish marrë ende shpejtësinë dhe atij s'i mbetej veç të hidhte këmbën në shkallë, kur konduktori i tha në mënyrë të prerë:

— Mos hip! Është e ndaluar të hipësh në ecje!

Llazi, me njerën dorë kapur pas parmakut, vraponte pas trenit dhe jepte e merrte për t'ja mbushur mendjen konduktorit se duhej të hipte pa tjetër, mbasi fëmijët s'dinin ku të venin, po tjetri qendroi i papërkullur.

— Është rregull, — tha. — Nuk lejohet!

Llazit i hipi gjaku në kokë. I erdhi të kërcente me forcë në shkallë, e t'i sulej me grushta konduktorit kokëfortë, po ndërkaq treni kish marrë shpejtësinë e atij iu desh të shkëputej nga parmaku me zemër të thyer. Pa ditur, ç'të bënte, duke qenë krejt i hutuar nga kjo e papritur, e lëshoi të voglin në platformë dhe vrapoi pas trenit. Fëmijët që ishin zgjatur në dritare, thërrisnin:

— Babi, hip, o babiii!

Tefta filloi të qante. Ai vinte pas tyre e s'dinte ç't'u thotë, sikur t'i ish zënë goja. S'pa as ndo-



një të njohur, që ta porositte të kish kujdes për ta.

I trullosur, ndaloi dhe vuri dorën në ballë. Para syve të tij kaloi edhe vagoni i fundit, duke zbuluar dy shinat e hekurta, që zgjateshin e zgjateshin, sikur i lëshonte ai nga pas. Sipër ato i shoqëronte një fjollë tymi i zi që davaritej shpejt. Duke kaluar në këtë si tunel, vagoni i fundit sa vinte e zvogëlohej. Ja, së fundi u dëgjua një fishkëllimë e zgjatur dhe e largët. Atëhere u bë një qetësi e madhe, njerëzit që largoheshin nga stacioni, iu dukën si miza, sepse nuk ndihej fare e folura e zhurma e tyre, sikur të vepronin në një film pa zë. Pastaj zhurma e rrotave të hekurta u largua nga veshët e tij dhe ai dëgjoi të qarët e Agimit të vogël.

U kthye tek ai, e mori për dore dhe u largua nga stacioni. Fëmija qante, po ai s'bëri asnjë përpjekje për ta qetësuar. E mundonte meraku për fëmijët, që kishin ikur me tren, e mundonte turpi, që i kish ndodhur një gjë e tillë atij, që ish aq i rregullt në jetë. Në jetë cilitdo mund t'i ndodhin të papritura, sado i rregullt të jetë, aq më tepër në udhëtime të tilla të rastit, po atij kjo i dukej një diçka e tmerrshme.

Për këtë udhëtim kish zënë të interesohej që një javë më parë. Kish marrë vetëm tri ditë leje, sa për të parë të jatin, që e kish të sëmurë. E shoqja ishte me një turne nëpër fshatra, kështu që duhej të merte me vete edhe fëmijët. Ishte përpjekur të gjente ndonjë makinë të rastit që të vinte sa më parë. Kish gjetur një «Skodë», e cila do të ngarkohej në ndërmarrjen e tij. S'kish ku vinte

më mirë: «Skodat» ikin shpejt e udhëtimi me to është i rehatshëm. Dhë ai ish ngritur shpejt, pa rënë dielli.

«Më mirë ta pres unë maqinën, se të më presë ajo mua.» thosh ai si njeri i rregullt që ish.

Mirëpo, kur u ngarkua «Skoda», shoferit i thanë se ai mall duhej shpënë në Sarandë e jo në Korçë. Çdo përpjekje e tij ish e kotë: aty ndihej nevoja.

Llazi s'e bëri veten. I mori fëmijët dhe u nis për te treni. Ora e nisjes së tij s'kish vajtur dhe, po të nxitonin ca, mund ta arrinin. E vërteta është se atij iu prish qejfi dhe, në ato çaste, mendoi se sa me vend është ajo fjala e urtë që thotë se rruga e gjatë pret më shkurt.

«Eh, tha me vete, kanë vojtur njerëzit e prandaj kanë thënë të tilla fjalë të mënçura!»

Dhe nxitoi e nxitoi, po, siç e pamë, nuk arri-ti dot me kohë. . .

\* \* \*

Me djalin e vogël për dore ai u kthye përsë-ri në qytet, nëpër rrugët e të cilit tani kish filluar lëvizja e gjallë e njerëzve.

As ndërmend s'e shkoi që të vente në shtëpi. Shkoi te Banka për të gjetur ndonjë taksi, po as atje s'pati fat. Taksitë për udhëtime të largëta ishin nisur. Atë ditë ish e dielë, kish dasma e lë-vizje shumë, kështu që s'mund të shpresonte shumë në to.

I ngrysur në fytyrë, duke e mbajtur veten me zor të madh, u nis për nga rruga e Elbasanit. Jo, duhej të bënte diçka. Në shtëpi s'mund të kthe-



hej, përderisa fëmijët ishin në udhëtim. Ai duhej t'i arrinte ata. Dhe duhej t'i arrinte në Elbasan para se të niseshin autobuzët e Korçës! Duhej të gjente pa tjetër një maqinë të rastit. Prandaj doli në rrugën e Elbasanit.

Dielli ish ngjitur mjaft lart në kupën e kalter të qiellit. Kish filluar të bënte vapë. Maqina kalonin, por s'ishin për në Elbasan. Llazi po e humbiste durimin. Kushdo që ka udhëtuar, sidomos me maqina të rastit, e di sa e mërzitshme është të presësh kështu në rrugë. Aq më tepër po të jesh në një gjendje të tillë shpirtërore siç qe Llazi. Ai nuk rrinte dot në një vend. Lëvizte sa andej këtej, shikonte drejt qendrës së qytetit prej nga duhej të vinte maqina që do të qe për të, vinte vesh të dëgjonte zhurmën e saj. Herë pas here shikonte orën. Sa shpejt që ikte ajo! Kur e shihte, atij i dridhej shpirti, mendonte se s'do të shkonte dot me kohë, djersët e mbulonin, pshe-rëtinte.

Ora kaloi njëmbëdhjetën. Ai e humbi edhe shpresën e fundit. Po të nisej para orës njëmbëdhjetë, mund t'i arrinte, ndryshe... Treni vete në Elbasan para dymbëdhjetës, autobuzët nisen në orën dymbëdhjetë e gjysmë. Ndërsa nga Tirana në Elbasan, me maqinë, duhet të paktën një orë e gjysmë.

Kur po mendonte ashtu shpresëhumbur, tek kthesa u duk një maqinë. Ish një «gaz» i mbuluar.

«Ky s'ka ku shkon gjetkë, veç në Elbasan ose më tej», mendoi Llazi. «Përpara e paska të zënë vendin, sidoqoftë...» Pa mbaruar mendimin, ai i doli maqinës para dhe bëri thujse me tërë

trupin një shenjë aq të ngutshme sa që shoferi, megjithëse kish nxjerrë dorën nga kabina për të treguar se s'kish vend, frenoi pak më tej.

— A shkon në Elbasan? — pyeti me nxitim Llazi.

— Po, por e kam të zënë vendin e parë, siç e sheh.

— Hipi sipër unë!

— Maqina është e ngarkuar, o shok, nuk na lënë ashtu, — dhe shoferi lojti marshin për t'u nisur.

— Shofer, të lutem! Kam një punë që s'pret. Do të më marrësh pa tjetër.

— Keq më vjen, — tha shoferi duke mbledhur supet.

Llazi, duke u trembur se mos i ikte ky rast, që e quante të fundit, ja tregoi ashtu shpejt e shpejt fatkeqësinë, që i kish ndodhur.

— Remë, — i tha shoferit ai që kish zënë vend në kabinë. — Kur qënka puna kështu, do ta marrim domosdo. Hipi unë sipër.

Dhe pa mbaruar fjalën, u ngrit e doli nga kabina.

— Mirë, — tha shoferi. — S'kemi ç'bëjmë. Hip, o shok! — shtoi ai.

Llazi e rrëmbeu të voglin ndër duar dhe hipi në çast. Nuk harroi të falënderonte atë që i kish lëshuar vendin dhe që po i thosh shoferit të nxi-tonte e të mos humbiste asnjë minutë kot, se ndryshe s'bënte dobi e mira, që po i bënëin këtij udhëtari.

Dhe Rema s'humbi kohë, ja shkeli gazin e maqina u hodh përpara, duke përpirë rrugën e asfaltuar. I duhej ta bënte Elbasanin për një orë



e një çerek. Kjo nuk ish e lehtë, por, ama, ish një gjë që mund të bëhej dhe ai do ta bënte. E kishin prekur shumë fjalët dhe halli i këtij udhëtarit. Apo mos e kish gënjyer? Rema i hodhi Llazit një vështrim hetues. Jo, s'ish nga ata.

Dhe Rema, i sigurtë, shikoi përpara dhe ja shkeli edhe ca. Mund t'i delte kontrollori në rrugë. Dhe kish çfarë t'i thosh: mbante një pasagjer, megjithëse nuk kish vend; maqinën e ngiste shumë më shpejt nga sa lejohej. Sikur të mos ishin mjaft këto, pasagjerin e kish pa biletë. Pse nuk kishin marrë, të paktën, një biletë? Ta marrë dreqi, kishin harruar! Po a do t'i besonte kontrollori që kishin harruar? Fundja, biletën mund ta merrnin edhe në Kërrabë. Megjithatë prapë ishin në kundravajtje. Mund t'i fluturonte lata, në mos patenta. Vërtet që mbante një farë përgjegjësie edhe Sejfiu, shoqëruesi i tij, po kjo përgjegjësi vlente vetëm për në ndërmarrjen e tyre, se kontrollori rrugor s'pyet nga ato.

«Ti je shofer, — thotë ai, — dhe ti përgjigjesh për maqinën tënde!»

Eh, në ç'gjëndje të vështirë ndodhet nganjëherë njeriu! Po Rema e mori parasysh çdo gjë: le të dalë ku të dalë! Ai po bënte një të mirë e jo një krim. Këtë të mirë s'e bënte për interes, jo, e bënte se ish njeri. Po, tamam në këtë mënyrë mendonte. Ai që njeri mbi të gjitha e pas-taj shofer, zanatçi. Dhe, si njeri, nuk mund të tregojë mospërfillës kundrejt hallit të një njeriu tjetër, kur këtë hall ai mund ta zgjidhte. Kështu e urdhëronin ndjenjat e tij.

I qetësuar, sepse kish vepruar drejt, Rema

nxori paqetën e cigareve dhe ja zgjati udhëtarit të vrerosur.

— Më fal, — tha ky i hutuar, — ja, po të jap unë më parë. — Dhe nxitoi të nxirrte edhe ai paqetën.

— S'ka gjë, ndize këtu tani, se je në shtëpinë time, — dhe shoferi qeshi i kënaqur.

E ndezën dhe vazhduan rrugën. Herë pas herë Rema i hidhte nga një vështrim Llazit.

— Mos u mërzit, — i tha, — brenda një ore jemi atje e çdo gjë do të rregullohet. Kur të them unë, flije mendjen!

— S'dyshoj për këtë, jo. Po te stacioni i trenit si kanë bërë vallë? Ata janë të vegjël. Apo s'bëhet një rrëmujë atje që...

— Po pse, vetëm ishin ata?

— Vetëm jo, po njeri të njohur s'më zuri syri.

Shoferi qeshi.

— S'ka rëndësi kjo. Sot të kesh frikë për raste të tilla? Cilido prej atyre që muarën vesh si u ndodhi fëmijëve të tu, do të jetë i gatshëm t'u dalë krah. Sikur të ishe ti, nuk do t'u delje?

— Oh, si jo!

— E, atëhere? Asgjë të keqe mos mendo. Ja, sikur kemi vajtur.

Atë çast në kthesë doli papritur hunda e një maqine. Rema bëri një përpjekje të shpejtë e të fuqishme me timonin për të mos u përplasur me të. Pastaj drejtoi trupin, zgjati qafën dhe shikoi përpara. Nuk foli më. Maqinës ja kish shkelur shumë dhe duhej të kish kujdes.

Llazi u mbështet në shpinën e kolltukut me vështrim të ngulur përpara. Para syve të tij ka-



lonin me shpejtësi shtyllat e telefonit. Kthesat e shumta mbeteshin pas. Maqina përpinte me uturimë rrugën e asfaltaruar. Ai vështronte dhe zemra i bëhej mal. Përse? Ndoshta sepse nxitimi në këtë rast ish ilaçi i vetëm për t'ja larguar merakun e shqetësimin. Po ndoshta edhe se e dinte që ky nxitim bëhej për hatrin e tij. Kthente kokën nga Rema dhe e shikonte me admirim.

«Trim djalë!» — mendonte. — Duhet ta ketë zemrën flori». Për të ai po e ngiste me aq shpejtësi maqinën. Për të i kish shkelur rregullat e qarkullimit, sadoqë dukej i kujdesshëm. Jo, ky Rema ish djalë për kokë të djalit. Llazit i vinte të ngrihej e ta puthte në ballë shoferin zemërflori, po ky i dukej një veprim aspak serioz e s'desh ta lëshonte veten.

Pastaj përsëri mendonte fëmijët. I përfytyronte duke zbritur të hutuar nga treni. Kushedi sa do të kenë qarë! Kushedi sa do të gëzoheshin kur ta shihnin! Ja, për gjysmë ore do të arrinin. Ai e shikoi si fshehurazi orën dhe fytyra i qeshi:

Shoferi trim do ta mbante fjalën. Brenda dyzet minutave e kishin kaluar gjysmën e rrugës. Po nuk arriti të gëzohej e të ngushëllohej me këtë shpresë, kur, sa muarën tatëpjetën, vuri re motoçikletën e kontrollorit rrugor. Zemra iu drodh.

— Kontrolli! — i tha i trembur shoferit.

Rema bëri shenjë se e pa, po nuk mundi ta pakësonte shpejtësinë dhe mezi frenoi në krahun e djathtë disa metra më poshtë se oficeri i kontrollit. Nuk zbriti nga maqina, ndoshta sepse i vinte zor, se po zihej në gabim, ose sepse desh ta

mbante veten. Qendroi në vend, gjakftohtë, dhe e priti atje kontrollorin.

— Ku shkoni? — pyeti ky pasi nderoi me një përkulje të hieshme të kokës.

— Në Elbasan.

— Edhe ju në Elbasan? — e pyeti kontrollori Llazin.

— Po, — tha me gjysmë zëri Llazi.

— Ke marrë biletë?

Llazi ngurroi e u hutua. Nuk dijt si t'i përgjigjej dhe u bë gati t'ja tregonte ç'i kish ndodhur, po Rema s'e la, se nxitoi të përgjigjej në vend të tij.

— Nuk ka marrë biletë, — tha ai prerë.

Pastaj kontrollori vuri re Sejfiun që zbriti nga karrocera, tundi kokën e tha:

— Nga t'ja fillojmë? Maqinën e nget shumë shpejt. Në s't'ë dhimbset koka jote, duhet të mendosh për këta të tjerët. Mbi ngarkesë ke marrë, pa bileta i ke...

— E di që jam në kundravajtje, — tha shoferi, — po këtë e kam marrë parasysh, vetëm të lutem për një gjë: mos më pengo tani. Unë pranoj çdo gjë dhe ti bëj ç'ke për të bërë, po kur të kthehem.

Kontrollori po habitej. Atëhere ndërhyri Sejfiu. Me pak fjalë ai sqaroi se si qe puna. Kontrollori tundi kokën dhe bëri një hap më tej. Pastaj kafshoi buzën e poshtme dhe diç u mendua. Kur e ngriti kokën, shikoi nga Llazi.

— Na fal, o shok, — i tha këtij, ndërsa shoferit i bëri shënjë që të nisej.

— Vetëm ki kujdes, mor shejtan! — shtoi «Gazi» u nis përsëri.



Disa minuta më pas maqina zbriti në fushë. Vetëm atëhere Llazi pyeti me një fije zëri:

— A do të të dënojë, thua?

— Sipas rregullit, po.

Llazi s'kuptoi gjë nga kjo përgjigje. Pyeti përsëri:

— Po si ta merr mendja të veprojë ai?

— Kjo s'ka rëndësi.

— Si s'paska rëndësi! Mua m'u duk djalë i mirë dhe them se do të ta falë.

— Edhe ai, — tha Rema duke shikuar përpara, — para se të jetë kontrollor, është njeri. Fundja, ne jse...

Llazi tundi kokën shumë i kënaqur nga kjo përgjigje kuptimplote. Tani po, ai e kuptoi atë, Remën, dhe veprimin që kish bërë për të. Përsëri zemra iu bë mal nga kënaqësia. Dhe përsëri ndjeu dëshirën ta përqafohte e ta puthte këtë djalosh guximtar e zemërmirë.

\* \* \*

Pas pak «Gazi» ndaloi tek agjensia e Elba-sanit. Pasagjerët po hipnin në autobuzë. Llazi kërcëu nga maqina dhe po shihte me padurim e si me frikë nëpër to.

— Babi! — dëgjoi t'i thërresin nga njëri.

Ai pa se si të dy fëmijët u lëshuan drejt tij dhe iu hodhën në qafë.

— Babi, ja, ky xhaxhi na mori e na gjeti edhe bileta! — tha Tefta.

— Na dha edhe drekë! — shtoi Ylli.

Llazi, i mallëngjyer e si i hutuar, e falënderoi të panjohurin, që po i buzëqeshte.

Atë çast te dera e autobuzit u dha Rema me

Agimin e vogël në krah. Ai e lëshoi atë dhe buzëqeshi kur pa se si iu sulën e pō e puthnin dy të tjerët, sikur të ishin ndarë kushedi që kur.

— Rrugën e mbarë, Llazi! — tha pastaj duke zgjatur dorën.

— Oh, prit, se unë e humba fare, mor djalë!

Dhe Llazi nxori lekët nga xhepi duke shtuar: — S'kam paguar udhëtimin, shiko, shiko...

— Mos më fyej! — tha prerë Rema.

— Si, ç'është kjo e fyer! Ja, zëre sikur do të pinim nga një birrë bashkë, posi.

— Do ta sjellë rasti të pimë edhe nga një birrë. Si thonë, mali me malin nuk piqen, se njeriu... Hajt, mirë u pafshim! — Dhe këtë radhë e nderi dorën më me vendosmëri.

Llazi ja shtrëngoi dorën me të dy të tijat, po kjo s'iu duk hiç me vend. Ai nxitoi ta ndreqte këtë gabim, e përqafoi dhe e puthi duke i thënë:

— Je një djalë xhevahir. Kurrë s'ta harroj këtë që bëre sot për mua! — Dhe i tha ku ta gjente në Tiranë.

Rema zbriti dhe i përshëndeti edhe njëherë me dorë duke buzëqeshur.

Kur «Gazi» u nis, Llazi ktheu kokën dhe hasi vështrimin e ëmbël të të panjohurit, që ish kujdesur për fëmijët e tij. I buzëqeshi dhe i tha:

— Besoj se do të udhëtojme bashkë e do të njihemi mirë. Tani po vete të shoh edhe për një biletë tjetër.

Udhëtimi më pas i vajti shumë mbarë dhe ai ndjehej tepër i kënaqur. E ndjente zemrën të mbushur plot gëzim prej përshtypjeve aq të mira, që kish patur nga njerëzit, me të cilët iu dha rasti të njihej atë ditë.



## DASHURIA PËR TOKËN

Prilli u tregua i pakursyer: pemët i ngarkoi me lule shumëngjyrëshe, bimët e jonxhat i gjallëroi dhe ajrin e pasuroi me aroma lulësh e cicerima zogjsh. Këto aroma përziheshin edhe me atë erën e njohur që ka dheu i porsalëruar. Sidomos kjo përzierje e kënaqte pa masë xha Vasilin. Po në këtë ditë të prillit atij nuk i bënte përshtypje asgjë.

Lëronte në një arë buzë lumit. Ecte i kërrusur, duke lëvizur sa andej-këtej dorashkën e parmendës.

— Mua të ma bëjë këtë? Po mirë ma bëri! Rri, or qerrata, rehat, ç'të duhet ty të shesësh mend! Nuk e di ti se kurrë s'del i humbur ai që vetëm ble?

Dikur vuri re se qeve u rrihnin barqet me nxitim. U kujtua se kish harruar t'i linte të çlodheshin.

— Oha, bir, oha! — u foli.

Qetë qëndruan menjëherë. Ai ua liroi parmendën dhe e mbështeti hostenin në zgjedhë, si pengesë. Pastaj u hodhi misërishte të thata, të cilat ata filluan t'i hanin me lakmi.

Ai mernte me vete gjithmonë një kazmë e

latore dhe, kur çlodheshin qetë, thyente galinat, sepse s'i shihte dot të forta e të mëdha, sikur t'i mburreshin.

Mirëpo atë ditë s'e kish mendjen te galinat. Ai mendonte grindjen me brigadierin, grindje që e kish shqetësuar e dëshpëruar shumë. Vajti e u shtri në mezhde.

Ndezi një cigare të trashë dhe po e thithte me duf.

Papritur vuri re se pranë tij u ul Koci, që lëronte në një arë aty afër.

— Tërë jetën si hie ke baritur, o Koste! — tha xha Vasili.

Koci qeshi me qesëndi.

— Të ngarkuara apo bosh i kishe gjemitë, o Vaso?!

Tjetri s'foli, po shikoi shtrembër. I vinte inat. Koci qe nga ata që s'përziheshin fare në punët e kooperativës. Punonte mirë, por vetëm për vete.

E njihte tokën mirë, e dinte mirë kohën kur duhej mbjellur, i dinte tërë punët e bujqësisë si bujk i mirë që ish, por i dukej sikur do të futej në telashe, po të jepte mendimin e tij, prandaj, kur e pyesnin për gjësendi, përgjigjej duke mbledhur supat me një frazë stereotipe: «Pa di edhe unë!».

Vasili kish thënë sa e sa herë, se, ashtu si Koci, ish e kotë të jetonte njeriu.

Dhe tani prandaj i vinte inat nga ngacmimet e tij. Dhe Kocit këtë radhë i qe zgjidhur gjuha.

— Ti, Vaso, — thosh, — ke qejf të ta dëgjojnë llafnë, je çyst ti! Ta krehin edhe ca bishtin dhe pastaj!.. Pse, budalla jam unë që s'flas? Po kujt t'i thuash, more! Ta vë veshin njeri? Mirëpo ti



thua se unë jam i shastisur. Hë, tashti! Tërë javën e mirë, e mbarë nusja, një gabim na bën të shtunë dhe hop, bëhet e pambarë!

Këto iu dukën me vend xha Vasilit. Ja kishin dëgjuar fjalën dhe ai shumë herë kish ndjerë kënaqësi të madhe nga këshillat e mira që kish dhënë, mirëpo...

Në fillim, kur hyri në kooperativë, edhe ai «shikonte vetëm punën e tij». Bile e kish ndjerë edhe të fyer veten kur vunë brigadier Kolin, «një çilimi», që s'kish fare haber nga bujqësia! Ai do t'i mësonte bujqit?! Punë të bukur po bënin ata të kryesisë, besa!

Dhe xha Vasili, si të thuash, ish tërhequr mënjanë dhe shikonte veç punën e tij. Le t'u jepte dum brigadieri punëve të kooperativës.

Kështu dita ditës shikonte se si Koli, ai «çilimiu», që vërtet s'dinte dhe aq, po që ish i zgjuar e i shkathët, po ja merrte dorën punës për bukurri. Ai fliste gjithmonë shtruar dhe i dëgjonte me kujdes këshillat e bujqve. Nga këto vërejtje, xha Vasilit i ish lëkundur që nga themelet ai zemërimi i tij pa shkak kundrejt Kolit.

Një ditë kishin vajtur të mbillnin misër. Ishin shumë bujq në një parcelë, në Ullcovec. Ish edhe Vasili e Koci. Ua suallën misrin. Koci e të tjerët filluan të mbillnin.

Xha Vasili vuri re se misri ish i lagur e i bymyer.

— More shokë, — tha, — ky misër është venë në ujë që mbrëmë.

— Pse, e para herë është kjo, a? Ne kështu po mbjellim që prej dhjetë ditësh! — tha njeri.

— E di, e di, po këtu ndryshon puna. Misrin

e vënë të njomet, se koha sivjet është e thatë e s'ka vlagë, po këtu, or tunjatjeta, i thonë Ullcovec! Këtu vendi është vodenik e misri do të kalbet. Ja, le të thotë edhe Koci!

Koci mblodhi supet si nga hera e tha me gjysmë zëri:

— Pa di edhe unë!

— Na hëngre veshët me këto fjalë, o Koci! — iu shkreh Vasili — E si s'ditke ti? Tërë jetën këtu ke punuar! Apo s'ka qenë jotja kjo arë! E mbillje ti ndonjëherë me misër të lagur?

— E, ashtu, po tashti s'urdhëroj unë! Këtë punë e dinë të mëdhenjtë.

— Po ne, ç'dimë ne? T'i themi vetes se mbuallëm? Jo, vëlla, kështu s'bën. S'duhet ta gënjemë veten. Misrin e mbjellim për vete.

Pastaj, si e kish dërguar në depo misrin e lagur, kish kërkuar t'i sillnin të thatë. Kështu kishin bërë edhe të tjerët. Kjo ish bërë çështje e madhe. Vajti fjala te brigadieri, te kryetari, more edhe te agronomi i rrethit, që e kish dhënë atë udhëzim. Po të gjithë i dhanë të drejtë xha Vasilit e kryetari e kish lavdëruar në mbledhjen e asamblesë.

Këto lëvdata ai i kish pritur vetullngrysur, pa u dhënë fare rëndësi, po thellë në shpirt ndjente atë kënaqësinë e njeriut që ka bërë një punë të mirë. Kish dhënë një këshillë me vend, kish shpëtuar disa hektarë tokë nga më të mirat prej shterpësisë së plotë. E pakët ish kjo?

Po gjithënjë e hante merakun në do të delte apo jo misri i thatë. Po sikur, për djall, të mos delte? Ai e dinte se kjo ish e pamundur, megjithatë



edhe ajo fije e vogël dyshimi që ndjente, e mundonte pa masë. Aq merak kish, sa që ngrihej me natë dhe fshehurazi vinte në Ullcovec, e gërmonte pak tokën; gjente kokra misri, i shikon-te me vëmendje e ikte i kënaqur, se vinte re që fara po zhvillohej si duhej. Dhe, kur misri dolli, ai u gëzua si një fëmijë, sepse kish edhe nga ata që thoshin: «Sikur të mos dalë, pa të shohim ç'do të bëjë Vasili pastaj!»

Që atëhere, kurrë s'ish kursyer të jepte mendimin e tij në çdo rast.

... Po ja, një grindje me brigadierin e ri, Lonin, se Koli kish vajtur në një detyrë tjetër, ja kish prishur qejfin këto ditët e fundit të prillit.

Një ditë më parë ai po mbillte patate. Toka qe punuar e plehruar si jo më mirë, patatet ishin të zgjedhura e të dizinfektuara me kujdes e xha Vasili ndjente atë kënaqësinë e zakonshme që provonte kur punët venin mirë. Mbasdite qielli u err e u bë gati për shi, bile filluan të binin pikat e para. Si e pa kohën kështu, xha Vasili tha se do të ishte më mirë që të mos e branovitnin tokën e mbjellë, se, po të binte shi, ish keq për mbirjen. Bujqit e tjerë, që ja njihnin zotësinë, e dëgjuan dhe bënë si tha ai. Por s'kishin arritur mirë në fshat, kur retë e dendura u shpërndanë, duke zbuluar qiellin e kaltër. Koha i kish gënjyer.

Sapo i lanë qetë e veglat e punës, në oborrin e stallave arriti Loni, brigadieri i tyre i ri. Ai dukej i nxehur. Kish vajtur në arë, e kish parë atë të mbjellë, po të pabranovitur, kish mësuar se këtë mendje e kish dhënë xha Vasili dhe ja ku po vinte i nxehur kundër tij.

— Pse nuk e branovitet arën? — pyeti.

Bujqit shikuan xha Vasilin.

— Po ja, mor djalë, — tha ky, — thamë se mos binte shi dhe ara bëhej plloçë pastaj.

— Le të bëhej! Kur të kam dhënë urdhër unë, ç'do ti? Ti s'ke përgjegjësi për të!.

— Si, ore, s'paskam përgjegjësi!? Ama, mos u llafos tashti si e ëma e Zeqos majë thanës!

Brigadierit i dogëndisën keq këto fjalë. U skuq e u mavijos, fjalët i delnin përgjysmë, zëri i dridhej.

— Brigadier jam unë! — bërtiti. — Ta kemi zgjatur ca dhe të është rritur mendja si shumë, po...

Plaku s'dëgjoi më tej. E ç'të dëgjonte? Edhe me kaq mbeti si i ngrirë. Kurrë s'kish dëgjuar njeri t'i fliste në këtë mënyrë! Kurrë s'i kish folur njeri kaq ashpër! Dhe përse? Sepse ish përpjekur për mirë!

... Ja, kështu kish ndodhur.

Tani rrinte në mezhde shtrirë, duke hequr me duf cigaren e trashë.

Qetë ishin çlodhur e po përtyreshin. Pendarët u bënë gati të ngriheshin përsëri, por vunë re se po vinte kryetari dhe e pritën atje, te mezhda. Kryetari i përshëndeti serbes, siç e kish zakon, pastaj u ul pranë tyre. Ai e drodhi një cigare nga kutia e xha Vasilit dhe, duke e shikuar buzagaz, i tha:

— Pa hë, xha Vasil, si bëtë dje me atë djalin?

Bujku plak s'foli fare e as kokën s'e ngriti. Pasi kryetari s'e linte rehat, ai hoqi me vete:

— Ti e ke marrë vesh!

— Ndoshta s'e kam marrë vesh mirë, prandaj të pyes.



— Ta ka thënë ai meselenë, — tha xha Vasili.

— Dëgjo, xha Vasil, këto janë gjëra që ngjasin. Në punë bëjmë edhe gabime, domosdo, se s'jemi njerëz rënë qiellit.

— Jo, kush tha.

— E kështu de, edhe gabojmë. Ti u përpoqe për mirë. Ne e dimë që ti je përpjekur gjithnjë për të mirën e përbashkët. Loni ka gabuar. Ne ja hoqëm ca veshët atij dhe ai e pranoi gabimin e do të të kërkojë ndjesë vetë, po, ndofta sot... i vinte ca rëndë.

Plaku psherëtiu. Pas pak tha duke shikuar nga ana tjetër:

— Ta ketë mësim për veten e tij, se s'është në binarë, pa për mua...

Kryetari zuri një muhabet tjetër e në çast sikur u harrua ajo zënka, që e kish brengosur aq shumë kooperativistin e moshuar.

Si e pa punën kështu, Koci iku vjedhurazi.

Kur u ngrit kryetari të shkonte, në kokën e kooperativistit plak zienin mendime të kundërta. A duhej të rrinte vërtet rehat? A mund të rrinte? Të hiqej kështu mënjanë si i mundur a si njeri që s'e do të mirën e përbashkët?

— Ja, them të mos flas, po s'duroj dot, më lëvron këtu. — Dhe tregoi zemrën. — Ky dhe, o shoku kryetar, do mbjellë e jo përzierë. Kjo arë është bërë qilizmë me traktor. A e sheh si është tashti? Edhe me kleçkë punohet! Është tamam në vlagë. Po ndenji edhe ca ditë...

Si tha këto fjalë, ai mori një dorë dhe, e mbylli grushtin dhe pastaj e hapi: Kur ra poshtë, shuku i dheut u thërmua.

Kryetari zuri të shihte me kujdes. E thirri edhe Kocin. Ai u afrua me drojtje e, kur e pyetën, mbeti një hop si i nemitur, po nuk tha «Pa di edhe unë!» siç e kish zakon.

— Toka do mbjellë kur e ka kohën... — tha xha Vasili dhe iu kujtua se si një vit, tamam si në këtë rast, kish thënë të mbillej një arë muzgë, kur ish pothuaj baltë dhe për më tepër vesonte shi. Ai e dinte se toka argjilore në kohë të keqe duhet mbjellë. E kishin dëgjuar. Dhe atë mot ajo arë kish bërë grurë si asnjëherë tjetër.

Për çudinë e të dyve, Koci s'rrinte më si i ngrirë, po tha me guxim:

— Ashtu them edhe unë. Më mirë është ta mbjellim.

... Pas pak xha Vasili shkante mbas qeve e kënaqej kur shihte dheun e zi tërë vlagë, që kthehej e thërmohej, duke mbuluar kokrrat e verdha të misrit, që sapo ja kishin sjellë.

Dielli i kish shpërndarë retë e pakta dhe ngrohte si në behar. Bilbilat ja thoshin edhe më me zell. Xha Vasili s'ngopej së thithuri aromën e përzier të luleve, të barit të njomë e të dheut të porsalëruar, atë aromë që e pëlqente aq shumë. Ndjehej i kënaqur dhe, kur e kur, i nxiste qetë:

— Hajs, bir, hajs, hajs!



## MBETURINAT E FUNDIT

Maqina jonë ndaloi pranë urës së Devollit. Drejt saj vrapoi një fshatar si nja 45-50 vjeç, veshur me rroba shajaku, të cilat qenë ca të zbardhura, të përdorura mjaft, por jo të grisura. Hodhi në kamion një thes të vjetër, mbushur me hekurishte, pastaj hipi dhe u ul mbi të. Pranë, midis këmbëve, vuri në siguri një torbë të leshtë.

Siç është zakon në të tilla raste, po e vija re udhëtarin e ri. Fytyrën e kish të zezë si të zbetë, me gropëzat e faqeve të futura thellë. Nga kjo dukej sikur po rufiste diçka. Fytyra e tij tregonte lodhje e mërzi. Të lodhur i dukeshin edhe sytë e gjelbër, si pa jetë. Buza e sipërme i rrinte e përveshur, duke i zbuluar ca dhëmbë të zverdhur e tek-tuk të nxirë. Me vështrimin e parë s'të linte përshtypje të mirë.

U ktheva nga ana tjetër dhe po shikoja rrugën.

Pranvera sapo kish filluar t'i hidhte si me drojtje hapat e saj të para. Dielli ish i ngrohtë dhe toka e thatë. Në degët e plepave spikatnin qartë sumbullat gati për të shpërthyer. Por lart, në maqinë, era vinte e ftohtë dhe përcëlluese si

hithër. Edhe diellin nuk e shihje dot pa rrudhur vetullat.

Kisha ngritur jakën e palltos dhe shikoja përpara duke e patur mendjen gjetiu.

Ndërkaq fshatari i porsaardhur kish zënë vend mbi thesin e hekurishteve. Ai u rehatua mirë e mirë, na vështroi të gjithëve me radhë dhe befas tha:

— Oh, po këtu qenkësh edhe Avniu! Si të kam, o Avni? Kur na paske ardhur?

— Ja, tashti po vi, — tha tjetri dhe ja zgjati dorën si me përtesë.

Nga biseda e rastit që bënë ata të dy, u muar vesh se ishin bashkëfshatarë. Avniu po kthehej nga Pishkashi, ku kish punuar si shofer, ndërsa tjetri quhej Reshit dhe banonte në fshat.

Në fillim biseda u duk krejt e zakonshme, dhe kureshtja e të tjerëve dalngadalë po binte. Por, pas një pushimi të shkurtër, duke mbyllur sytë përgjysmë e duke mbledhur buzët si me përqimim, Avniu tha:

— Akoma, me këto avaze merresh ti, Reshit?

— Ç'avaze? — pyeti tjetri serbes.

— Akoma e shkon kohën kot duke mbledhur vjetërsira? — sqaroi shoferi.

Reshiti u duk i prekur në sedër.

— Unë s'e shkoj kohën kot, — tha. — Jam punëtor i ndërmarrjes së grumbullimit të metaleve. Po të ish ashtu, ndërmarrja nuk më mbante.

Të tjerët po e ndiqnin me vëmendje bisedën që kish filluar aq papritur. Avniu e vuri re këtë dhe një çast sikur u tërhoq i penduar, por pas pak zuri vend më mirë dhe u kthye nga ne.

— Ky, or vëllezër, u mësua dembel i madh.



Se nga ka gjetur një punë qorre. Gënje andej e gënje këtej, mbledh hekurishte e i shet përsëri. Dhe tërë ç'fiton, për vete i mban. Asnjë lek shtëpisë e fëmijëve...

— Mos gënje, Avni! Unë i mbaj fëmijët si pëllumba!

— Posi, posi! Tërë zbathur e zveshur. Shyqyr që punon jot shoqe dhe ai djali i madh. Dhe që ta merrni vesh ju, — shtoi shoferi, — ky merrret me një punë hiq e mos këput, se s'është mësuar të dërsijë e të punojë si fshatarët e tjerë.

— Po ti, kur na e dashke kaq shumë punën e fshatit, pse s'ndenje atje, po u barkarise gjer prapa diellit? Hë, pse? — u hakërrua mbledhësi i hekurishteve.

— Unë vajta në Pishkash, se më dilte hesapi më mirë dhe ti e di që kisha ca halle. Atje, në Pishkash, që ta marrësh vesh ti, unë punoja ditë e natë dhe më vente muaji mbi 10 mijë, nuk sorolatesha kot, si ti...

— Hajt, more, mbaj gojën! Ç'të hyn në qese ty se ç'bëj unë? Shiko punën tënde! — Dhe me të thënë këto fjalë, Reshiti vrëjti vetullat dhe u kthye nga ana tjetër, duke i lënë të kuptonte tjetrit se s'desh ta vazhdonte më bisedën.

Avniu heshti një çast. Pastaj u kollit dhe ja filloi me një ton tjetër, më të butë, jo fyes:

— Sot, Reshit, nuk thua dot se s'u duhet të tjerëve se ç'bën ti. Jo vetëm mua, që të kam fshatar, po edhe këtyre shokëve që s'të njohin fare, u duhet dhe u duhet të dinë mirë punën tënde e të kujtudo tjetri. E di ti se unë po kthehem në fshat për gjithnjë e jo me leje? Dikur u barkarisa, siç the me të drejtë ti, por sot po kthehem.

Reshiti e shikoi një hop si me habi, por s'foli e prapë ngrysi vetullat.

— Edhe ti, — tha Avniu, — duhet t'i përvishesh punës atje, në fshat. Nuk të ka hie të merresh me të tilla çikërrima prej mikroborgjezi.

— Unë mikroborgjez? Mua të më thuash mikroborgjez? Ti që i bije maces me lugë, kur unë... Eh, po kujt i them edhe unë.

— E di, e di, mos u nxeh. Ti ke luftuar e ke punuar shumë. Por tashti po hiqesh mënjanë.

— Unë jam në punë të shtetit!

— Posi, shteti është në hall të madh për kësi lloj punësh!

— Punën time e di partia, more vesh? Unë edhe dje vajta në Korçë me maqinën e sekretarit të parë, or karafil! Më pa në rrugë dhe e ndaloi maqinën, më plaçin të dy në të gënjej. «Reshiti ky?» thotë. «I tëri!» i them. Ai m'u hodh për qafë. «Po si e ke punën, mor Reshit? Si ja shpie?» më pyet. Unë ja tregoj një për një. «Reshiti është komunist i vjetër i thotë shoferit. — Po ku do të shkosh?» «Në Korçë», i them. «Hip!» më thotë ai. Dhe unë hipa. Tërë rrugës muhabet, që thua ti, më ftoi edhe në shtëpi, po mua më vinte zor e i thashë se kisha punë. E ti më thua mikroborgjez! Hajde, tyrtubek, hajde!

Reshiti u krekos, lëpiu buzët dhe i dha gjoksit përpara, sikur të desh të tregojë ndonjë dekoratë.

— E heq veten edhe komunist, pale! Ta dinte ai sekretari me se merresh ti!

— Po unë ja thashë, more kungull, kupton ti apo jo? Hej ky, ore!

Tjetri qeshi.



— Ja the, ja the, po si ja the pa! Njeriun e tregon puna, jo llafet. Kjo punë që bën ti, s'të nderon. Shikoni! — dhe Avniu tregoi me sy një unazë me rreth floriri e gur të kuq e të madh që vetëtinte si xhevahir, të cilën Reshiti e kish vënë në gishtin e vogël.

Dukej sheshit që e kish vënë atje për ta reklamuar.

Kisha dëgjuar diçka për këtë unazë. Më kishin thënë se i zoti i kërkonte 10.000 lekë. Kisha dëgjuar se ai që e kish këtë unazë, shiste edhe sendurina të tjera këso dore. Po nuk më ish dhënë rasti ta njihja shitësin.

— E ke patur këtë unazë apo tani e ke blerë? — pyeta.

— E kam patur, — tha Reshiti.

— Kjo është ajo unaza dhjetëmijëlekëshe?

— Paske dëgjuar? Kjo është. A dëshiron ta shohësh njëherë? — tha me interesim të madh. Me sa duket, kujtoi se tek unë kish gjetur një myshteri që ta shiste.

— Jo, — i thashë. — Nuk më duhet. Ne, të rinjtë, s'kemi nevojë për stoli të tilla. Këto i përkasin së kaluarës. A e di ti pse mbahet unaza?

Ai më shikoi me habi.

— Përse mbahet? Për stoli dhe si shenjë që rrëfen në je beqar a i martuar. Këtë e di edhe bufi! — tha.

— Bufi nuk i di mirë të gjitha, — i thashë — Dikur, kur martohej njeriu, i shtoheshin vuajtjet. Për atë që martohej, populli thosh se i vinte rreth të hekurt kokës. Unaza simbolizon atë rreth të hekurt. Martesa jonë nuk është si atëhere...

Udhëtarët diskutuan një copë herë për una-

zën e për martesat. Reshiti s'fliste fare. Ish kthyer mënjanë dhe dridhte me mundim cigare. Një e kish ndezur, një tjetër e kish vënë në vesh dhe një të tretë po e dridhte.

Pas pak u kthye e mori pjesë në bisedë. Tre- goi si kish luftuar e bëri çmos të hiqej si revolu- cionar.

— Ti nuk je më revolucionar, — i thashë.

— Unë?

— Po, ti. Mund të kesh qenë, por tani jo. Një revolucionar nuk merret me matrapazllëqe e ndy- rësira të tilla, por i vihet punës atje ku të jetë më vështirë.

Nuk m'u përgjegj fare. Dikush shtoi se si ish e mundur që s'i kishin ngjitur prapa kurrizit ndonjë fletë-rrufe një njeriu, që mblidhte mbe- turina e që vetë ish mbushur i tëri me të tilla. Po Reshiti as atij nuk iu përgjegj. Ai vazhdonte atë punën e cigareve dhe tymi krijonte një si mjegull para fytyrës së tij.

Pak më tej zbritëm. Rrugët tona ishin të ndryshme dhe u ndamë me një përshëndetje të ftohtë.

Kur mbeta vetëm, mendova mjaft për mble- dhësin e mbeturinave, por pastaj dikë takova dhe s'pata më kohë të merrem me të.

Më pas e kujtova edhe herë të tjera. Nuk më shkonte mendja të takoheshim prapë dhe isha shumë kureshtar të dija ç'do të bënte më tej.

Një ditë isha përsëri në udhë. Pranvera tani kish zënë vend mirë. Ecja dhe s'ngopesha dot së thithuri ajrin e kundërmuar me aromë lulësh e bari të njomë. Dielli sapo kish dalë. Ish një diell



rrezear, i ngrohtë e si i qeshur. Edhe dita dukej si e qeshur dhe e gëzuar. Po të mos kishin mbetur ato piklat e ujit mbi barin e njomë, po të mos qe e lagur toka dhe ajri aq i freskët, nuk do të besojë kurrë se të djeshmen kish rënë shi, aq i kulluar ish qielli.

Ecja, pra, plotësisht i kënaqur nga kjo ditë pranvere. Biletën e kisha marrë një ditë më parë. Duke ecur, shpesh shihja andej nga kthesa, ku duhej të delte kamioni — autobuz.

Ja ku u duk edhe ai. Po e ndiqja me sy.

Pas tij mbetej vetëm një fjollë mavi tymi. «Do të udhëtojmë për bukuri sot, -- mendova, — se shiu e ka larë pluhurin.»

Pas pak kamioni u ndal afër meje dhe unë u hodha lart. Dikush mezi më lëshoi pak vend. Kur po ulesha me mundim, duke u shtrënguar, dëgjova të më thonë:

— Njatjeta, o djalë! Si më je?

Ktheva kokën dhe pashë pranë meje atë njeriun me buzën e sipërme të përveshur.

— Reshiti! — sa s'thirra unë.

U përshëndetëm dhe një çast mbetëm pa folur.

— A e dredh njëherë? — më tha Reshiti. Pastaj shtoi:

— Më ka mbetur peng ai llafi që më the atë ditë në kamion.

— Cili llaf?

— «Ti s'je më revolucionar!» Tamam kështu më the. S'më hiqet nga mendja dhe u gëzova shumë që u takuam.

Nuk dija si t'i merrja këto fjalë. Kureshtja po më shtoej. Po edhe ai digjej nga dëshira të

më zbrazej, me sa duket, që unë ta ndryshoja mendimin për të. Gjersa vajtëm në qytet më tregoi ç'kish bërë më tej.

— Që kur u ndava prej jush e gjersa vajta në shtëpi, s'e hapa gojën fare, — filloi të më tregojë ai. — Ai llafi yt herë sikur ma shtrydhte kokën e herë më peshonte si gur në zemër. Ato të Avniut po ashtu. Dhe ai djall s'm'u nda. Shkuam bashkë e tërë udhës po atij avazi. A ma unë hiç, ë! Fol o gur, fol, o mur! Po s'i dëgjoja, thua? Ashtu bëja, se... unë e di si më cimbisnin ato llafet e tij! A të kujtohet si ja ktheva njëherë atje lart, mbi maqinë? Jo që të mbrohesh, ore, po se e pashë që s'ja delja dot. Pastaj më vinte edhe gjyç prej jush, se ai djall s'pyeste fare ku ish e më llafoste sikur të ishim vetë për vetë.

Që ta kam llafnë, vajta në shtëpi asaj dite pikë e vrer. Do ti, sa hyra në oborr, shoh një djalin tim të vogël zbathur! E të m'u errën sytë, or djalë... Edhe herë të tjera i kisha parë ashtu fëmijët e mi, po më dukeshin të shëndetshëm e s'më bënte përshtypje. Ehu, se mos ne ishim rritur më mirë! Po kësaj radhe jo, kësaj radhe s'e pashë me atë sy.

— Erdhe? — më tha gruaja sa hyra brenda. Kjo fjalë m'u dëgjua si ankim. E shikova me inat e për pak do t'ja kisha nxjerrë asaj tërë të keqen që më ish mbledhur lëmsh ja, mu këtu, në zemër, po e mbajta veten. As që fola fare atë natë. Po gruaja e fëmijët sikur s'bëheshin merak hiç që unë isha i mërzitur e që rrija ashtu, si tutkuni. Sikur isha i huaj për ta, ore, për besë! Le që edhe më parë unë s'para kam qenë aq i muhabetit. Ata ishin mësuar me këtë huqin tim e ndoshta s'u



bënte përshtypje, po mua, ama, më erdhi rëndë.

Të nesërmen dola njëherë nëpër fshat. Xhanxhin njeri për të këmbyer një llaf! Ish vakt pune dhe tërë ishin në fushë. Vajta gjer te dyqani. Edhe ai shitësi më hodhi ca llafe plot thumba. «Ti e ke më terezi, o Reshit, — më tha ai qafir. — Punë të rehatshme ke, para nxjerr plot...» E vështrova me të keq, po aty për aty e ktheu fletën kodoshi:

«Ç'do të na marrësh, Reshit? «tha. S'mora asgjë, po ika drejt e në shtëpi. Herët e tjera, ato ditë që rrija në fshat, më pëlqente të krekosesha ca, kurse atë ditë më erdhi turp dhe u futa në shtëpi, sikur të fshihesha prej ndonjë njeriu. Ja, kështu. Çdo gjë ndryshe po më dukej. A ke dëgjuar kur thonë se sheh mendja e jo sytë? Ja, mua sytë s'më kishin ndryshuar, po në kokë më rrihnin si çekan ato llafet tuaja, prandaj e vështroja ndryshe çdo gjë. Pse s'më kish thënë njeri më parë llafe të atilla? Po të më kish thënë, do ta kuptoja që më parë se ç'udhë kisha zënë. Ti më the qëpari se ku dreqin e kisha gjetur atë punën e mbledhësit të mbeturinave. Po ta rrëfej, se lidhet me këto që po llafosim.

Kur u bë kooperativë fshati ynë, mua, si njeri i luftës që isha, më bënë teklif e më vunë një vit brigadier, një vit tjetër në magazinë. Mirëpo e panë që s'ja thosha dhe më dhanë kazmën. Unë desha ndonjë punë tjetër, roje, fjala vjen, a stallier, po më thanë se kish të tjerë më nevojtarë. Mua atëhere, që thua ti, më dukej bytha dyfek. Kisha luftuar unë, ore, dhe të merrja kazmën... Ehu! Më dukej qameti.

Që t'i bie shkurt, një ditë isha në Korçë. Kur po prisja për ndonjë maqinë te parku, shoh se po

vjen një miku im me një kalë ngarkuar. Ai qesh-te duke m'u afruar, unë po çuditësia.

«More, me gurë apo me dru e ke ngarkuar hajvanin, që dalin këto xhunga e xipa nëpër thasë?» i them. Miku qeshi.

«S'e merr dot me mend kurrë, — tha ai. — Kam ngarkuar vjetërsira, hekurishte, e gjëra të tjera».

«Ore, mos ke lojtur mendsh?»

«Fol ti, fol, — më thotë, — kjo punë...» dhe, pa mbaruar llafnë, shkeli syrin e tregoi xhepin.

«Demek ka fitim?»

«Fitim e çfarë fitimi sel!»

Pastaj më mori e më shpuri te magazina, që thua ti. Me atë magazinierin e kish grurë. «Të solla një myshteri tjetër», i tha dhe, kur magazinieri po më shikonte, ai i pëshpëriti në vesh: «E kam mik, prandaj...»

U muarëm vesh atje që unë të shpija mbeturina të çdo lloji, po sidomos monedha bakri e bronxi dhe hekurishte.

Mund t'i blija me 10 lekë qillon e të kisha dy përqind fitim për vete.

Miku ma lojti mendjen dhe zura të shoh ëndërra me sy hapur. Ama kisha zënë një punë të tillë? Tashti të më shihnin ata të kryesisë! Se mos isha një palo njeri unë që të më hiqnin për hunde si t'ua desh qejfi?!

Më tepër isha i gëzuar duke menduar që do t'ua hidhja atyre, se sa për fitimin që më përballiste miku im.

E t'ja filloj unë, or byrazer, mblidh vjetërsira nga ishin e nga s'ishin, ngarko si hamalli dhe shpjer në Korçë. Në fillim zura para mirë, se, ty



po ta them, ja hodha atij magazinierit. Hekurish-tet i kisha rjepur andej-këtej, por atij ja shita si-kur i kisha blerë. Kështu i mora 10 lekë për qi-llo, që i njihte shteti, shtoju këtyre edhe fitimin që më takonte mua, bëhej një doçkë e mirë! Ama do të thuash ti se kisha gënjyer! Po pse, ç'hum-bje kish shteti? Po sikur t'i kisha blerë vërtet? Punë për mua në kisha mundur t'i mbledh ba-dlava. Kështu më thosh kjo radakja ime në atë kohë.

Mirëpo të gjithë nisën të më shohin me sy të keq. Sikur u bëra tjetër njeri në sy të tyre. Edhe vetë e ndjeja se s'isha më ballëhapur si më parë dhe, me gjithë paratë që fitoja, shpirtin s'e kisha të qetë. Ftohtësia e tyre më rëndonte, heshtja më nevrrikoste.

Po prapë qëndroja më timen. Mirëpo ja ku erdhi rasti e bëmë edhe ato muhabetet që ti i di.

Një ditë më vinte turp të rrija jashtë, nëpër fshat. Kisha nisur ta kuptoj se s'isha në terezi, po njeriu s'heqka dot dorë kollaj nga një gjë që është mësuar. Të nesërmen mora torbën e thesin dhe dola përsëri fshatrave.

Shkuan edhe ca ditë. Unë gjithë po atë punë. Tani veç më vinte zor të thërrisja si më parë: «Hekurishte, vjetërsira, pore të vjetra kush ka! I blemë, i blemë! Mangëre, hekurishte!»

Pse më vinte zor? As unë s'e kuptoja. Megjith-atë, megjithatë, s'vendosja dot. Po dje më erdhi në majë të hundës. Kur po shkoja nëpër rrugën e një fshati, më dolën përpara ca fëmijë e njëri më thotë: «O xhaxho, ne s'kemi mbeturina fare!» «Hajt, këput qafën, qafir! Xhaxho më bëre ti mua?» i them. Ata shejtanë qeshën. «Po ç'je, pa

na thua j njëherë? Ti mbledh vjetërsira. Me këtë punë s'merren të rinjtë!»

Epo, mjaft! Edhe fëmijët do të tallen me mua? Jo, s'duroj dot më! Mirë e kish Avniu. Ai e bëri si burrat, kurse unë... Hej, s'ke ç'i thua, s'paskam qenë revolucionar i vërtetë, mirë e the ti. E bëra, kur thonë, si ajo nusja: «Për inatin e sime vjehrrë, do të shkoj me mullixhinë!»

Tashti e vendosa. Do t'i kthehem edhe unë fshatit. Do më duhet të rri ca kohë kokulur kur të më hedhin ndonjë romuz, po, ama, do të heq dorë njëherë e mirë nga tërë mbeturinat si të gjërave që mblidhja, ashtu dhe të mendjes. Po vete t'u them në Korçë që të mos presin më asgjë prej meje. Dhe në më thënçin që ma kanë nevojën — le që ç'më duan! — në më thënçin, do t'u them t'i porositin mësuesit dhe ata e bëjnë fët e fët këtë punë me fëmijët. Ca kohë unë e di si jam dredhur nga frika se mos u shkonte mendja e të ndiqnin shembullin e atyre të qytetit. Po tashti, siç e sheh, po shkoj vetë t'ua kujtoj këtë».

Kur mbaroi së treguari Reshiti, maqina jonë gjysmë e hapur kish përshkuar Unazën e Korçës dhe u ndal te agjensia e udhëtarëve. Zbritëm dhe u shkundëm nga pluhuri i rrugës. Pastaj secili u nis në drejtimin e tij. Reshiti më përshëndeti dhe me hap të nxituar ja mbajti nga magazina e grumbullimit të vjetërsirave. Shkonte drejt, pa kthyer kokën andej e këtej, si një njeri që mezi pret të mbarojë një punë të madhe e me rëndësi, e cila e ka shqetësuar mjaft kohë.



## G J A H U

Guri po mbushte fishekët e gjahut. Vëllai i tij i vogël, Maqua, bënte çmos për ta ndihmuar dhe herë pas here e pyeste:

— A do të më marrësh edhe mua, Guri?

Guri vrëjte vetullat e vazhdonte me zell e seriozitet punën e tij. Në vend që t'ja kthente përgjigjen djalit të vogël, i bënte ndonjë vërejtje, si për shembull: «Këtij fisheku i ke hedhur shumë barut!» ose: «Ngjishe edhe ca tallashin!»

Djali i vogël bënte siç i thosh ai, po ish i mërzitur. Dukej sheshit që i vëllai nuk desh ta merrte. Po pse nuk ja thosh hapur? Ai guxoi edhe njëherë:

— Guri, ti më ke premtuar kaq herë... ne s'kemi shkollë nesër...

— Pa shih, bie akoma dëborë? — e ndërpreu i vëllai.

Maqua doli në oborr.

— Bie, — tha.

Guri desh të sigurohej më mirë. Doli në treme e pastaj në oborr. Dëbora binte qetë-qetë, pa zhurmë. Bardhësia e mjegulluar sikur ja shtonte natyrës heshtjen. Nga një dritare dilte një fashë drite dhe

atje dukej sikur flokët e dëborës ndiqnin njëri tjetrin.

«Ah, sikur të pushojë gjer nga mesi i natës!» psherëtiu ai.

Kur u kthye në dhomë, vështrimit pyetës të vëllait të vogël, iu përgjegj rëndë-rëndë:

— Ka të ngjarë të mos vemë fare nesër, se, po të bjerë dëborë gjer afër mëngjezit, lepurat s'lëvizin fare. Po të vemë, do të të marr!

Maqua kaq desh. Ta shihnit se si filloi t'i punonte mendja tek ata lepurushët veshëgjatë që do të vrisnin të nesërmen!

Aty e kish mendjen edhe Guri. Kujtonte vendet ku rrinin më tepër lepurat, i bëhej sikur e shihte njërin përpara e një tjetër tek vidhej atje më tutje.

Atë natë pa në ëndërr sikur një lepur i rrinte përpara. Ai e qëllonte, po krismë s'dëgjohej fare e lepurit s'tundej nga vendi, bile i shkundte veshët si të tallej me gjuetarin.

Guri u zgjua i shqetësuar. Sapo kish aguar. Ai u ngrit, pasi e zgjoi edhe të vëllanë. Dëborë kish pushuar që në mbrëmje. Koha veçse ç'ish për gjah! Vetëm duhet të delte me natë. Atë e hante merakun se mos ndonjë gjuetar tjetër, Nesti, fjala vjen, kishte vajtur më parë në ato vende ku mendonte të shkonte Guri.

U përgatitën shpejt e shpejt, muarën edhe qenin dhe ja mbajtën përpjetë nga vreshtat.

«Andej është përballë diellit dhe lepurat e pëlqejnë shumë atë vend,» tha me vete.

Nëpër rrugët e fshatit s'kish shkuar asnjëri. Rruga e ngushtë, e hapur në dëborë, dukej si një



kanal kullues që ka zënë tinë<sup>1)</sup>. Fshati dukej i heshtur, si i përgjumur, dhe tymi i oxhaqeve të porsandezur ngjitej lart si me përtesë. Atje poshtë, te lumi, u dëgjua krisja e një akulli, ndërsa një shelg i ri u shkund nga dëbora e rëndë dhe maja e tij fishkëlleu në ajrin e ftohtë, ngaqë u çlirua prej asaj peshe shtypëse.

Frynte një erë me cingërimë. Andej nga lindja qielli ish ndezur flakë.

Djemtë shkonin njeri pas tjetrit. Guri shfrynte me vete, sepse një grua që hapte portën, u kish thënë «Udhën e mbarë!»

E ç'i duhej asaj? Më mirë të mos kish folur fare! Ku dreqin kish gjetur kohën për ta hapur portën tamam kur shkuan ata atje!

Por, në këtë kohë dalloj para tij gjurmë në dëborën virgjër. Ai nxitoi. Gjurmët ishin në formë trekëndëshi, e me kërcime. Gjurmë lepuri! Kaq shpejt? Vetvetiu Guri hoqi çiften nga krahu dhe me sy po ngutej të shihte nga shkonin ato gjurmë. Qeni futi kokën në dëborë dhe s'mbahej dot. Duket era e lepurit ish e fortë dhe ja çante hundët.

— Mos e lësho! — tha Guri. — Shtrengoje fort zinxhirin dhe kij kujdes. Ta shohim njëherë nga ka shkuar e ku mund të ketë zënë vend. Ka shumë dëborë e këtu afër e kemi.

Pastaj filluan ndjekjen e gjurmës. Guri ecte përpara me çiften ndër duar. Shkonte larg gjurmëve, sepse e dinte që lepuri, që atje ku zë vend, shikon vetëm gjurmët e tij.

«Duhet t'i vemë papritur, — thosh me vete

---

1) tinë = lym, balte që bie në fund të lumit

gjahtari, — ndryshe ai ngrihet pa iu afruar mirë ne, ose vidhet.»

Kishin arritur te një rrëzim. Atje poshtë kish ca ferra. Lepuri kish bërë disa kërcime të gjata. Gjahtari hodhi një vështrim më tutje, duke kontrolluar me sy vendin. Gjurmët s'kishin dalë përtej përroit. Atij filloi t'i rrihte zemra me vull.

«Këtu do të jetë!» tha.

I bëri shenjë Maqos që të shkonte pas gjurmëve, ndërsa vetë doli më lart e zuri vend që, kur të hidhej lepurit nga ferra, t'i binte.

Vendi që zgjodhi ish i përshtatshëm. Ngado që të shkonte lepurit, çiftja e hante që atje. Me gishtin në këmbëzën e çiftes rrinte i gatshëm me muskuj të tendosur.

Maqua i mori ferrat me radhë, po lepurit s'doli gjëkund. Djali i vogël po e pyeste me shenja dhe Guri habitej. Pse s'dilte lepurit? Ku drejtohet lepurit zënë vend?

«Ah, sa shejtanë, që janë ata! Sa mirë dinë ta zgjedhin vendin! Prite tani kur të dalë sapo të vete unë poshtë!» thosh me vete. Eh, edhe ai Maqua! Po ç't'i vinte faj? Ai ish i vogël. Që të ndjekësh gjurmët e lepurit e t'i kuptosh shejtanllëqet e tij për t'i fshehur ato, sidomos kur përpiqet të zërë vend, nuk është e pakët, do mjesh-tëri.

Guri bëri hy hapa për të zbritur poshtë, pas-taj ndërroi mendje. E pse të heshtnin? Tani le të dëgjonte lepurit e të ngrihej. Ai atë desh. I thirri Maqos që të shikonte me kujdes ku kish kërcyer lepurit. Në këtë kohë Maqos po e tërhiqte qeni që i kish diktuar gjurmët. Guri ndoqi me sy drejtimin nga mundahej të shkonte qeni. Atje lart,



buzë përroit, iu duk se kish shkarë ca dëborë. Oh, po! E si nuk e kish parë vetë? Lepuri kish ikur pas përroit.

«Eh, ai kushedi ku është, kurse ne po e presim të dalë këtu!» tha me vete. «Apo mos na është vjedhur tani?» shtoi dhe rendi në krye të përroit. Atje dalloj se gjurmët ndiqnin vazhden e zakonshme, duke formuar një si zinxhir në dëborë.

«Po të kish dalë tani, gjurmët do të ishin me kërcime të gjata», tha ai dhe i thirri të vëllait.

Kur vajtën te një përrua tjetër, gjithë duke ndjekur gjurmët e lepurit, Guri vuri re se ai i kish prerë ato.

«Do të të gjejmë, or shejtan, s'ke ku na vete!» tha i gëzuar gjahtari i ri. Dhe përsëri zuri të shihte me vëmendje.

Rreth e rrotull dëborë ish e pacënuar.

«S'mund të ketë ikur edhe prej këtej, tërë shenjat tregojnë se ka kërkuar vend», tha ai me vete dhe bëri ca hapa më poshtë. Atë çast, mu nën këmbët e tij, u dëgjua ajo zhurma ngjethëse që bën driza kur kërcen lepurit. Guri e pa tre hapa larg tij. Lepuri bëri përpjetë, pastaj u kthye e mori poshtë. Gjahtari qëlloi, po gjahu s'mbeti. Kur mori Guri shenjë për së dyti, lepurit ish fshehur nga sytë e tij, sepse qe hedhur në përrua. Guri nxitoi të delte në krye të përroit, po mundimi qe i kotë. Lepurit kish marrë tatëpjetë e kish dalë tutje.

«Ta marrë dreqi! — tha ai. — Eh, gjithnjë nxitohem! Apo s'më ecën fati? Unë mirë ja mbajta dhe lepurit sikur i uli veshët kur e qëllova. Ndoshta është plagosur!» E kish këtë të metë ai: nxitohet. Sidomos kur gjahu i delte afër, i dukej sikur do t'i ikte kot dhe qëllonte. Kështu i ndodh një gjahtari të ri. Ai

kish vjete që vente për gjah, po tronditjen s'e kish mposhtur ende. E dinte mirë se, edhe në kish vrarë në raste të tilla, kishte vrarë se ashtu kish qëlluar, e jo se kish marrë shenjë mirë. Ndryshe ish kur ja sillte qeni që larg. Atëhere rrinte gjakftohtë. E shoqëronte lepurin me çiftin në sy e gishtin në këmbëz dhe, kur i mbushej mendja, e shkreppte. Rrallë i shpëtonte lepur në këto raste. Kur lepuri vinte drejt tij duke vrapuar, siç mund të vrapojë vetëm lepuri i ndjekur, Guri i dukej sikur krijohet një shirit i drejtë, që zgjatej e zgjatej me shpejtësi të madhe, si tymëset kimike. Kjo ndodh sepse syri përqëndrohet te lepuri dhe ky xhvendoset me aq shpejtësi, sa që figura e tij e disa hapave të mëparshme nuk shlyhet lehtë nga pamja e përgjithshme e vështrimit.

Kur lepuri mbetet i vrarë, ky shirit ndërpritet menjëherë. Kënaqësinë më të madhe të gjuetisë Guri e ndjente pikërisht në çastin e këputjes së këtij shiriti, që krijohet para syve të tij.

— Maqo, lëshoje qenin! — thirri Guri.

Në çast qeni e mori gjurmën dhe të lehurit e tij u dëgjua larg. Guri priti një copë herë që të kthehej lepuri, po i vëllai i tha se po vërtitej te kodra tjetër e ai u nis për atje. Lepuri ish larg. Ai e pa vërtet te kodra matanë. E hodhi çiftin në krah dhe vazhdoi të ecte. Kish shkrepur dielli e dëborat t'i vriste sytë. Duke rrudhur qepallat ai ecte me plogështi. Papritur vuri re se po shkëlqente në ca gjurmë taze. Atje të kish shkuar lepuri? S'ish e mundur! Ai do ta kish parë. Mos ish tjetër?

Që të sigurohej, Guri zbriti më poshtë. Atëhere dalloi plot gjurmë që më parë s'i kishin rënë në sy. Ja edhe dy kërcime të gjata. Ai shkoi pas tyre. Nën



një shkurre të vogël dukej strofka ku kish qenë lepuri. Guri shkoi më tej. Po ta kish patur mendjen, do t'i dallonte gjurmët, vendi veç se ç'ish!

«Ters po më vete sot, shumë ters!» tha ai.

«Po njerin nga këta do ta vras pa tjetër, në mos të dy!» shtoi.

Shkoi pas gjurmëve të reja. I ndoqi me sy. Lepuri kish marrë një tjetër drejtim.

«Këtë do ta ndjek më pas», mendoi ai dhe ja mbajti drejt kodrës, ku lehte qeni i tij. Por, sa shkoi pak më tej, përsëri ra në gjurmët e lepurit, që i qe vjedhur.

«Qenka kthyer! Këtu do të jetë!» tha dhe prapë zemra filloi t'i rrihte me vrull. «Ah, kjo tron-ditje e drejtit!» Ai qëndroi pak sa të qetësohej, pastaj bëri gati çiftin dhe vazhdoi kërkimin.

Ja ku e pa lepurin! Tani e kish larg. Guri mori shënjë kokën e lepurit, e shoqëroi pak me çiftin në sy dhe qëlloi. Lepuri uli njërin vesh, u duk sikur u shtri, po ja ku iku përsëri me vrap. Guri e qëlloi edhe njëherë. Lepuri ndryshoi drejtimin, po vrapin s'e ndali. Ajo vija si shirit s'u ndërpre.

Gurit i erdhi inat dhe shau me vete fatin e keq të asaj dite. Mirë i kish dalë ky lepur, s'ish nxituar fare, kish marrë shënjë mirë, po...

Kur vajti atje ku lepuri kish ulur veshin, pa disa kokrriza dëbore të skuqura me gjak. Më tej kish edhe të tjera.

«Qenka plagosur!» — tha dhe rendi.

Lepuri vërtet ish plagosur, po s'kish mbetur. Me sa dukej, kish marrë ndonjë plagë të vogël.

— Këtej, këtej, hajde këtu, o Guri! Këtu janë të dy lepurat, po vrapo! — thërriste Maqua.

Guri u mundua të vraponte, po dëbora mezi çahej. Ish lodhur, djersët i rridhnin rrëke nëpër fytyrë.

Kur iu afrua Maqos, ky nxitoi t'i sqaronte me një frymë:

— Ja, mu këtu më erdhi lepur, Guri! Ah, sikur të ishe ti! Ish një lepur i madh si shqerrë! Njerin vesh e kish të varur. Mua s'më pa fare. Qëndroi ja, atje ku je ti. Ah, sikur ta kisha çiften! Po ti ç'u bëre, more! Edhe tjetri më dolli përpara mua.

Guri s'përgjigjej.

— Po si s'e vrave dot? Ama ai është plagosur! Këtu ku qendroi, shikoje, është skuqur dëbora nga gjaku! — dhe Maqua tregoi vendin e skuqur. Guri e pa, por s'i vuri rëndësi.

— Do të ketë ndonjë plagë të lehtë! — tha i dëshpëruar.

Ndërkaq u dëgjua lehja e shpeshtuar e zagarit. Guri u pregatit. Zagari i tij lehte kështu vetëm kur e kish lepurin afër. Dhe vërtet lepurin e kish afër, po ai shkoi nga ana tjetër. Guri e pa, por atje ish e kotë të qëllonte.

Më pas kodra rreth e përçark u bë tërë gjurma e s'merrej vesh më asgjë. Qeni mundohej, po era e lepurave ngatërrohej e ai s'ja gjente dot fillin. Djemtë u vunë të kërkonin edhe vetë. Njëri lepur kish shkuar në korien ku kish dushk. Atje vajtën edhe djemtë.

Pas pak ishin larguar mjaft duke u futur thellë në korie.

Maqua kish mbetur prapa.

«Shko poshtë ti», i kish thënë Guri që të mos lodhej shumë. Vetë kish marrë lart.

Të dy lepurave ua kishin humbur gjurmët. Ai



ish munduar shumë mbas tyre. Pastaj e kish humbur shpresën t'i gjente prapë. Tani shpresonte të gjente një tjetër dhe këtë ta nxirrte zagari. Lapi, zagari i tij, shkonte poshtë, ndërsa ai vetë, lart. I lodhur e i mërzitur, i dëshpëruar që s'i kish ecur fati, mezi e çante dëborën e trashë. Në korie nuk zinte dielli mirë dhe gjatë dimrit s'kish lojtur fare dëbora. Ishin krijuar disa shtresa dëbore, secila e ndarë prej tjetrës me një cipë të fortë, të ngrirë. Këto e pengonin shumë ecjen. Guri e fuste këmbën dhe pastaj mezi e shkulte. Duke ecur me mundim, arriti deri te një përrua i vogël, ku gurgullonte një vijë uji. Uji kish tretur dëborën që kish rënë mbi të, dhe e kish gërryer atë të anës. Dëbora, e prerë kështu në të dy anët, dukej si mur.

Guri kërceu në vendin ku ish tretur dëbora dhe e ndjeu veten shumë të lehtë. Deri në atë çast kish parë dëborë dhe vetëm dëborë. Në korie kish parë edhe lisat të ngarkuar prej saj. Kur e kur ndonjeri prej tyre ngrinte majën lart, duke shkundur dëborën e mërzitshme. Zhurma që shkaktonte ky çlirim, zhdukej në çast, sikur ta përpinte dheu, dhe kudo sundonte një heshtje aq e madhe, një qetësi aq e pakëndshme, sa të dukej sikur krejt natyra ish e vdekur.

I mësuar me këtë përshtypje, Guri buzëqeshi vetiu dhe psherëtiu i lehtësuar kur u ndodh te kjo vijë uji. Uji ish i kulluar e i tejdukshëm. Në vijë dukeshin guralecët. Duke shkuar nëpër to, uji gurgullonte me ëmbëlsi. Në tërë atë hapësirë të heshitur, Gurit iu duk se vetëm te kjo vijë uji ish mbledhur jeta, sikur vetëm ajo vijë jetonte. Dhe gurgullima e ujit ish e vetmja këngë, i vetmi tingull jete në atë vend si të shkretë.

Kur ndodhej te përroi dhe po shikonte ujin e kulluar, dëgjoi një krismë andej nga kish shkuar Maqua.

Ai mbajti vesh. Krismë tjetër s'u dëgjua.

«Do të jetë Nesti. E vrau me siguri», tha me vete duke ndjerë zili për gjahtarin tjetër fatmadh.

Befas përroin para tij e kapërceu një lepur. Atij iu duk sikur lepuri ra brenda, po në të vërtetë kish shkarë dëbora. Duket lepuri s'kish kërcyer dot sa duhej. Guri vuri çiftin në sy, po, kur do të hiqte këmbëzën, pa se lepuri qëndroi, u kthye nga kish ardhur, shikoi një çast, pastaj u shtri anash dhe zunë t'i dridheshin këmbët. Pas pak edhe kjo dridhje mbaroi: lepuri i shtrirë s'ndihej më.

Guri e kuptoi si qe puna. Lepuri qe plagosur e aty i ishin prerë fuqitë.

Tani ndodhej veç disa hapa larg tij. Guri kish gjithë ditën që po mudohej e s'kish vrarë dot asnjë. Të ish vetë, nuk do t'i bënte aq përshtypje, po ku kish qëlluar atë ditë fat i keq, kur ai kish marrë me vete edhe atë shejtanin, Maqon! Prej tij i vinte zor. Kaq e kaq herë i kish treguar me mburje historira gjuetie, kurse këtë radhë që ish bashkë me të, s'kish vrarë dot. Tërë kohën kish menduar vetëm për gëzimin e djalit të vogël kur të merrte lepurin e vrarë. Tani që s'kish vrarë, mendonte me dëshpërim se si do të rrinte i heshtur në mbrëmje, se ashtu rrinte kur gjahu s'i shkante mbarë.

Tërë ditën po ankohej ndaj fatit dhe ai ja ku ja kish sjellë gjahun të vrarë, mu te çanta!

Tundimi i tij qe i shkurtër. Fundja edhe atij kushedi sa lepura të plagosur i kishin humbur ose ja kishin marrë të tjerët. Pastaj ky lepur kish ikur shumë dhe gjahtarit tjetër as që i shkante mendja



se kish mbetur i vrarë. Që të ndjehej më i çfajësuar, atij i shkrepni në kokë një djallëzi tjetër: vajti te lepurit duke shkëlur pas gjurmëve të tij, e mori atë dhe shkoi edhe më tej. Atje e shkrehu njëherë çiften kot dhe doli në majë të kodrës. Që andej pa Nestin e Maqon poshtë, rrëzë korijes. Diç bisedonin e shikonin atje ku kish qëlluar Nesti, duket.

Duke ngritur lepurin e vrarë lart, Guri thirri:

— Maqoo! Hajde, se e vrava një!

Në këtë çast vajti tek ai edhe qeni. Guri i hodhi një copë bukë atij duke thënë me zë të lartë, me qëllim që të dëgjonte Nesti:

— Na, bre Lapi se sot e bëre si burrat. Hë, më të lumtë, si ma solle këtë kodosh!

Kur hodhi vështrimin poshtë, pa se Maqua po vinte drejt tij, kurse tjetri iku poshtë. Guri këtë desh. U mbështet në rrëzë të një lisi të çlodhej gjer të ngjitej i vëllai. Por tek e shihte Nestin të largohej, dyshoi se mos ai e kish kuptuar hilenë. Pse s'ish ngjitur edhe ai? Pse s'i'sh interesuar fare ta pyeste Gurin si e kish vrarë, siç ndodh zakonisht me gjahtarët? Ç'bënin atje poshtë me Maqon? Mos kish gjak atje?» «Po ai as që më pa fare», tha i çfajësuar Guri që priste edhe më keq. Ai priste që Nesti të ndiqte gjurmët e lepurit të plagosur. Guri ish përgatitur edhe për këtë. Do t'i thosh se e kish parë lepurin të vinte drejt tij, pasi e kish vënë përpara zagari. Do t'i thosh se s'kish dëgjuar asnjë krismë.

Po ai shejtani, Maqua, ç'po bënte atje poshtë? Pse s'po dukej akoma? Mos kish vajtur gjer atje ku kish mbetur lepurit? Ej, dreq! Ai nuk ish munduar fare t'i zhdukte gjurmët.

Atë çast Guri ndjeu se s'ish aspak i kënaqur.

Gjahtari kënaqet kur e vret vetë gjahun dhe, për më tepër, kur e vret me vështirësi. Sa për mishin e gjahut ai mendon vetëm gëzimin e pjesëtarëve të familjes.

Këtë provonte tani ai. Një ngushëllim të madh ndjente sedra e tij e fyer nga veprimi që kish bërë, kur mendonte kënaqësinë e Maqos.

Po sa u çudit kur vuri re se Maqua nuk u gëzua fare! Guri e shikonte buzëgaz tek afrohej; ja dha lepurin dhe i tha me mburrje.

— Ama, i madh është, ë! Ja ku e kanë marrë saçmat, në kokë e në kërbishte. Çiftja jonë i lëshon si zinxhir.

Maqua shikonte si me dyshim e buzëqeshte me pahir. Nja dy herë u mat diç të thotë, po i vëllai s'i la rast, se nxitoi:

— Po merre, more, ç'rri kështu? Do ta hedhësh në krah, apo do ta futësh në çantë?

Dëshira e Maqos ish që lepurin e vrarë ta hidhte krahëqafë, që t'ja shihnin gjithë shokët në fshat. Ai këtë çast kish ëndërruar e dëshiruar gjithë këto ditë. Po tani me gjysmë zëri tha se do ta fuste në çantë.

Pas pak u nisën. Guri tha të delnin nga Padinat e që atje të zbrisnin në fshat. Ish e pamundur të mos gjenin lepuj të tjetër ose thëllëza andej.

I kish bërë përshtypje qendrimi i të vëllait. E kish marrë me mend se ai e kish pikasur, po s'e bëri veten. Me mend vendosi që, po të vriste ndonjë tjetër, do t'ja dërgonte këtë lepur Nestit e do t'i thosh se ai vërtet e kish vrarë, po të plagosur, prandaj i takonte atij që e kish plagosur.

Mirëpo nuk vranë dot lepur tjetër, sadoqë u munduan gjersa perëndoi dielli.



Kur u kthyen në shtëpi, ishin shumë të lodhur, të dërsitur e të lagur. Ata u ndëruan e u ngrohën, po të dy s'flisnin fare. E ëma dhe të motrat i ngisnin kur e kur, po ata rrinin të ngrysur. Sa herë mundohej Guri t'i hidhte ndonjë vështrim studjues të voglit, ky sikur t'ja kish vjedhur mendimin, e shikonte me bisht të syrit. Gurin e tronditte ky vështrim i tërthortë. Para se të hynin në shtëpi, Maqua kish guxuar e i kish thënë:

— Ky lepur s'është yni.

Guri e kish sharë, pastaj ish përpjekur t'ja mbushte mendjen duke sajuar një histori të tërë, por dukej sheshit që djali s'i zinte besë.

Po sikur të mos e kish pasur fare Maqon me vete? A do ta merrte lepurin e shokut? Jo, nuk do ta bënte këtë! Po edhe sikur ta bënte këtë, nuk do ta dinte njeri.

Kështu mendoj njëherë. Po pas pak e kuptoj se kot ish munduar të gënjente veten. Ai përsëri do të ish i mërzhitur nga një gjah i tillë. Nuk do të gjente qetësi, nuk...

Guri pa se i vëllai e mori lepurin ta ripte. Kur hasi vështrimin e tij, në të sikur lexoi: «Si thua? Po të them për të fundit herë që s'është yni ky gjah!»

— Mos e rip, Maqo! — tha Guri.

Ai u vesh, e mori lepurin dhe doli. Pas pak trokiti në portën e Nestit. Kur e hapi ky dhe po habitej nga kjo vizitë e papritur, Guri ja zgjati mu para fytyrës lepurin e vrrarë duke thënë:

— Merre, është yti!

Tjetri s'po e mblidhte dot veten.

Guri ja lëshoi gjahun në këmbë, i uroi natën e mirë dhe u largua, para se shoku i tij ta hapte gojën e të sqarohej.

## «ÇILIMIU»

Ish kohë dreke. Punëtorët e frutikulturës po bënin pushim. Kishin ndenjor në anë të fidanishtes me mollë të egra ku bënin shartime me syth. Atje qe edhe Qaniu, brigadieri i tyre. Duke biseduar, ai priste kleçka me thikën e mprehtë të shartimit. Mënyra si e përdorte thikën e si fliste, sytë e tij të vegjël e tepër të lëvizshëm, fytyra e hequr e me mjekër të mprehtë, e tregonin një djalosh energjik, që s'rrinte dot pa bërë diçka.

— E pse të mos e presim fare filizin e egër? Kështu do të rritet më shpejt e më mirë i riu, — tha njëri nga djemtë.

Nevruzi, një burrë vetullzi, mesatar nga trupi dhe pak i kaluar nga mosha, nxitoi të përgjigjet:

— S'bën, — tha ai, — se lëngu s'ka ku të qarkullojë dhe e prish sythin.

— Jo, — tha Qaniu duke vënë buzën në gaz si pa i dhënë rëndësi kësaj bisede — sythin nuk e gjen gjë. Ai, përkundrazi, do të ketë ushqim të bollshëm e do të hidhet përpjetë, mirëpo nuk arrin dot të forcohet e kështu dëmtohet nga dimri. Kur nuk pritët filizi mëmë, sythi vetëm sa zihet e mbetet ashtu në një gjendje. Në pranverë, pastaj, hidhet përnjëherësh e zhvillohet shumë shpejt.



Nevruzi u prish në fytyrë. Kështu kish ndodhur shumë herë. Shpesh, kur ai, që ish marrë shumë me pemët dhe e hiqnin për specialist, çfaqte ndonjë mendim ose këshillonte ndonjë punëtor, Qaniu thosh të kundërtën. Dhe gjithnjë ja kthente ashtu, duke nënqeshur me mospërfillje, sikur e bënte me qëllim, për ta fyer. Ai e kish prej natyre një sjellje të tillë, ta thosh troç mendimin e tij, pa marrë parasysh rrjedhimet. Këtë cilësi e kish fituar në shkollë, ku i këshillonin gjithnjë që, kur ishin të sigurtë për diçka, të mos druheshin për ta thënë hapur kudo e me cilindo që të ishin. Qaniu i çmonte shumë këto këshilla më tepër se ato pajtoheshin me karakterin e tij. Mirëpo Nevruzi nuk e kuptonte në këtë mënyrë kundërshtimin e Qaniut. Ai thosh më vete se brigadieri «kërcente si krimbi në gjizë» dhe se nuk durohej.

Mendimin e tij Qaniu e shprehte qetë e me siguri të madhe. Punëtorët tundnin kokën në she një pohimi duke e kuptuar drejtë, ndërsa Nevruzi skuqej nga turpi, e ndjente veten të fyer e të poshtëruar, e urrente brigadierin e disa herë që bërë gati t'ja ngjishte një pëllëmbë të mirë asaj fytyrës së tij të hollë prej çilimiu, me atë nënqeshje, që i dukej aq tallëse e therëse. Po gjithnjë frenohej, se nuk desh të bëhej shkaktar zënie. Zakonisht e gëlltiste inatin e s'fliste fare. Por këtë radhë s'iu durua:

— Ti hiqesh sikur i di të gjitha më mirë se të tjerët, — tha. Unë kam tërë jetën që merrem me pemët, kurse ti po na shet mend! Ca mistrecave të tillë mendjemëdhenj u bien pendët shpejt, po sa para bën...

Për çudi, Qaniu vazhdonte të buzëqeshë si me mospërfillje. Jo, Nevruzi nuk desh t'ja shtonte këtë buzëqeshje, që s'e duronte dot! Ai desh ta nxehte «Çilimiun», siç e quante brigadierin, ta poshtëronte, të mernte hakun. Po, kur e pa përsëri duke ndenjtur mospërfillës, sikur të mos i bënë fare përshtypje fjalët që kish dëgjuar, e ndjeu veten edhe më të fyer. I shikoi me radhë të gjithë punëtorët me shpresë që të gjente përkrahje tek ata, por e kuptoi shpejt se gjykimet e djaloshit atyre u dukeshin me vend.

Atëhere u xhindos fare. U ngrit rrëmbyer, e hodhi thikën në tokë e tha:

— Merre! Nuk punoj më me ty! Dhe të shohim sa mbarë do të të venë punët!

— Ti u nxehe kot, — tha Qaniu. — Sa për punët, hiç mos u bëj merak.

Nevruzi s'dëgjoj fare. Ai ish larguar e po ikte me kokën lart e me vështrimin e egër të ngulur përpara.

— Më mirë kështu, — tha njëri. — Ai këtu e ndjente veten të përulur. Më mirë le të punojë në një brigadë tjetër.

— Është burrë i mirë e punëtor i madh, por ja ka ca qejfi të bëhet ashtu si thotë ai, — shtoi një tjetër.

Të tjerët pohuan me kokë.

\* \* \*

Kjo zënkë nuk qe e rastit. Njerëzit nuk zihen me gjithë mend për gjëra kaq të vogla. Po zënkat e tilla janë vetëm shkas për të shfrenjtur dufin, që ka shkaqe të tjera, më të mëdha.



Këtë radhë Nevruzi «e kish lëshuar brezin për sherr.»

Kjo zënkë e vogël shërbeu si shkak që ai të largohej nga frutikultura, ku e ndjente gjithmonë veten të fyer e të poshtëruar...

Ca kohë më parë, Qaniu kish mbaruar tekni-kumin bujqësor dhe qe emëruar në kooperativën bujqësore të fshatit të tij. Në atë kohë, përgjegjës i frutikulturës ish Nevruzi, të cilin në fshat e mbanin për burrë merakli e që i vinte ndoresh për punë pemësh.

Si u emërua Qaniu në kooperativën e tij, një mbrëmje kryetari i tha Nevruzit:

— Qaniu është specializuar për frutikulturë. Si thua, Nevruz, hə? Mos e merr për keq. Ne kemi menduar që ai të jetë përgjegjës në këtë sektor, ndërsa ty do të të lëmë brigadier të frutikulturës. Ti ke punuar mirë, ne e dimë, e duhet ta ndihmosh atë, se helbete ti ke praktikë, kurse ai sado të dijë është i ri, sapo doli nga bankat e shkollës.

Nevruzi s'kundërshtoi fare. I erdhi ca rëndë që do të urdhërohej nga një çilimi, po s'e bëri veten. Tha se pranonte e se do ta ndihmonte pa u kursyer përgjegjës in e ri.

Të nesërmen Qaniu filloi nga puna.

Në fshat atë e njihnin për djalë ters, nga ata që s'lënë dy gurë bashkë. Kur vinte për pushime në verë, ai gjithnjë do të gjendej në krye të fëmijëve çapkënë. Andaj, kur u kthye me diplomën e agronomit të mesmë në xhep e u caktua përgjegjës i frutikulturës, shumë ishin që çfaqën mosbesim.

— Ç'mund të presësh nga një çilimi? Ai do t'i mbledhë shokët dhe do t'i shpien dëm tërë pemët,

ja të shihni! Ai është i zianit, ore, më dëgjoni mua!  
— kështu pat thënë njëri.

Aq hapur shpreheshin dyshime të tilla, sa që edhe kryetari, sadoqë e dinte se Qaniu ish djalë i zgjuar dhe diplomën e të dhënat nga shkolla i kish të shkëlqyera, nuk u qetësua, veç kur kryesia vendosi që të vinte brigadier Nevruzin, këtë burrë të matur, që nuk do ta linte djaloshin të bënte «pelivanllëqe».

\* \* \*

Qaniut nuk i durohej sa të njihte gjendjen e sektorit, që i kishin besuar e të fillonte nga puna sa më parë. Muajtë e fundit digjej nga dy dëshira: ose të vazhdonte institutin, ose të emërohej në fshatin e tij dhe të punonte në sektorin që i pëlqente. Njëra nga dëshirat i qe realizuar. Ai do t'i vihej punës siç dinte. Që më parë kish vënë re se në fshatin e tij pemë mbillnin shumë, po shërbimet nuk ua bënin si duhej. Krasitjen e çdo punë tjetër ata e bënin sipas ca rregullave, të cilave s'u kish mbetur asgjë shkencore, veç qëllimit të mirë e zakonit për të mos i lënë në mëshirën e fatit.

Tani ai do t'i përmirësonte këto shërbime. Do të punonte me mish e me shpirt, do të duheshin nja dy-tre vjet që puna të jepte rezultatit e duhur, po të gjitha do të rregulloheshin. Ish i sigurtë në njohuritë që kish marrë, e nuk mendonte kurrë se nuk do ta kuptonin apo se do të haste vështirësi në zbatimin e planeve të tij.

Të nesërmen e ditës që u caktua në punë, e mori Nevruzin dhe doli fushës. Kontrollloi pemish-



tet, perimet, vreshtat. Shikonte me vërejtje të madhe, ndonjëherë ngrysej në fytyrë. Rrallë mbante ndonjë shënim dhe e pyeste për diçka Nevruzin. Ky i vinte pas dhe herë pas here mundohej t'i shpjegonte ç'kishin bërë e ç'mendonte të bënin në çdo sektor. Po djaloshi dukej sikur s'e dëgjonte fare.

«Ky ose s'merr vesh, ose mundohet të shesë mend», thosh me vete Nevruzi dhe aty për aty vendoste që të mos fliste fare. Po më tej e ndryshonte këtë vendim, se kish frikë mos djaloshi e merrte për guak.

Në fund panë pemishten e Brodës. Kjo pemishte zë një vend të gjërë. Në mes të saj kalon rruga për në një fshat tjetër. Në të dy anët e kësaj rruge ka kumbulla, degët e të cilave, të varura e të pleksura me njëra-tjetrën, formojnë një si tunel, që gjatë verës ndryshon disa herë pamje: Në fillim kumbullat duken si të ngarkuara me dëborë prej luleve të shumta, pastaj vishen me gjelbërim e më pas skuqin, zverdhin e nxijnë nga kokrrat e pjekura. Poshtë kësaj rruge ndodheshin bahçat personale të anëtarëve, sipër pemishtja e kooperativës. Ca kohë më parë fshatarët ishin të cfilitur për tokë e s'donin kurrsesi të mbillnin pemë. Kryetari kish sjellë një maqinë me fidane. Një pjesë i kish detyruar anëtarët t'i mbillnin sipas një piketimi të përgjithshëm. Tani aty është bërë një bahçe që të kënaq syrin.

Aty u ndal Qaniu.

— Bukur shumë është këtu, — tha ai. — Kur t'i bëjmë mollët të na japin maksimumin e prodhimit dhe kumbullat t'i rregullojmë mirë, këtu

do të bëhet një vend që të mos ngopesh dot së pari.

Pas pak buzëqeshja, që i kish dhënë një pamje të ëmbël, ëndërruese, u zhduk nga buzët e tij të njoma.

— Mollët e personaleve kanë më shumë, — tha duke psherëtitur.

— E po, s'do mend. Çdo gjë në personale është më e mirë se e kooperativës.

— Por duhet të ndodhë e kundërta!

Nevruzit i erdhi për të qeshur. «Eh, ky flet më hava, — mendoj po më flet si në librat. Po ç'faj ka, fundja? Buzët i ka edhe me qumësht!»

— Mirë e ke ti, — tha me zë, — por kjo do kohë. Punën e shërbimet, që bën secili në personalen e tij, s'e bën dot kooperativa.

Qaniu kundërshtoi:

— Kooperativa ka mundësi t'ua bëjë shërbimin pemëve dhjetë herë më mirë. Këtë do ta shohësh që sivjet!

Tjetri s'foli. Me vete mendoj edhe njëherë se djalka po fliste në hava. Pak më tej Qaniu pyeti:

— Sa mollë janë në prodhim?

— Rreth pesë mijë.

— E sa kuintal japin? Sa muarët vjet?

— S'e di me saktësi, po më duket se nja treqind e treqind e pesëdhjetë kuintal, — u përgjegj Nevruzi.

Përgjegjësi i ri mblodhi buzët me përçmim. Ai i pa edhe punëtorët, që bënin tëharjen e vresh-tave. Atje mësoi se punëtorët e frutikulturës ishin nga brigada të ndryshme. Kjo e çuditi.



— Po si bëhet kështu? — pyeti.

Nevruzi i tha se, kur bëhej plani, ai paraqiste kërkesën dhe brigadierët e arave i caktonin atë punëtorë sa desh.

Qaniun s'e kënaqi kjo përgjigje. Ai kish vënë re shumë çrregullime në këtë sektor. Edhe aty ku kish hyrë ndonjë gjë e re agronomike, me siguri me udhëzim nga lart, puna që bëre duke ja përshtatur më tepër zakonet të vjetër.

Sa hëngri drekë, ai shkroi një raport të hollësishëm, ku shënonte dobësitë që kish vënë re e masat, që mendonte të merreshin. Në radhë të parë kërkonte që brigada e frutikulturës të kish njëzet punëtorë të zgjedhur të përhershëm. Këta do t'i mësonte ai e do të ishin specialistë në frutikulturë. Kur të mos kish punë në këtë sektor, ata mund të punonin në brigadat e tjera, ndërsa në kohën e punimit të vreshtave p.sh. ai do të kërkonte edhe punëtorë të tjerë nga brigadat e arave. Pastaj thosh se përgjegjësi e brigadieri do të bënin të njëjtën punë, kështu që njeri që i kotë.

\* \* \*

Këto vërejtje i pëlqyen shumë kryetarit të kooperativës. Ca ditë më vonë i thanë Nevruzit që të punonte në një sektor tjetër ose të rrinte si zëvendës i Qaniut, po pa ditë pune. Ai duhej të punonte si punëtor i specializuar në frutikulturë. Atij kjo iu duk si mosmirënjohje. E mori inat «çilimiun», po prapë e mbante veten. Mund ta vinin brigadier të arave, po të donte, mirëpo ai,

që e kish treguar gjithnjë se ish merakli i pemëve, pranoi më mirë të qe punëtor i thjeshtë, por në këtë sektor.

Nevruzi iu shtrua punës. Po zemrën e kish plot mëri ndaj atij që u bë shkak ta ulnin nga detyra. A ish njeri që i pëlqente përgjegjësitë? Ndoshta jo, po, sidoqoftë..., ta dish veten se diç je e pastaj përnjëheresh të vënë mbi ty një tjetër, për më tepër një «çilimi»; të jesh mësuar me urdhëra e këshilla e pastaj përnjëheresh të të urdhërojnë e të të këshillojnë ty, këto nuk qenkan të lehta. Pastaj çdo ditë vinte re se «çilimiu» s'pajtohej me shumë nga rregullat e punës që kish vënë ai, Nevruzi, dhe vepronte krejt ndryshe. Qaniu s'thosh gjë për shërbimet e gabuara që ishin bërë më parë, po Nevruzin e lëndonte më tepër heshtja e tij. Filloi të bëhej i zymtë. Cmira e mëria e mundonin. Qaniuun s'e shihte dot me sy, se, sadoqë ndonjëherë i jepte të drejtë, prap-seprapë ai ish shkaktar i vuajtjeve të tij.

Kështu i dukej Nevruzit.

Po ai nuk desh të binte në sy se vuante. Shpesh, kur e shihte, siç ja thosh mendja, se djaloshi gabonte, ai hahej me të dhe ish i bindur se kish të drejtë, po të tjerët sikur nuk e kuptonin.

\* \* \*

Gjatë dimrit, në kohën kur fshatarët mblidhen pas porit në sallën e leximit dhe bisedojnë për gjëra të ndryshme, Qaniu organizoi kurse të thjeshta për punëtorët e frutikulturës. U mësonte aty llojet e krasitjeve e të shartimeve, sëmundjet e pemëve, insektet dëmtues e luftën kundër tyre e



sa e sa gjëra të tjera. Këto kurse ai i bënte në formën e bisedave të lira. Fliste thjesht dhe i bënte atë që qarta ato që thosh, sa që të tjerëve u vinte si çudi që nuk i dinin më parë, këto gjëra kaq të thjeshta. Punëtorëve të përhershëm të frutikuturës, që u caktuan sipas kërkesës së tij, këto biseda u pëlqenin shumë. Qaniu diji të ngjallte tek ata dashurinë për pemët, atë dashuri që e kish edhe vetë për to.

Në këto kurse vinte edhe Nevruzi ndonjëherë. Ai dëgjonte e qeshte me vete. Nuk pyeste fare, ndoshta s'e bënte veten, po më tepër i dukeshin të kota nojhuritë e djaloshit, sepse shpesh mendonte me qesëndi:

«Po rreh ujë në havan, djalka i mamasë! Se s'di unë nga këto, prandaj s'më bëjnë mollët!» Ai mburrej, se vërtet mollët e tij jepnin shumë prodhim.

Në këto kurse, që zakonisht bëheshin mbrëmnet, Nevruzi e shihte shpesh me bisht të syrit «Çilimiun», duke e hetuar për diçka, që ja shtonte edhe më tepër inatin kundrejt tij. Kjo ndodhte se në kursin e frutikuturës e të agronomisë hynë edhe disa vajza, midis së cilave edhe e bija, Esmaja.



Në të hyrë të marsit, disa ditë me radhë mbajti jugë e dëbora shkriu shpejt e shpejt. Në disa vende të pjerrëta e të ngritura toka avullonte e terej. Aty ku shkonin njerëzit, u bë shpejt një udhishte e thatë, me baltë të ngjeshur. Kjo baltë e ngjeshur e kësaj kohe është disi e veçantë nga

ajo që mund të bëhet edhe ndonjëherë gjatë dimrit, kur s'ka dëborë. Kjo baltë e ngjeshur në rrugicat e rrahura nga këmbët e udhëtarëve dhe aroma e dheut që avullon, krijojnë përshtypjen e fillimit të pranverës.

Punëtorët e frutikulturës filluan punën. Hiqnin kashtën e thekrës, me të cilën kishin mbështjellë trungjet e mollëve për t'i mbrojtur nga lepujt, e pastronin trungjet prej vemjeve të ndryshme. Kur shkriu dëborat krejt, ata filluan krasitjen e pemëve. Me ta ish gjithnjë edhe Qaniu. Ai krasiti vetë një pemë, duke i mësuar të tjerët se si duhej bërë kjo punë.

Punëtorët e rinj habiteshin kur dëgjonin sa gjë e madhe qënkej krasitja, Nevruzi tundte kokën i pakënaqur.

— Ashtu si po na mëson ti, — tha, — pemët nuk do të japin fare prodhim.

Pastaj shtoi se duheshin krasitur të gjitha pa përjashtim:

— Kur e punon tokën rreth pemës, i lutesh asaj që të prodhojë, — tha. — Kur e plehëron, i kërkon të prodhojë, ndërsa kur e krasit, e detyron të të japë prodhim! — dhe shikoi si fitimtar rreth e rrotull.

— Shumë me vend janë këto fjalë, — shtoi Qaniu. — Mos i kundërshtova unë ato? Më duket se unë thashë që tamam krasitja ka rëndësi të dorës së parë, por, kur bëhet si duhet.

— E pse, s'është bërë si duhet vitin e kaluar?

— Jo, nuk është bërë.

— Ç'thua, more!

— Po, po, mollët janë dëmtuar shumë. Pas



ca vjetësh, po të mos vëmë dorë që tani, ato do të shterpëzohen thuajse fare.

Pastaj Qaniu shpjegoi se krasitja nuk bëhet vetëm duke prerë çdo filiz. Ai shtoi se duhet shikuar toka e zhvillimi i pemës para se të bëhet krasitja. Po të që pema e rritur, me filizë të shkurtër, duhet bërë krasitje e pjesëshme. Po të që e zhvilluar mirë dhe në tokë të shëndoshë, duhet të lihen deri gjashtë sythe. Tri prej tyre do të jenë sythe frutore, ndërsa tri do të lëshojnë filiz. Sikur kësaj peme ti lireshin tri sythe, nga ushqimi i tepërt, të tri do të hidheshin filizë e prodhim s'do të kish fare. Ndërsa krasitja e rëndë, si kish bërë Nevruzi, i sakatonte pemët.

— E pse nuk janë sakatosur të miat? — pyeti Nevruzi, duke dashur t'ja nxirrte fyçka «çilimiut» mësimet që po jepte.

— Vërtet, — pohoi një punëtor, — sivjet atij i kishin shumë.

— I kam parë. Po të vazhdosh t'i krasitësh siç po thua, brenda dy-tre vjetëve... — dhe djaloshi s'e mbaroi fjalën, por bëri një shenjë kuptimplote. — Pse s'të janë dëmtuar deri tani, the? Ka qenë toka e shëndoshë edhe pemët po ashtu. U ka qëlluar edhe moti. Po dëmi do të ndihet më vonë, ke për të parë.

Nevruzi vuri buzën në gaz me tallje.

Kur mbaroi krasitja e pemëve, ato muarën një formë të bukur ombrelle. Në çdo degë që lënë një filiz udhëheqës, degë të trasha s'u prenë thuajse fare.

Punëtorët ja muarën dorën shumë lehtë kësaj pune. Qaniu ish gjithmonë pranë tyre dhe shkonte prej njërit te tjetri.

Nevruzi nuk punoi për krasitjen e pemëve, mbasi, siç tha, kish ca punë të tijat e kish marrë lejë. E vërteta ish se ai s'desh të hiqte dorë nga krasitja e rëndë, të cilën e quante mënyrën më të mirë për të siguruar prodhim të bollshëm. Ai shkoi edhe më tej dhe lajmëroi edhe kryetarin, po ky ja preu shkurt, duke i thënë se Qaniu e dinte mirë zanatin e tij. Kështu kish thënë edhe agronomi i lartë.

Nga kjo Nevruzi priste me ligësi prodhimin e pakët, që do të jepnin pemët e kooperativës. Kur u bind plotësisht për këtë, u largua fare nga frutikultura duke gjetur shkak ato fjalët që këmbëu me brigadierin, «çilimiun» siç i thosh ai.

\* \* \*

Një mbrëmje vjeshte kur sapo qe errur, Nevruzi po ngjitej për në shtëpi. Kish qënë tek i vëllai. Vetëm atij mund t'ja shprehte hapur atë gëzimin e tij dashakeq që mollët e kooperativës s'kishin dhënë prodhim të mirë. Le ta shihnin ata të kryesisë se ku i shpinte mushka! Tani le të gjykonin të gjithë se kush dinte më tepër, Nevruzi, që i kish pemët rrush, apo «çilimiu», që s'do të nxirrte nga mollët e kooperativës as ilaçet që kish harxhuar.

Mirëpo i vëllai s'ua kish vënë veshin fjalëve të tij. Ai i kish thënë se në fshat flisnin se Qaniu bënte dashuriçka me Esmanë e tij. Edhe kjo duhej! Ai e kish dëgjuar këtë që me kohë, po kish kujtuar se e bija do të dinte t'ja tregonte vendin atij mistreci. Kjo fyerje e dyfishtë e lëndonte shumë. Sa herë që e sillte rasti të bisedohej për Qaniun,



ai kujtonte këtë fyerje të dyfishtë dhe zemra i pikonte gjak. Le pastaj kur dikush i shtonte edhe ca më tepër helm asaj zemre që lëngonte! Që kur ish larguar nga frutikultura, emri i «çilimiut» i qe ngulur në tru si një peronë e nxehtë. Kur harronte, «perona» zinte vend e ai s'e ndjente fare. Por mjaft që dikush ta lëvizte qoftë edhe fare pak dhe ajo zinte ta digjte e ta përvëlonte. Fjalët e të vëllait e kishin futur edhe më tej në trurin e tij të cflitur atë «peronë».

Duke ecur i zymtë, zemërlënduar, nëpër rrugët e qeta të fshatit, ai parandjente që do të ndodhte diçka atë mbrëmje, po çfarë? Këtë s'e kish të qartë. S'kish vendosur fare se ç'do të bënte. Po ish i sigurtë se nuk do ta shihte dot i qetë të bijën pa shprehur brengën që e mundonte. Jo, nuk do të duronte dot! Do t'i thosh asaj. Dhe pastaj?... Sidoqoftë, do të bënte diçka...

Kur zgjati dorën të hapte portën e shtëpisë së tij, ndjeu disa hapa të lehta në oborr. Kujtoi se dikush po delte nga shtëpia dhe priti me krah të nderur që ai «dikush» ta hapte derën i pari. Mirëpo hapat dredhuan nga e djathta dhe zhurma e tyre, së bashku me atë të fëshfëritjes së fletëve të fasuleve, u dëgjuan në kopsht. Pastaj u bë një qetësi e përnjëhershme, e thellë. Ish një qetësi ogurzezë: dukej sikur në çast kish pushuar së jetuari çdo gjë dhe ai ndjeu sa rëndë po merrte frymë. Errësira u bë më e dendur. Yjet dukeshin të zbetë, shumë të largët e të ftohtë, si shkëndija të ngjitura në një kube të qelqtë.

«Ndonjë qen ka qenë, po pse qëndroi? Apo mos është ndonjë hajdut që vjedh mollë?» mendoi. Dhe përsëri mbajti vesh. Atëhere dëgjoji diçka,

që do të desh më mirë të qe shurdhuar e të mos e dëgjonte.

— Esmë! — pëshpëriti dikush.

— Ku je futur, mor i zi? Hiç s'dukesh!

Vajza e tij, pra, po takohej me dikë! Cili qe ai djalë? Qaniu! Me siguri ai do të ish.

Nevruzit iu ndez gjaku dhe bëri përpara, po, sikur ta ndalte një dorë e padukshme, ndoshta kureshtja, që shpesh është më e forët se inati qendroi në vend si i gozhduar. Pas pak zërat në kopsht u dëgjuan përsëri:

— S'bën kështu, Qani! Ti do më gojosësh mua!

— Ke frikë nga babai?

— Mos ma kujto atë! Sikur ta dijë ai, sikur ta dijë...

— Çfarë pastaj?

— Ma pret kokën! S'e njeh mirë ti atë!

Ai qeshi.

— Qesh ti, qesh!

— Po ç'të bëj, të qaj?

— Jo, po...

— Çfarë «po»?

— Ashtu, më mirë mos takohemi.

— Nuk më do?

— Oi! Sa i lig bëhesh! Po mos të desha, nuk vija këtu!

— Unë trembem vetëm po të mos më duash ti. Të tjerat s'më trembin mua. Ato s'kanë rëndësi.

— Si?...

Kuptohet që ai s'e la vajzën të mbaronte. U ndie veç një «Jo, mos kështu!», po edhe këto fjalë humbën diku, si të mbytura.

Kjo heshtje e dytë i sëmboi në zemër babait të fyer e të inatosur. Nuk duroi dot më. Këtu iu



duk se poshtërsia po arrinte kulmin. Mjaft më!  
Ky mistrec ja kish marrë detyrën, e kish detyruar  
të hiqte dorë nga puna që i pëlqente, e kish marrë  
nëpër këmbë dhe tani po i rrëmbente edhe nderin  
e familjes! A mund të durohej më tej?

Si i marrë e hapi portën dhe u sul në kopsht.  
Me të dëgjuar zhurmë, e bija iku me nxitim për në  
shtëpi, ndërsa Qaniu mori për nga shtegu ku kish  
hyrë. Kur po ngjitej në avlli, dora e fortë e Nevru-  
zit e kapi për rrobash dhe e uli poshtë.

— Ku vete, ti, ti... Ku vete, o ligavec i  
ndyrë?! — Klithi duke e shkundur të tërin.

Kur u ndodhën ballë për ballë, u mat ta go-  
diste me grusht, po tjetri ja kapi dorën si me darë.  
Nevruzi provoi ta lëvizte, po s'mundi. Atë çast me  
siguri do të jetë habitur se ku e kish gjetur gjithë  
atë forcë ai pisqolla, «çilimiu». Filloi ta shante,  
duke u shkumbavitur nga inati, me një varg  
shprehjesh të ndyra e të ngatërruara.

Tjetri tha në mënyrë të prerë, si një njeri,  
i cili, i ndodhur në një gjendje të vështirë, më në  
fund e mbledh veten dhe merr vendim:

— Fundja, ç'do prej meje?

— Si?! Si the?! Ç'dua unë? Unë ç'dua?! Ah,  
mor laskuriq! Edhe guxon, ë? Edhe guxon të më  
bësh këtë pyetje? Nga puna më hoqe, tërë qe-  
shën me mua, tani më ke ardhur edhe këtu...  
Si?! Akoma, ë? Akoma do?!

— Nuk bën të thërresësh, se këtu afër është  
rruga. Nga puna ike vetë. Unë s'të kam asnjë faj,  
merr vesh? Esmanë e dua!

— Si?! E dashke? Kështu? E dashke! Po kë  
pyete ti, mor spurdhjak? Ë? Kë pyete?

— Mos e ndy gojën, se do pendohesh! Unë pyeta ndjenjat e mia e të sajat.

— Po mua?! Po unë?! Çjam unë këtu?!

— Edhe ty do të të thoshim. Meqë u bë kë-shtu..., ja, po të themi tani. Unë s'kam qëllim të keq. Esmanë e dua. Edhe ajo më do!

— Kurrë! Ty, ty të ta jap unë?! Sikur të më mbetet në derë! Dëgjon?! Më mirë e vras!

Djali qeshi përsëri.

Nevruzit iu bë sikur dalloj prapë atë buzë-qeshjen e tij tallëse. Nga kjo pandehmë iu drodh trupi, por, papritur, e ndjeu veten të plogët, të pafuqishëm...

... Qaniu kish ikur. Ai kish thënë edhe diçka, po Nevruzi s'kish dëgjuar fare. Ai kish mbetur si i dalldisur. Tani e ndjente veten të dërmuar. Kish mbledhur në shpirt aq shumë mëri, aq shumë inat kundër «agronomit», sa që tani, kur iu paraqit rasti, tha se kish ardhur koha t'i lante hesapet me të. Po ç'kish bërë? Asgjë! Ç'kish ndodhur? Me dy fjalë Qaniu e kish çarmatosur krejt, me dy fjalë dhe me atë qëndrimin e tij të sigurtë e të prerë, atë qëndrim që s'ja lëkundte dot askush. Si ish e mundur që një fëmijë të ish aq gjakftohtë e i paepur?...

Si ndenji një copë herë aty me duar shtrënguar pas tëmthave, ndjeu një zbrazëtim të madhe në stomak, dhe një e ftohtë po i përhapej në tërë trupin e dërmuar. Nuk qe në gjendje të mendonte asgjë. Duke u kolovitur sa andej këtej, shkoi në shtëpi. Nuk foli fare. As hëngri, as piu. Shkoi në krevat dhe i shtrirë më kurriz, pa lëvizur fare, ndenji me orë të tëra, gjersa më në fund gjumi, i ndihmuar prej lodhjes, e nënshtroi dalngadalë dhe



e futi në mbretërinë e tij të ëmbël, të thellë e  
qetësuese.

\* \* \*

Në ditët e mëpasme ai binte shpesh në mendime të thella. Mendimet s'e linin të qetë, ato i vërtitëshin në tru si ato retë e ulëta që venë e vinë në ditët me erëra të kundërta. Ai mendohej, kur thonë, «si kau në ugar». Në shtëpi e në rrugë, duke punuar e duke ndenjtur, kudo që të ndodhej, atij s'i hiqej nga mendja ajo që kish ndodhur. Shpesh herë shtrëngonte grushtat e dhëmbët nga inati. Në ato çaste, sikur ta kish përpara, ish gati ta copëtonte atë «mistrecin malukat». Po e bija? Ah, edhe ajo! E si e kish gënjer, xhanëm, si? Si kish mundur ta gënjente ai atë, Esmanë, për, të cilën thosh me mburrje se s'ja gjeje shogën? Fare budallaqe ish treguar edhe ajo! Sikur s'e dinte që ata, i ati dhe ai «çilimiu», e kishin halë në sy njëri-tjetrit, sikur s'e dinte... Dhe inati drejtohej në tjetër shenjë. Po shpejt një mendim tjetër, i dalë s'di prej nga, si një gjemb për t'ua prerë rrugën mendimeve të tjera, e bënte të hidhej përpjetë. Një kohë të gjatë ai kish qenë i bindur se Qaniu ish një mistrec, një foshnje, që s'e nxirrte dot qimen nga qulli. Mirëpo pse ai kryetari ja zgjatte aq shumë? Pse plot njerëz me mend, që ishin plakur duke punuar arat, bisedonin me të si me një burrë të vërtetë? Po ata punëtorët e frutikulturës pse s'kishin marrë anën e Nevruzit, po përkrahnin Qaniu? Apo kishin frikë, se ai ish brigadier? Jo, s'ish e mundur! Po të qe kështu, ai do ta kuptonte. Do të gjendej një midis

tyre që t'ja thosh këtë! Kurse ata ishin munduar  
kaq herë t'ja mbushnin mendjen se e kish të kotë  
që mbante mëri me Qaniun, i cili ish djalë i mirë  
dhe i zoti. Posi, tamam kështu i kishin thënë: djalë  
i mirë dhe i zoti.

Më në fund, pse e desh aq shumë e bija? Si  
kish hedhur kaq dashuri ajo vajzë tek ai mistrec?

Pas pyetjeve të tilla, të cilave s'u përgjigjej  
dot, inati i kthehej në dyshim. Dhe ky dyshim  
binte mbi atë vetë. Mos vallë Qaniu vërtet ish  
djalë i zoti dhe kish të drejtë? Mos vallë ato që  
dinte Nevruzi ishin vërtet njohuri të vjetëruara e  
s'vlenin më? Mos vallë?...

Kur arësyetonte kështu duke dyshuar, i dil-  
nin në ballë djersë të ftohta dhe një valë gjaku  
i ngjitej në fytyrë. Atëhere ngrihej me inat nga  
vendi, rrëmbente sopatën, kazmën a ç'vegël t'i  
ndodhej përpara dhe punonte e punonte me të,  
që të lodhej e t'i davaritte mendimet, që e mun-  
donin.

...Pas asaj që ndodhi atë mbrëmje në  
kopsht, ai nuk desh ta takonte gjëkund Qaniun.  
Nuk e merrte dot me mend se si mund ta vësh-  
tronte në sy atë faqezi. Nja dy herë që iu dha  
rasti, ndërroi rrugën që të mos e takonte. Po, një  
ditë kur u ndodhën papritur ballë për ballë dhe  
Qaniu e përshëndeti buzëgaz, si një njeri të afërt  
e sikur të mos kish ndodhur asgjë, Nevruzi u shas-  
tis fare. Si ta quante këtë njeri? Ç'ish vallë, shej-  
tan apo engjëll? Apo ish edhe shejtan edhe engjëll  
bashkë?



Kish ardhur pranvera tjetër. Shenjave të para të ardhjes së saj iu shtuan edhe filizat e prerë nga mollët. Fillimi i pranverës është koha e kra-sitjes së tyre.

Punëtorët e brigadës së frutikulturës ja kishin marrë dorën kësaj pune tamam si ua kish mësuar Qaniu. Po ky, edhe pse ua kish dhënë atyre punën që në mbrëmje, nga që e kish bërë zakon, në mëngjez herët vajti te pemishtja e mollëve. Shkonte nga një rrënjë te tjetra, pastronte ndonjë kleçkë të thatë, që kish mbetur aty, vështronte sythet e luleve që sapo kishin dhënë shenjë dhe zemra i mbushej me gëzim.

— Sivjet do të kenë shumë, të gjitha, — tha një punëtor.

— Mot do të kenë edhe më tepër. Tani mua-rën radhë ato, — ja ktheu brigadieri.

— Në vjeshtën e kaluar, — shtoi brigadieri, — sadoqë unë ju kisha thënë me kohë se, kur bëhet shërbimi i rregullt rrënjësor, pemët atë mot s'japin shumë prodhim, ju menduat keq për mua. Po pemët janë qenie të gjalla. Pemët tona i ngjasin një trupi të mbushur me plagë. Kur i lidh me fashë në fillim, plagët s'duken dhe aq. Kur i heq fashot, i pastron plagët, e i lidh sërish, ato duken sikur janë bërë më keq. Por shpejt marrin për mbarë e zënë përthahen. Kështu na ndodhi edhe neve. Tani mollët tona janë shëruar. Prandaj ju them që mot do të kenë edhe më tepër.

— Veç të mbajë koha! Sikur të mbajë mirë këtë muaj!

I kishin marrë pemët me radhë.

Duke punuar, edhe bisedonin.

— Mollët e Nevruzit sivjet lëshuan vllastarë meshkuj, — tha njeri.

Të tjerët shikuan Qaniu. Ky nuk dha asnjë shenjë që të tregonte se ç'përshtypje i kishin bërë këto fjalë.

Duke iu drejtuar atij Raqi, një punëtor, tha:

— I doli që sivjet ajo që i the ti.

— Ka vend të shëndoshë e pemë të zhvilluara mirë, po është shumë kokëfortë, s'heq dorë nga e tija, — tha Qaniu. — Krasitja e rëndë, siç e bën ai, i sakaton pemët. Pemët duhet t'i duash e t'i shohësh si fëmijët. Fëmijën e ushqen mirë, po që të bëhet i shëndetshëm e i bukur, duhet edhe ta lash, ta qethësh, t'ja presësh thonjtë. Kjo është krasitja e lehtë.

Të tjerët qeshën me këtë krahasim.

— Kur flisje vjet për këtë punë, ne s'kishim aq besim. S'na shkonte mendja kurrë që krasitja të jetë kaq e rëndësishme.

Qaniu qeshi si fëmijë.

— Të njihnim që të vogël dhe na dukesh qesharak kur fillove t'i vihesh punës me tërë mend, — shtoi Raqi.

— Qëllon shpesh herë kështu, — tha Andoni, më i moshuari i punëtorëve të frutikuturës. — Kur e njeh në punë një njeri, çuditësh. Pse? Se je mësuar ta shohësh rrugëve a me libra në dorë e s'e përfytyron dot që t'i shtrohet punës.

Qaniu nuk i pëlqente të flisnin për të. E dinte që punëtorët e donin dhe e çmonin, po i dukej një gjë e ulët të lejonte ta lëvdonin në sy të tij.



— Por nuk e ndryshuat të gjithë bindjen që kishit për mua, — tha ai.

— Të gjithë, — tha Andoni, — veç Nevruzit.

— Nevruzi nuk është i keq nga shpirti, — u hodh ta mbrojë njëri. — Po është sedëri i madh.

— Sedër e sëmurë ajo e tija.

— E sëmurë nga koha. Ne, të rinjtë, s'kemi sedër të tillë.

— Ai e di si djalli që Qaniu ka të drejtë, po s'e bën veten. Ka hall të heqë dorë nga e tija, po pa u marrë nëpër këmbë.

— Meseleja e tij është e ngatërruar. Këtu hyn edhe e bija, — tha Raqi.

Të tjerët u shikuan ndër sy, se s'e kishin sjellë ndonjëherë fjalën për Esmanë në sy të Qaniut.

— Ai mendon se ti ja bën për inat, — shtoi Raqi.

— Po ti e beson këtë? — pyeti Qaniu, i cili ish bërë flakë në fytyrë.

— Jo. Unë të thashë ç'mendon ai.

Këtë bisedë nuk e nganë më tej.

...Kur u largua prej tyre, Qaniu i kujtoi ato fjalët që kish thënë Raqi. Vërtet të mendonte kështu Nevruzi? Qaniu s'i kish lënë rast të dyshojë, po, edhe mund t'i shkonte mendja për keq Nevruzit, sepse e kish vënë re që mezi ja kthente fjalën kur e përshëndeste.

Qaniu vendosi të bisedonte me Esmanë për këtë. Tani e kishin mjaft vështirë të takoheshin, por prapë e gjenin mundësinë. Ata që dashurohen nuk vuajnë nga rastet. I ati mundohej t'ja ndalonte së bijës dashurinë për të, po ajo e desh edhe më shumë. Sa njerëz janë munduar ta frenojnë a ta shuajnë dashurinë! Sa mjete e mënyra janë

përdorur për këtë qëllim! Dhe dashuria, si për t'u tallur me ta e për të treguar fuqinë e saj, gjithnjë ka bërë të kundërtën, është forcuar.

Kështu ndodhte edhe me dashurinë e tyre.

\* \* \*

Nevruzi ish detyruar të bisedojë me të bijën. I kish thënë asaj se Qaniu tallej me të e do të turpërohej në fshat prej tij, por ajo kish qeshur me qesëndi. E kish kërcënuar ta rrihte, i kish thënë se kurrë nuk do ta linte të marrë atë mistrec, por ajo e kish shikuar serbes drejt në sy. I ish lutur e përgjyruar të mos ja nxinte faqen tani, në pleqëri, atij që e desh aq shumë, por ajo e kish shikuar si me mëshirë.

Ai që mundur edhe prej «çilimiut», edhe prej së bijës. Nuk ish i zoti t'u bënte asgjë. E keqja më e madhe ish se ai e bënte veten të tregohej i prapambetur, si ata të qëmotshmit. Mirëpo si të pajtohej pa e ulur veten? Me ç'sy do të dilte në fshat kur të bënte udhë e të hiqte dorë nga e tija?

Këto pyetje bënte sedra e tij e sëmurë.

\* \* \*

Kish dalë një mëngjez herët dhe po i shikonte i brengosur pemët e tij që i kishin rritur aq shumë ata djaj filiza meshkuj. Duhej t'i priste, po si? Se mos i delnin noca të tjerë më të këqinj. Kish shkuar nga pemët e kooperativës dhe i kish shikuar me cmirë tërë degët me filiza të vegjël e të mbushura me sythe lulore.



Ai «çilimiu» paskej qenë shejtani vetë! Kishin dalë tamam fjalët e tij. Po të paktën t'ja kish vënë veshin e të mësonte të krasitte mirë! Tani s'do ta ndjente të nevojshme t'i përulej.

I dalldisur në të tilla mendime, s'vuri re se në bahçen e tij kish hyrë vetë «çilimiu». Kur e pa, i tha vetullngrysur:

— Erdhe të më gëzohesh?

— Jo, — tha Qaniu. — Po më vjen keq të shoh si prishen mollët e tua dhe erdha të të ndihmoj.

— Të më ndihmosh? — Nevruzi u mendua një hop. Tani kish ardhur rasti për t'u pajtuar. Si duhej të vepronte? Ç'ti thosh? Në çast iu kujtua tërë ajo luftë e gjatë shpirtërore dhe sedra e tij ngriti krye edhe njëherë. U drodh nga inati, shikoi me vëmendje «çilimiu». Ndoshta desh të vinte re në fytyrën e tij atë buzëqeshjen tallëse dhe kështu ta përlligjte atë zemërimin e tij të pashkak. Por vuri re se fytyra e djaloshit ish e qeshur dhe e pafajshme. Atë e shikonin dy sy të ëmbël e të qetë. Këtë vështrim e ndjeu t'i ngulet deri në zemër. Dhe u drodh përsëri. Këtë radhë ish inatosur me veten që ish nxehur aq papritur. Nga lart e vështronin pemët, që kishin marrë tatëpjetën, para tij qëndronte një djalosh guximtar, që po sillej aq i dashur e i sinqertë me të.

Nevruzi uli sytë përdhe.

— Po të pyeti njeri, — tha, — i thuaj që kish ardhur këtu për të shkëmbyer eksperiencën me mua.

— Akoma me këto ti? Mirë, mirë...

Qaniu hipi në zhgërdallën 1) që ish vënë te një mollë me degë të gjëra.

— M'i jep gërshërët! — tha. — Hip edhe ti këtu!

Dhe filluan të punonin së bashku.

---

1) Zhgërdallë: shkallë e gjatë, teke, që përdoret për të hipur në pemët e larta.



## « FSHATARJA »

Mësuesja e re ish një vajzë shtatmesatare, e shëndetshme, me fytyrë të mbushur e faqe të kuqe si molla dhe me sy të zinj si ullinj të ndritshëm, sikur i kish të lyer me vaj, që lëviznin me gjallëri e shkathësi të madhe. Kish veshur një fund të kuq dhe një bluzë basme, e cila ja tregonte qartë format e trupit dhe i shkante për bukuri fytyrës së saj plot shëndet. Flokët e zes me forma natyrale, i kish prerë shkurt, me sa duket, që të mos e bezdisnin, sepse nuk kish treguar ndonjë kujdes të madh për to.

Duke e shikuar që nga flokët e deri te majat e këmbëve, Leni, një mësuese që mbahej si femër me shijë të hollë për veshje e për të çmuar të bukurën, mbloodhi buzët kur sytë e saj u ndalën te këpucët e përdorura e tërë pluhur të mësueses së porsaardhur.

Tefta, mësuesja e re, doli të shihte klasat.

— Epo, si ju duket kjo çupka? E bukur është, s'ke ç'i thua, — tha një mësues, duke iu drejtuar me qëllim Lenit, e cila s'kish qejf t'i flisje për bukurinë e një femre tjetër.

— Ju, djemtë, nuk dini t'i çmoni fare femrat, — tha ajo. — Me vështrimin e parë, e jepni mendi-

min, pa u thelluar. S'them se s'është e bukur, por, a nuk të duket bukuria e saj si bukuri prej kuklle? S'ka hiç finesë, nuk është tërheqëse si femër. Apo për të veshur! Ka mbathur një palë këpucë si opinga. Në këtë vapë! Po ç'them? Ajo është tamam fshatare. Fshatarët, kur vishen, do të lënë mangut ndonjë gjë pa tjetër.

Pas pak, kur hyri drejtori në dhomën e mësuesve dhe e pyetën se ç'përshtypje kish për mësuesen e re, ai rrudhi vetullat dhe tha rëndë-rëndë.

— Ata të Seksionit nganjëherë nuk dinë ç'bëjnë. Ne kërkua një mësues matematike, ata dërgojnë një çupkë çamaroke. E ç'të bëj unë me të? Ç'matematikë pret të të japë ajo?

Edhe sikur t'i kish dëgjuar Tefta këto vërejtje jo të mira, nuk do t'i kishin bërë shumë përshtypje. Ajo nuk bëhej aq merak se ç'mendonin të tjerët për të. Por, ama, nuk do t'ua kursente përgjigjen, se edhe për këtë s'i bëhej vonë. Dhe një fillim i tillë nuk do të qe aspak i mirë.

Gjersa filluan mësimet, ajo i mërzhiti të gjithë duke i pyetur si bëhej plani tremujor apo ai ditor e për çdo vogëlsirë që i delte. Kur e kish pyetur në fillim drejtorin, ky e kish vështruar shtrembër, sikur t'i thosh: «Ama, as këtë s'e ditke? Ç'pranove të vije këtu, atëhere?» Ndërsa Leni, edhe ajo duke e shikuar me mospërfillje, i kish thënë: — Pse, s'kini mësuar në shkollë ju? Kaq kollaj u mësua, me një të pyetur, si bëhet plani? Se mos është ndonjë «5 + 5 bëjnë 10».

Tefta, me atë instinktin e natyrshëm që kanë disa njerëz për të parandjerë të mirën e të keqen, edhe kur ato s'kanë marrë forma të konkretizuara,



u druhej të dyve qysh në rastin e parë që pati të bëjë me ta. Nga të tjerët s'desh t'ja dijë fare e sillej çpenguar. Jo vetëm që i pyeste si ta bënte këtë apo atë gjë, por, edhe si e bënte, ua jepte t'ja shihnin në e kish bërë mirë a jo dhe i detyronte t'ja thoshin mendimin e tyre.

Ta shihje si bisedonte me ta, do të thoshe me siguri se i kish të njohur prej kohësh. Nga kjo sjellje Leni, kur s'ish Tefta, thosh me mburrje:

— S'u thashë unë që është tamam fshatare? «Nga je ti? Po ti? E ke mbaruar Institutin? Je martuar?» — të pyet tietra si pa gjë të keq. U, pika edukatës që ka marrë!

Filluan mësimet. Teftës nuk i mbetej kohë, kur thonë, as të pinte ujë. Bënte mësim, korrigjonte detyra, shkruante e lexonte, pyeste për çdo gjë e kurdoherë, pa vënë re nëse ai që pyeste ja kish ngenë apo jo. Nuk i vinte radha të bisedonte për gjëra të tjera e të rrinte e qetë, po kurrë s'mërzitej. Ora e mësimit s'i arrinte dhe shpesh mbetej duke shpjeguar edhe në minutat e pushimit. Kur ish e lirë, vinte e dëgjonte në orën e mësimit të ndonjë mësuesi tjetër.

Leni i shihte me qesëndi këto veprime të «fshatares». ndërsa drejtori mezi e përmbante veten. Në fillim i kish thënë me seriozitet se si duhej të sillej në mësim e kudo për të mos prishur autoritetin e kolektivit të mësuesve që, siç tha ai, në atë shkollë qe i madh. Por tani vinte re me nerva të tendosura se ajo s'ua varte fare këslillave të tij. «More, nga na doli kjo farë e tillë? Me qiri ta kishim kërkuar e s'do ta gjenim dot, dreqin!» thosh me vete.

Më në fund s'iu durua dot më. E thirri në drejtori.

Kur hyri ajo, drejtori ngriti kokën nga ca evidenca që kish përpara, mbloodhi vetullat si për të shikuar më mirë, i bëri shenjë mësueses të ulej, drejtoi shtatin e tha me seriozitet, sikur të ish ushtararak e t'i diktonte një urdhër lufte sekretares së tij:

— Ju porosita në fillim si të punoni e si të silleni, por ju s'i kini vënë në vesh fjalët e mia. Ju nuk veproni korekt me rregullat e shkollës. Unë s'mund të shoh indiferent se si ju po na i prishni këto rregulla që i kemi vendosur me përpjekje të mëdha.

Mësuesja mbloodhi supat. Drejtorit iu duk tamam naive me këtë gjest, i kërceu damari që kish në anë të tëmthave dhe me zor e përmbajti veten.

— Po tregohi sikur s'merrni vesh? — vijoi. — Aq më keq, atëhere! Po ju them për të parën e të fundit herë: në mësim tek të tjerët, të mos hyni pa urdhërin tim! Kur bie zilja, të dalni nga mësimi, se nxënësit kanë nevojë për pushim. Dhe së fundi, kini parasysh t'i vini rëndësi autoritetit tuaj. Jeni mësuese në tetëvjeçare dhe silleni me nxënësit sikur të jeni edhe ju vetë nxënëse. Kur hyn njeriu në klasë, pasi kini dalë ju, i duhen disa minuta vetëm për të vendosur disiplinën e nevojshme për mësim. Shkoni tani dhe i vini gishtin kokës. E përsëris: jeni mësuese e shkollës tetëvjeçare! Ndoshta qe gabim që ju cakton këtu, po...

Mësuesja u mat diç të thoshte, por drejtori ja preu fjalën:

— Këtu nuk ju thirra për të diskutuar! — tha prerë ai.

Mësuesja doli pa marrë vesh asgjë. Përse e



kish thirrur drejtori? Ç'i kish thënë? Ç'kish mësuar ajo nga fjalët e tij plot autoritet? Ç'ishin këto rregulla kaq të rrepta, për të cilat ajo s'kish dëgjuar kurrë?

Atë ditë mësuesja e re ish si e shushatur nga ato që kish dëgjuar prej drejtorit dhe nga pyetjet që i bënte vetes.

Për çudi, të nesërmen e harroi takimin që kish patur me të. Kur e kujtonte ndonjëherë, nuk tronditej aspak, siç i ndodhte një ditë më parë, po i dukej si një diçka e largët, pa rëndësi, që s'ja vlen ta sjellësh ndër mend.

Dhe vepronte në çdo rast natyrshëm, pa i vënë vetes ndonjë kufizim për sjelljen e saj si mësuese. Ajo nuk mund të sillej sipas ca rregullave të caktuara që më parë. Bile ca ditë edhe u mundua por hoqi dorë, se i dukej sikur lozte ndonjë rol në teatër.

Një ditë drejtori vajti për kontroll tek ajo në një orë mësimi aritmetike.

Siç e kish zakon, ai u ul në karrige mu aty te tryeza, pasi hodhi një vështrim hetues në klasë. Pastaj vuri gjyslykët dhe shfletoi me radhë: regjistrin, planin ditor e tremujor të mësueses, fletoret e detyrave të shtëpisë së nxënësve. Duke i parë me kujdes e pa u ngutur, ai mbante edhe shënime në një rradhua të trashë.

Mësuesja e re në fillim e ndjeu veten keq e u hutua. Pse vallë? Sepse ish kontrolli i parë apo sepse drejtori kish zënë vendin e saj dhe nuk i vinte mbarë për të bërë veprimet e nevojshme? Kur kish bërë praktikën pedagogjike, të gjithë sa kishin ardhur ta dëgjonin — aty ishin edhe drej-

tori i shkollës e mësuesit e saj — kishin ndenjtur në fund, prapa nxënësve. Kurse ky... Ja, ajo shënoi datën dhe mungesat duke iu dredhur duart ca nga tronditja e kontrollit të parë e ca ngaqë nuk i volitte vendi. Nga kjo e la për më pas temën e mësimit. Edhe gjatë mësimit ajo nuk e kish në dorë klasën, nuk e tërhiqte dot në procesin e punës, sepse nxënësit kur e kur shihnin me kureshtje nga drejtori.

Tefta bisedonte për çdo çështje me mësuesit e tjerë, sidomos me ata të matematikës. E kishin këshilluar ata që, në ngjashmëri me problemat e tekstit, të krijonte vetë disa, me të dhëna konkrete nga kooperativa. Ajo qe bindur shpejt se, në këtë mënyrë, problemat bëheshin më të qarta për nxënësit dhe, vec kësaj, lidhej edhe mësimi me jetën, prandaj e ndiqte vazhdimisht këtë praktikë pune. Atë kohë në fshat kish nisur një fushatë e vërtetë për grumbullimin e plehrave organike të anëtarëve në dobi të kooperativës, pa asnjë interes. Tefta në mësimit e saj s'e kish lënë të kalonte në heshtje këtë fushatë. Kish marrë ca të dhëna nga brigadierët dhe me këto të dhëna kish krijuar disa problema, njërën prej të cilave e shfrytëzoi për dhënien e mësimit të ri pikërisht atë orë që i vajti për kontroll drejtori.

— Siç e dini, — tha ajo, — këto ditë, anëtarët e kooperativës sonë po i falin kooperativës plehrat organike të oborreve të tyre. Kjo tregon se ata e kanë kuptuar vlerën e pronës së përbashkët dhe se i janë vënë me mish e me shpirt shtimit të drithrave, shtimit të prodhimeve bujqësore...

Drejtori i kish lënë shënimet e tij, kish hequr gjyslyket dhe po e vështronte mësuesen me habi.



Kjo kujtoi se drejtori po e pëlqente një hyrje të tillë dhe vijoi më me zell:

— Deri tani janë grumbulluar 3.400 kv. pleh. Plehu është shpërndarë në parcela të ndryshme. Brigada e parë ka marrë 90% më shumë pleh se brigada e dytë, kurse e treta 120% më pak se e dyta. Sa kv. pleh organik ka marrë secila brigadë?

Kur mësuesja mbaroi pyetjen dhe po e shënonte atë në dërrasën e zezë, karrigia krisi e drejtori brofi në këmbë. Mësuesja qendroi në pritje. Drejtori e shikoi rreptë, po s'foli fare. Ai rrëmbeu fletoren e trashë dhe një libër aritmetike që kish marrë me vete, dhe doli nga klasa.

Natyrisht, mësueses i bëri përshtypje të madhe një sjellje e tillë e papritur, po e zotëroi veten dhe vazhdoi mësimin.

Drejtori ndërkaq hyri në dhomën e mësuesve. E hodhi me inat fletoren mbi një tavolinë dhe tha me përbuzje:

— Mësim është ky? O kasolle, ku na mblodhe! Ka dëgjuar e bija e botës se mësimi duhet lidhur me aktualitetin dhe hop, na i mbush problemat me pleh! Dhe e zinte në gojë pa pikën e drojtjes! Ç'vulgarizim i tmershëm!

Mësuesja e re e pati vështirë gjatë analizës së mësimin. Drejtori e paralajmëroi në mënyrë të prerë se do ta nxirrte nga klasa herë tjetër, po të bënte një mësim të tillë, banal! Nuk harroi të shënonte në «detyrat» për mësuesen që ajo të shkruante temën e mësimin në regjistër, t'i aktivizonte më mirë nxënësit, t'ua vinte notën e detyrës në anë të fletores e jo në mes e sa e sa çështje të tilla me rëndësi. «Fshatarja» po çuditej gjithnjë e më tepër dhe mezi e mbajti veten t'i

thosh se këto vërejtje ishin vogëlsira dhe për mësimin s'po bëhej fjalë fare. Për këtë analizë ajo bisedoi me mësuesit e tjerë.

— E pse të ka bërë kaq përshtypje? — pyeti njëri. — Drejtori, kur vjen për kontroll, do të bëjë edhe vërejtje.

— Të tilla vërejtje?

— Përse çuditësh?

— Por këto vërejtje s'lidhen fare me mësimin!

— Drejtori ynë ka borxh të të bëjë vërejtje. Lidhen apo jo me mësimin, këtë shikoje vetë!

Disa qeshën. Leni e shikonte me inat Teftën sikur desh t'i thosh: «Pa ardhur mirë, e fillove të shesësh mend! Po fshatarët aq e kanë: po të dinë pesë para gjë, hajde e mbaji pastaj!»

— Nga ai që më vjen për kontroll e ndihmë, unë pres diçka që të më vlejë për ta bërë mësimin më mirë, për t'u bërë mësuese më e mirë, — tha Tefta sikur të mos kish dëgjuar ç'tha me shaka shoku i saj e pa i vënë rëndësi vështrimit për-buzës të Lenit.

— Gjykim shumë me vend! — tha njëri.

— Mirë e ka ajo, vërtet, po...

— Çfarë «po...»?

— Drejtori ynë, moj çupë, është mësuar me një formë pune, që, si të them, është vjetëruar! Ai kërkon rregull e përpikmëri në çdo rast. Çdo gjë e shih jo nga vlera e domethënia, po nga forma. A është i bukur ky send? Nëqoftëse po, është plotësisht i kënaqur, ndryshe...

— Po ju? — pyeti me habi mësuesja e re.

— Ne? Ne shikojmë punën tonë, përpiqemi ta bëjmë sa më mirë dhe mundohemi ta ruajmë edhe anën formale, që të kënaqet ai.



— Domethënë jeni pajtuar me këtë formë pune të vjetëruar, siç thatë vetë!

— E ç'të bësh tjetër?

— Ç'të bësh tjetër? Po sikur ta shkundësh ca atë drejtorin e vjetëruar?

Mësuesit u panë sy në sy. Njëri vuri re ç'përshypje i bënë Lenit këto fjalë. Po kjo bënte sikur s'e kish mendjen aty. Dikush qeshi.

— Drejtorit tonë nuk i kthen dot fjalë. Ai s'pranon asgjë. «Ehu, — thotë, — ju keni qënë nxënësit e mi!» Ai nuk arrin dot kurrë ta kuptojë që një ish nxënës i tij mund të dijë baras me të. Ato që thotë ai, janë të peshuara e të drejta sipas tij.

— Tamam për këtë duhet shkundur njëherë e mirë. Por puna është se edhe ju...

Atë çast ra zilja për fillimin e mësimit. Po biseda sapo kish filluar... Dhe ish një bisedë interesante, nga më interesantet e më të guximshmet që ishin bërë deri atëhere në atë shkollë. Bisedohej për të mirën e punës. Njëri tha me shaka se duhej vetëm shkëndija që të ndizej zjarri. Dhe shkëndija ish Tefta, mësuesja e re. Vetëm Leni nuk merrte pjesë në këtë bisedë.

Ajo u mundua ti jepte fund një muhabeti të tillë që i dukej fyes si për autoritetin e drejtorit, ashtu dhe për atë vetë, duke kurdisur një tjetër. Se nga kish marrë vesh që Tefta dashuronte një djalë nga fshati i saj dhe këtë e tha faqe të gjithëve. «Fshatarja» u skuq pakëz në fytyrë.

Tefta nuk dinte ç'është sekreti. Në fshatin e saj e njihnin si vajzë të çiltër e për të thoshin se «i kish sahanet pa kapak». I kishin thënë se, sa më e fshehtë të qe dashuria, aq më e ëmbël ish.

Kur e provoi, ajo qeshi me tallje. Si mund ta mban-te të fshehur dashurinë? Dëshira për fshehtësi tek ajo kish zgjatur pak, shumë pak, sepse nga çasti në çast zemra i mbushej e i mbushej me gëzim e kënaqësi dhe ajo ndjente nevojën t'i hapej dikujt, t'a zbrazte tepricën.

Prandaj edhe këtu nuk i kundërshtoi fjalët e Lenit.

— Po, — tha, — është e vërtetë.

— Po ai është fshatar?! — gati sa s'klithi Leni.

— E pastaj?

— Ti do të marrësh një fshatar që punon në kooperativë?!

— Pse, të duket një gjë e jashtëzakonshme ty?

— E jashtëzakonshme është vërtetë. Ti je vajzë me shkollë, mësuese, kurse ai...

— Ai është punëtor, i bukur. Oh, ti s'e njeh atë!

— Ah, po, fshatare! S'thashë kot unë sapo të njoha!

Tefta u prek nga këto fjalë. Sytë e zinj i lëvizën me shpejtësi e sikur i lëshuan shkëndija kur ndeshën në ato të Lenit. Por e zotëroi veten e tha me seriozitet:

— Po, unë jam fshatare, por kjo s'më bën përshtypje. Unë kam njohur mjaft qytetare, mi-rëpo ato s'janë si ti. Ti ëndërron të martohesh me ndonjë doktor a inxhinier që të banojë në Tiranë, fundja edhe në Korçë, po me kusht që të ketë një shtëpi të mirë, me qilima të shtrenjtë e perde të rënda, me pasqyra, sidomos...

— Pse, keq është të ëndërrosh për një jetë më të mirë?

— Ka ëndërra e ëndërra. Edhe jeta e mirë



është si ta marrësh. Ti do të vdisje nga turpi po të lidhje jetën me një fshatar, kurse unë jam e kënaqur sa s'bëhet. Për mua ka rëndësi që ta dua e të më dojë shoku i jetës. Mua do të më merrej fryma në atë dhomën komode, borgjeze, që ëndërron ti...

Kur dëgjoi fjalën «borgjeze», Leni kërceu nga vendi e zuri të fliste me nxitim, duke e sharë «Fshataren», që po i «bënte moral» e që guxonte të thosh gjëra «të rrezikshme» e të paqena, se ajo, Leni, e urrente borgjezinë. Po Tefta tundi kokën e iku pasi i tha që, edhe pse e urrente borgjezinë mendonte e sillej tamam si borgjeze.

Të nesërmen Tefta po u ndihmonte nxënësve të saj për të larë klasën. Kish përveshur mëngët, kish vënë një përparëse dhe flokët i kish lidhur me një shami të bardhë. Drejtori po shkonte klasë më klasë. E pa Teftën midis nxënësve të klasës, u prish në fytyrë dhe u largua pa thënë asnjë fjalë. Pas pak e thirri në drejtori.

Tefta vajti menjëherë.

— Ku hyn kështu? Ti e tërbon njeriun me sjelljet e tua të pahijshme. Ku hyn kështu pa trokitur? Ç'më ke ardhur kështu sikur do të korrësh?

— Përse më ke thirrur? — pyeti ajo pa ja vënë veshin inatit të tij.

— Përse të kam thirrur? Flet me ti, fare pa edukatë... ah! Ja, për këto që bën të kam thirrur! Sa herë të kam thënë që të sillesh korekt si mësuese që je? Ti vete e përvishesh sikur je shërbyese!

Vajza s'foli. Ajo shikoi nga dera duke lënë të

kuptohej se s'ja kish ngenë të dëgjonte kësi muhabetesh. Drejtori kaloi në një temë tjetër:

— Kam marrë vesh se bën dashuriçka atje në fshatin tënd. Edhe ajo duhet! Unë nuk lejoj që në shkollën time të ketë mësuese imorale!

— Mbaj gojën, drejtor! Unë do të fejohej me atë që dashuroj dhe s'kam ndërmend të të marr lejë ty! — tha Tefta duke u dredhur nga inati.

Drejtori kërcëu përpjetë.

— Të mbaj gojën, the?! — klithi.

— Po, të shikosh punët që të takojnë, jo të fyesh.

— Do të shohësh që kam për t'i parë. Dhe kam për t'i parë, që ç'ke me të! Ja unë, ja ti këtu, ta dish! Pa ke filluar edhe të llomotitësh poshtë e përpjetë për mua! Ç'të bëmë ty këtu? Po s'të thonë kot fshatare. Ti ke lindur për kazmë, ti femër pa edukatë, rebele!..

— Dhe ti do ish mirë të kishe lindur nja njëzet vjet më parë dhe tani të kishe mbaruar, — tha me ironi «fshatarja» dhe doli pa e dëgjuar më tej drejtorin, i cili po turfullonte.

Sa doli ajo, drejtori i tha kujdestarit të ditës që t'i lajmëronte të gjithë për një mbledhje me rëndësi. Mësuesët muarën nga një fletore dhe zunë vend kush e kush më prapa në rreshtat e fundit të bankove të një klase. Ata ishin mësuar me mbledhje të tilla dhe s'u bënë aspak përshtypje. Po Teftës iu drodh trupi. Kish frikë? Jo, nuk kish. Por i vinte edhe turp, edhe rëndë që do të bëhej një mbledhje enkas për të, se ajo besonte se kjo mbledhje bëhej për të. Ajo ish e re si në moshë, ashtu dhe në detyrë. Ndoshta e kish gabim? Por asaj iu kujtua se si disa mësues i kishin përkrahur



fjalët e saj, kur kish thënë që drejtori duhej shkundur ca. Ndoshta ajo nuk do të kish patur guxim t'i kundërshtonte drejtorit. Ndoshta do të kish heshtur kokulur para tij dhe me kohë do të mësohej me këto të bërtitura e nuk do t'i bënin më përshtypje. Mirëpo ato ditë kish lexuar në shtyp një artikull me titullin «A ka burokratizëm në arësim?» Ky artikull i «Zërit të popullit» i kish dhënë zemër e guxim. Ai i kish sqaruar shumë gjëra që më parë s'i kuptonte dot.

Pastaj këtë radhë Teftën do ta përkrahnin edhe shokët e saj. A nuk e kishin lexuar edhe ata me interesim të madh këtë artikull. A nuk kishin biseduar me zjarr rreth problemeve që ngriheshin në të? Fundja, ajo s'kish bërë asgjë të keqe. Ç'i duhej drejtorit të ndërhynte në punët e saj personale? Pse ta fyente ai? Vajza e re hyri ngadalë në klasën ku do të bëhej mbledhja.

«Akulli u thye, — tha me vete. — Por, po të lihet me kaq, ujrat do të pengohen aty e do të përmbytin vendin rreth e qark. Akulli duhet thyer edhe më tej, që ujët të shkojë lirisht në jaz».

Drejtori s'dukej aspak i nxehur, si në drejtori. Duhej ta shihje me kujdes për të dalluar se ai damari i tij i tëmthave s'ish qetësuar ende dhe ngjante si një krimb që tkurret e zgjatet, po s'lot dot nga vendi.

— Ju thirra, — filloi ai, — se s'jemi gjëkund fare. Pezhishka kudo, baltë, pluhur, nxënësit mungojnë, gazetatat e murit s'janë ndërruar. Po s'kini faj ju! Fajin e kam unë që ju kam lejuar të shini si të doni! Po! Këto ditë na vjen një ekip! Mua nuk më intereson se si do të bëni. Unë dua...

Si mbaroi rrebeshi i kërkesave në formë ultimatumi, drejtori shtoi:

— Dhe shikoni, dikujt po i rritet mendja si shumë, po!.. E kam fjalën për Teftën! Ka filluar ta pastrojë klasën, të kujdeset për të, por...

Tefta u ngrit pa kërkuar lejë. Iu kujtua artikulli i «Zërit të popullit». Tani ajo dinte si t'ja vinte emrin këtij drejtori. Dhe tha qetë-qetë:

— Mirë e the, shoku drejtor. Duhet të bëjmë një pastrim të plotë. Këtu mban erë myk. Myku duhet fshirë...

— Jashtë! Dil jashtë! — thirri pa pritur drejtori.

— Ajo ka të drejtë, — tha një mësues.

— Po, — shtoi edhe një tjetër.

Të tjerët, veç Lenit, pohuan me kokë dhe drejtori e kuptoi se ata i jepnin të drejtë Teftës.

Ai diç mërmëriti, po s'e ngriti zërin më. E kish zakon të thërriste e t'i trembte të tjerët, po kurrë s'desh që të vinte më lart një çështje që kish të bënte me shkollën e tij. I dukej si fyerje, se do të thoshin në seksion që ai s'ish i zoti ta zgjidhte çështjen vetë. Apo kish frikë? Kushedi. Në këto raste ai mendohej të tërhiqej me marifet.

Kështu po bënte edhe tani.

Tefta kish marrë zemër nga përkrahja e kolegëve të saj.

«Akulli u thye, — tha përsëri me vete. — Tani uji do të rrjedhë tatëpjetë pa gjetur asnjë pengesë».

E ndjente veten të fortë, të kënaqur e të gëzuar.



## DITARI I NJË PARTIZANEJE

2 tetor 1943

Shkolla jonë u mbyll, ose, më mirë të them, nuk u hap fare sivjet. U ktheva në fshat. Në fillim isha shumë e mërzitur, po shpejt u mësova edhe me këtë gjendje të re. Për fatin tim të mirë, qëlloi koha me shi. Kur bie shi, fshatarët s'kanë ç'bëjnë nëpër ara dhe ja shtrojnë me muhabet. Tek unë vijnë plot vajza, shoqe moshe. Vajzat e fshatit janë shumë të muhabetit dhe s'më lënë të mërzitem.

Më tepër vijnë tek unë Lefka e Goni. Lefka është vajzë e bukur syzezë, trupdrejtë e shumë e hedhur. Flet me nxitim. Tani është e gëzuar sa s'bëhet më, pas pak s'i flitet fare. Unë çuditem me të. Por ndoshta e ka kështu ngaqë e kanë përkëdhelur mjaft. Ka ndenjur ca kohë në qytet; te xhaxhai i saj. Lexon shumë. Sapo erdhi tek unë, ditën e parë, më kërkoi libra. Unë kisha disa pjesë të romanit «Nëna». I thashë se mund t'ja jepja, po ajo më pyeti:

— Është me dashuri?

— Edhe dashuri ka, — i thashë duke qeshur.

— Po dashuria në të është më tepër për njerëzit që vuajnë...

Ajo s'më la të mbaroja. Tha se kish lexuar «Bija e mallkuar», «Konti i Montekristos», «Maska e zezë», e të tjerë si këta.

— Më kanë pëlqyer shumë, — shtoi ajo. — Po të mos jetë i tillë ai «Nëna», kot që të ma japësh.

Sot, sapo erdhi, më tha:

— Gjeta librin «Manon Lesko» dhe e lexova me një frymë. Ah, moj Dhora, sa keq! Ajo vdes në rrugë, atëhere kur duhej të ishte e lumtur.

Pastaj shtoi me lot në sy:

— Kam frikë, moj Dhora, kam frikë se mos edhe dashuria jonë nuk do të ketë fat më të mirë. Oh, ç'qenka dashuria!

— Sa budallaqe që je! — i thashë.

— Vërtet, — tha, — nganjëherë bëhem fare budallaqë, — dhe iku si e lehtësuar. Më ka thënë se dashuron një partizan, i cili e ka patur ca kohë si bazë shtëpinë e tyre.

Nuk besoj që ajo të dashurojë vërtet. Ndoshta i duket sikur dashuron. Sidoqoftë, unë nuk do të jem kaq e dobët në dashuri. Besoj se dashuria të bën të fortë, të jep krahë. Po që se dashuria të sjell lot e dhembje, siç thotë ajo, nuk e dua fare.

Goni është krejt e kundërta e Lefkës. Është vajzë punëtore. Nuk duket të jetë e dhënë pas leximeve, por, sapo dëgjoi përse bën fjalë «Nëna», ma kërkoi. Siç thonë në fshat, Lefka shet, kurse Goni blen.

#### 4 tetor 1943

Sot erdhi nga Tirana një djalë nga fshati ynë. Ai punonte atje, më duket, në një punishte private, që bënte krevatë hekuri. Emrin e ka, Kristo, po



i thërresin Taqo. Është djalë i pashëm, me trup të gjatë e sy plot zgjuarësi.

E takova rastësisht. Më pëlqeu biseda e tij. Fliste e qeshte. Djemtë e tjerë të fshatit, kur flasin me mua, sikur druhen, po ai jo. Ai fliste shumë çpenguar. Më tregoi plot të reja me rëndësi nga Tirana. Thonë se është komunist dhe se edhe këtu do të merret me punët e Partisë Komuniste. Ndoshta më tepër nga kjo më pëlqente të rrija me të. Kam dëgjuar kaq shumë për komunistët!

Këtu, në fshat, pashë për të parën herë partizanë. Sa më pëlqyen! Kur erdhën një natë tek ne, më bëri përshtypje se ja gjenin anën muhabetit e flisnin shtruar me këdo. Ndryshe folën me mua, ndryshe me babanë e nënën, ndryshe me Koçon e vogël.

— Këta, moj bijë, — thotë nëna, — ta dinë ku të pikon çatia. Yt atë në fillim sikur kish frikë prej tyre, po tashti, siç e pe, kokën jep për ta.

### 6 tetor 1943

Pothuaj gjithë ditët me shi i kaloj me Gonin. Ajo është shoqja ime më e ngushtë. Ne jemi të një mendjeje për çdo gjë. Shumë na thonë se edhe ngjasim. Sot kish ardhur ajo tek unë dhe po bënim çorape.

— Dhora! — u dëgjua që jashtë zëri i Lefkës. Hyri brenda sikur ta ndiqnin. Dukej shumë e gëzuar.

— Sa mirë që ju gjeta të dyjave! — tha e na puthi. — Kam një lajm të rëndësishëm, moj çupa. Tani sapo u ndava nga Taqua. Ish me një të panjohur, duket ndonjë partizan. A e dini ç'më tha? Më tha të bëjmë pjesë dhe ne çupat në gru-

pet e fshehta. Edhe ne duhet t'i ndihmojmë partizanët!

Ne na bëri vërtetë përshtypje ky lajm. «Të ndihmojmë partizanët.» A do të jemi të zonjat ne për ta bëjmë këtë? Më duket se nuk është një gjë e thjeshtë kjo, ashtu si e paraqit Lefka. Po le që ajo asgjëje s'i vë rëndësi. Gëzohet shpejt, premtion, po...

Sidoqoftë, ne vendosëm të vemi për t'u takuar me Taqon dhe me atë të panjohurin.

Mamasë i thashë se do të venim nga Lefka. Për të mos dyshuar, ne muarëm edhe punën e dorës me vete.

### 8 tetor 1943

Ja, edhe ne jemi aktiviste të luftës për liri. Tani për tani puna jonë nuk është shumë e vështirë; duhet të bëjmë çorape e fanella për partizanët, t'i strehojmë kur vijnë në fshat, e të jemi në lidhje me shokët e njësitit të fshatit.

Por më vonë të shohim, kështu na thanë.

Me sa ma merr mendja, duhet të kryejmë edhe punë të tjera më serioze. Po, me këtë «të shohim», shokët kanë parasysh që ne të provohemi.

Le të na provojnë dhe të shohin!

Më vjen keq që s'na besuan menjëherë. Po s'ke ç'i bën; kështu e duan këto punë.

Sot fillova nga punët që m'u ngarkuan dhe ndjehem e kënaqur, sepse edhe unë do të bëhem e vlefshme për njerëzit.

### 26 tetor 1943

Brenda një kohe të shkurtër ne jemi bërë shoqe që punojmë për partizanët. Sofia dhe Gjena qepin



në maqinë rroba për ta. Çdo ditë na del nga një diçka e re, që në dukje nuk bie në sy. Ne bëjmë me qejf çdo punë që u kushtohet trimave tanë.

Në fshat nuk druhemi nga askush. Të gjithë këtu janë me lëvizjen. Rrapon, që kish filluar ta trashte punën me ballistët, fshatarët e demaskuan vetë në mbledhje.

Shpesh ka qëlluar të mbledhin ushqime. Dhe jo me torba, po me thasë!

Megjithatë, ka ca gjëra për të cilat duhet kufizim. Mua më pëlqen të shënoj se bëj pjesë në të paktët më të besuar.

### 30 tetor 1943

Përveç detyrave të tjera që kemi, ne duhet të sqarojmë në popull rrugën e vërtetë të luftës çlirimtare dhe të luftojmë prapambetjen. Sikur këtë punë ta bënim në fshatin tonë, nuk do ta kishim edhe aq vështirë. Po një nevojë e tillë ndihet në fshatin e madh fqinj. Atje gratë, e sidomos çupat, janë më të shtypura se ne.

Sot na u desh të venim atje. Isha unë, Goni dhe një shok nga fshati, që na shoqëronte. Tek çezma u bashkuam me ata që na prisnin dhe pastaj bëmë një takim të fshehtë me një grup vajzash, në shtëpinë e njërës nga ato.

Biseduam për shumë gjëra. Për prapambetjen që trashëguam nga e kaluara, për jetën, për luftën e çlirimit. Vajzat nuk flisnin fare, kishin turp edhe nga ne.

Kur po flisnim për partizanët, ato u shikuan në sy dhe njëra guxoi e tha:

— Qyqja! Atyre t'u ndihmojmë ne, moj? Ata janë pa din e pa iman, pa fe e pa nder!

Ne e kuptuam se balli kish bërë punën e tij këtu.

— Kush tha se partizanët janë të tillë?

— Po tërë flasin për këto...

— Cilët janë këta «tërë»? Kjo është çpifje e ballistëve!

Si mund të flitet kështu për partizanët? Ata për nderin e tyre e tonin, për nderin e vendit, kanë dalë malit e luftojnë si luanët. Rrinë atje pa bukë dhe pa gjumë, të zveshur e të zbathur, në shi e në të ftohtë. Mos vallë nga qejfi? Kurse ata të «ndershmit» vërtiten fshatrave, plaçkitin e vjedhin, u bien në qafë grave të botës dhe kështu «luftojnë për kombin!».

— Mirë thotë, — tha njëra. — Sapo vijnë në shtëpi, që në oborr, ata kërkojnë pula të pjekura e raki. Ne na kanë ardhur njëherë edhe partizanët. U dhamë bukë me domate e me gjizë. Dhe jo vetëm që nuk bënë naze, po u kënaqën dhe na falënderuan.

Si përfundim, ne ja arritëm qëllimit dhe caktuam mënyrën se si do të punonim e të mbanim lidhje me to.

Kur u ngritëm, hyri brenda i zoti i shtëpisë, që më parë nuk ish aty. Ai tha:

— Në doni të tërbohi ju me komunistët, shkoni ferrave, se s'ju ndalon njeri. Po çupat tona s'i lëmë të bëhen bishtdredhura!

Më erdhi sa t'i kërceja në grykë atij matufi. Po s'bënte. Na u desh t'i bënim politikë edhe atij. Dhe u sqarua që ç'ke me të!

## 5 nëndor 1943

Me Gonin nuk ndahemi fare. Të dyja kemi



vendosur që të luftojmë me çdo mënyrë. Ndërsa Lefka çdo ditë po bëhet më frikacake dhe e pavendosur. Njëherë i dhëmb koka, njëherë e pengon e ëma dhe gjithnjë e zvarris punën. Ne shpesh s'e lajmërojmë për punët e terrenit. Dhe ajo kënaqet nga kjo.

Po sot ndodhi diçka që më prishi fare me të. Kish ardhur partizani i saj. Ai ish me Taqon. Dësh ta takonte, se e kish marrë vesh lëkundjen e saj. Unë vajta i thashë Lefkës.

— Po ja, moj Dhora, si të bëj, unë e zeza! Ai është me kokë në torbë. Ja vritet, pastaj kush më merr mua, që mbetem e gojosur?

Ja, si mendoka! E shikova me inat, por s'i folja, veç ika me nxitim.

— A e dashuron ti? — i thashë partizanit, kur u ktheva.

Si të them? Tani nuk është edhe koha për t'i menduar hollë këto gjëra, — tha ai.

— Ti duhet ta urresh atë, — i thashë unë dhe ja tregova çështjen.

M'u duk se i erdhi keq kur dëgjoi fjalët e mia. Më shikoi me simpati: duket i kish bërë përshtypje gjykimi im, po s'foli fare. Psherëtiu thellë e pastaj bisedoi për çështje të tjera, sikur të mos kish ndodhur gjë.

Kur iku ai, unë mbeta me Taqon.

Shumë herë jam takuar me të, po sot nuk e di përse e vërejta me hollësi, si për ta studjuar.

Vë re se çdo gjë është e përsosur te ky njeri. Apo kështu më duket mua?

**30 nëndor 1943**

Lefka s'bën pjesë më në grupin tonë. Sot Goni

kasten i tha se ne të trija duhej të delnim në mal. Ajo zuri të qante dhe të betohej se s'kish ç't'i bën-te s'ëmës, pa edhe ajo ish gati.

Tani unë e Goni jemi bërë goxha të dëgjuara. Emrin tonë e kanë përmendur për keq ballistët kaq herë. Dendur jemi ndodhur ngushtë.

Taqua na porositi gjithmonë që të jemi të kujdesshme. Sa shumë punon e përpiket ai njeri! Kurrë nuk e kam dëgjuar të ankohet. Dhe gjithnjë është i palodhur e plot besim. Këto shënime unë i mbaj për vete dhe s'kam pse ta fsheh:

— Unë e dua atë, e dua pa masë!

Po të më pyeste njeri përse e dua, do t'i përgjigjesha: «Nuk e di, po më duket se për çdo gjë».

### 5 dhjetor 1943

Goni e ka kuptuar që unë e dua Taqon. Ajo më tha tërthorazi një ditë se edhe ai më do. E kundërshtova këtë bisedë, po zemra ma desh të vazhdonte e të ish e vërtetë ashtu si tha ajo.

Atë ditë, sapo biseduam për çështjen e punës sonë, ajo na la të dyve. Kur mbetëm vetëm, ne nuk folëm një copë herë. Të dy rrinim me druajtje. Ishim afër shtëpisë sime. Pa prituri na doli përpara Koçua, vëllai im i vogël.

— Opa! Do t'i them mamasë! — thirri ai dhe, sado që u munduam, nuk mundëm ta mbanim.

E dua shumë shejtanin, po nganjëherë është ters i madh. Taqua ka ardhur shumë herë në shtëpinë tonë. Prindërve të mi ai u ka hyrë në zemër. Edhe Koçua vetë e do dhe gjithnjë e mërzit për t'i mësuar këngë partizane. Po sot ç'i shkrepit? Dhe mirë nuk është të thotë në shtëpi ato fjalë...



Duke menduar kështu, u skuqa në fytyrë.  
Edhe vetë e kuptova këtë.

Pas pak Taqua tha me një zë të butë e si të dredhur:

— Më duket se ai shejtan i ra në të. Kur të fitojmë lirinë, ne... Si thua, Dhora? Ti je kaq e mirë dhe e vendosur, je guximtare... Unë të dua...

Zemra m'u hodh përpjetë. Disa herë përgjigja m'u ngjit gjer lart po buzët s'e lanë të dilte.

Megjithatë, i thashë «Mirupafshim!» dhe ika me nxitim.

Ah, ç'jemi edhe ne vajzat!

Koçua i vogël u bë shkak, pra, që të thyhet akulli ndërmjet nesh. Tani do ta dua më tepër...

## 26 mars 1944

Zuri të bjerë erë pranvere. Dëbora, sado e shumtë që ish, u shkri e tëra. Vende-vende, anës kumit e pas drizave, kanë dalë aguliçet.

Natyra ka punën e saj. Ajo s'pyet për luftën e përpjekjet e njerëzve.

Me luftën që bëjmë ne, tani jemi mësuar. Ajo na është bërë aq e nevojshme, sa që s'mund t'a marrim me mend si do të jetonim ndryshe.

Ka kohë që Taqua ka dalë malit. Ai shkoi me batalionin, larg zonës sonë.

Kam dëgjuar të thonë: «Larg syve, larg zemrës». Jo, s'është e vërtetë! Unë tani që jam larg tij, e dua më shumë.

Sa shumë besim kam në këtë dashuri! Ajo është e dyfishtë: ne e duam te njeri-tjetri edhe dashurinë për çështjen e madhe të lirisë.

Ah, kur do të vijë ajo ditë! Sa shumë e pres unë atë!

### 30 mars 1944

Qendrimi ynë në fshat është bërë shumë i vështirë. Kanë filluar të na gjurmojnë. Na është dashur shpesh të tregohemi me tjetër fytyrë. Jo, unë nuk dua të tregohem ndryshe nga ç'jam! Dua t'i tregoj armikut se e urrej në kulm. Dua ta vëshetroj atë drejt në sy dhe ta luftoj për vdekje!

Të dyja me Gonin vendosëm të dalim partizane. Batalioni, siç muarëm vesh, ka ardhur përsëri këtej. Edhe shoku i terrenit nuk e kundërshtoi dëshirën tonë.

Nesër do të nisemi! U thamë edhe në shtëpi. Babai s'foli, ndërsa nëna qau. Ata kurrë s'më kanë penguar. Shpesh kanë bërë sikur s'i marrin vesh punët e mia. Po sot e pashë që u dëshpëruan shumë. Eh, cili është ai prind që ka përcjellë pa dhimbje birin a bijën e tij në luftë? Por ka luftë e luftë. Kjo që bëjmë ne, është luftë e shenjtë, është detyrë ndaj atdheut e lirisë, një detyrë e madhe. Ata e kujtojnë këtë.

Nesër fillon për ne një jetë e re, plot vështirësi, por një jetë e vërtetë, për njerëz të vërtetë!

### 31 mars 1944

Kur muarëm rrugën e malit, Goni psherëtiu dhe i shpëtuan lotët.

— Ndoshta nuk do të kthehemi më, Dhora, —tha ajo.

— Jo, i thashë, — ne do të luftojmë e do të fitojmë dhe kemi për t'u kthyer. Ja të shohësh! Tek unë ndodh ndryshe. Kam besim të madh



në të ardhmen. Edhe mua më vjen keq që po iki nga fshati. Po mallëngjimi dhe keqardhja errësohen nga gëzimi që po filloj një jetë të re, të vërtetë.

Partizani i parë që takuam na tha se shoku Taço, komisar i kompanisë së dytë, ish aty shëndoshë e mirë.

Pra, qenka bërë komisar kompanie! Dhe asnjëherë s'më ka shkruar për këtë! Në këtë çast ndjeva një dashuri të pakufishme për këtë njeri të thjeshtë e të dashur.

Ky lajm ish për dashurinë time ashtu si është benzina për zjarrin.

Vendosëm t'i dalim papritur, pa e lajmëruar. E pamë që po shkante rrugës, dhe u fshehëm. Unë dolla përnjëherësh. Ai u zbraps.

— Ti këtu?!

— Po, shoku komisar!

— Partizane ? Do të rrish këtu?

Si përgjigje unë iu hodha në krahë. Ai më shtrëngoi një çast dhe pastaj më largoi papritur lehtëzi.

— Nuk bën kështu, Dhora, nuk bën...

— Çfarë nuk bën?

— Ja, duhet të jemi të matur...

— Si?!

Ika me të katra dhe kur m'u lodhën këmbët, u plasa në tokë dhe fillova të qaja me dhëmbje. Përkë më merr mua ai? Gjesti i tij më dukej se e kish fyer aqë rëndë ndjenjën time të dashurisë, sa që s'mund të mendoja që të pajtoheshim më.

Pas pak dëgjova se dikush po vinte. As që lëviza nga vendi, po e kuptova se do ish ai me Gonin.

Ç'bën kështu, moj budallaçkë? — më tha Goni dhe u mundua që të më ngrinte. Taqua rrinte si i rrahur.

— Ti s'më kuptove, Dhora. Mos vallë unë nuk vuaj larg teje? S'të dashuroj, thua? Ah, kur më përqafove, m'u duk se në atë çast kisha zënë qiellin me dorë. Aq i lumtur isha. Po shpejt u kujtova për detyrën tonë të shenjtë.

Unë s'fola fare.

— Tani edhe ti je patizane, e dashur. Dhe duhet ta dish, pra, se ligjet partizane nuk lejojnë gjëra të tilla... Po të na shihte njeri atë çast, a e di? Ne mund të dilnim në gjyq...

**18 prill 1944**

Sot po pregatitemi për një aksion me rëndësi. Jam pranë Taqos. Ne rrimë shpesh bashkë. Dashurohemi në heshtje. Flasim me zjarr orë të tëra. Po nuk e prekim fare njëri-tjerin.

Ah, gjer kur do të vazhdojë kështu? Kur do të shporren nga vendi ata që na pengojnë që ta gëzojmë jetën? Por ata s'ikin vetë, do t'i shporrim ne!

Tani edhe unë i kuptoj drejt ligjet partizane. Unë e kam këtë të metë: rrëmbehem shpejt. Po tani më duket se jam bërë pak më e mençme dhe i kuptoj ndryshe gjërat. Unë kam patur disi të drejtë. Vërtet nuk mund të ketë ligje njerëzore për të ndaluar dashurinë, dashurinë e vërtetë. Mirëpo, nën emrin e dashurisë çfarë nuk mund të ndodhë!

Na ka qëlluar rasti të flemë tok në një dhomë, vajza e djem dhe e kemi ndjerë veten si vëllezër e motra të vërteta.



Unë e kuptoj se ky është frut i ligjeve të rrepta të malit.

Pardje na qëlloi rruga dhe u kthyem në fshat. Ish edhe Taqua me ne. Kur vajta në shtëpi, ndjeva se sa shumë më kish marrë malli. E puthja çdo çast Koçon e vogël. Edhe ai s'më ndahej. «Do vi edhe unë me ju, — thosh. — Do bëhem partizan!»

Që kur u larguam përsëri, Goni ndjehet më tepër e malluar. Ç'vajzë e mrekullueshme që është! Ka zënë shumë shoqe këtu. Të gjithë e duan. E dua edhe unë. E dua, se është trime, punëto-re dhe zemërbardhë. E shoh që më do me gjithë zemër dhe s'ndjen aspak zili a cmirë për ne.

Mirë që m'u kujtua. Po shkoj ta gjej. Duhet të jemi bashkë në aksion. Ku dihet? Luftë është...

## 20 maj 1944

Po bëja më tepër se një muaj në këtë kasolle në mes të malit, që ne e quajmë spital partizan.

Sot ndjehem fare mirë. Plaga m'u mbyll dhe dhëmbje s'kam më.

Oh, çfarë s'i ndodh njeriut! Sidomos në kohë luftime, një fije peri e ndan jetën nga vdekja.

Ai mëngjezi i aksionit ish i bukur. Nuk më vinte të besoja se në një ditë aq të këndshme do të përlesheshim dhe të vriteshim me armiqtë.

Na foli vetë komisar i batalionit. Duhej të sulmonim kazemat e armikut. Ndjeheshim të tronditur. S'i thoshin shaka. Gjer atë ditë ishim, ndeshur disa herë me gjermanët, po me grupe të vogla. Luftën e vëtetë s'e kishim provuar.

Gjersa u dha urdhëri i zjarrit, mua nuk më

pritej. Edhe kisha frikë, edhe ndjenja gëzim, se, më në fund, do vrisja armiq. Përkëdhelja automati-kun tim dhe rrija në pritje pranë Taqos e Gonit.

Kur filloi lufta, mua m'u ndez gjaku dhe vetëm një dëshirë kisha: të vrisja sa më shumë! Nga kjo shpesh harroja të ruhesh.

Atëhere Taqua më urdhëronte rreptë. Po kur më duallën përpara syve disa gjermanë njëherësh, unë s'u përmbajta dot më. E zbraza tërë karikato-ren, pashë dy prej tyre që ranë si dengje, po në sup ndjeva sikur m'u fut një gjilpërë e nxehtë.

Para se të më mbylleshin sytë, vura re se Taqua kish dalë nga pozicioni e thërriste: «Para, shokë!»

Kur i hapa përsëri, ndodhesha në këtë kasolle të heshtur. Mbi kokë më rrinin dy shoqe dhe një djalë, të tre me xhaketa të bardha.

Nuk u hutova fare. E mora me mend se ç'kish ndodhur. Po përnjëherësh u kujtova dhe dyshova se Taqua mund të ishte vrarë! Dhe atë çast m'u duk sikur mbarova.

Më siguruan se s'kish ndodhur një gjë e tillë. Të plagosurit i kishin sjellë këtu të gjithë. Pashë se kish prej tyre më keq se unë.

Pas pak erdhi vetë komisari im. Sapo pashë buzëqeshjen e tij plot dashuri, sapo dëgjova zërin e tij të ëmbël, m'u mbush mendja se do të shërohesha pa tjetër. S'kish si të ndodhte ndryshe!

### 31 maj 1944

Sot djaloshi me xhaketa të bardhë i qiti disa copra predhe nga trupi një të plagosuri të ri. I plagosuri nuk nxori asnjë klithmë, asnjë fjalë,



veç shtërngonte dhëmbët. Sa të fortë që jemi ne, partizanët!

Në kohë të ashpër njerëzit s'janë delikatë. Dhe as tremben fare. Djaloshi i ri s'ka mbaruar ende për mjek, po bën operacione të rënda, me shkathësi e besim të madh.

Dolla përjashta. Ahishtet kanë gjethuar. Zogjtë këndojnë. Dielli është i ngrohtë dhe qielli i kulluar. Erë lulësh e gjelbërimi ndjehet kudo. Sa keq që s'kemi kohë ta gëzojmë këtë stinë kaq të bukur!

Kam filluar të mërzitem. Taqon e Gonin ka kohë që s'i kam parë. Më shkruanin një letër të dy. Më uronin shërim të shpejtë. Thoshin se janë mërzitur pa mua, më presin dita ditës. Më ka marrë malli edhe për shtëpinë, për fshatin. Vallë, e kanë mësuar që jam plagosur? Më mirë të mos dinë gjë. Së shpejti do të dal prej këtej dhe, në rrugë e sipër, do fle një natë në shtëpi.

### **3 qershor 1944.**

Sot doktori i ri më lejoi të shkoj. U përshëndeta me të gjithë me radhë. Kur u ndava prej tyre, nuk m'u mbajtën lotët.

Më në fund, jam përsëri e aftë për të luftuar! E mora në krahë automatikun tim të dashur. Tani do të di të luftoj më mirë. Do të luftoj për vendin tim, për prindërit e mi, për të ardhmen e Koços. së vogël, për Taqon e për vete, për lumturinë tonë!

Do të luftoj, që të jetoj!...

Kur mbarova së lexuari këto shënime, m'u duk sikur e dëgjova këtë thirrje plot dashuri për jetën, për një jetë të re, të lirë, pa vuajtje.

Shënimet e kësaj partizaneje më ranë në dorë rastësisht. Sado që jam interesuar, nuk kam mundur të mësoj gjë tjetër për të, veç atyre që përmban ditari i saj, shkruar me kalem në një blok të vogël, të cilit i mungonin fletët e para dhe të fundit. Më vjen mirë të besoj se këto shënime kanë humbur, siç mund të ndodhë në kohë lufte dhe se Dhora, partizaneja trime, që i ka mbajtur ato, jeton tani, kur dëshirat e saj janë bërë realitet.



## NJË DETYRË E ZAKONSHME

Gjatë natës ra dëborë, një dëborë e lagët, me pllaska, nga ajo që shtron e që ke qejf ta shohësh prej dritares, kur brenda në dhomë kërcet zjarri.

Afër mëngjezit, ndërmjet qilimit të bardhë të dëborës dhe qiellit të murmë, u nde një mjegull e dendur shetitëse.

Degët e rënduara të ahishteve vareshin gjer në tokë.

Llambi rrinte te dera e kasolles dhe shikonte përjashta i menduar.

Në kasolle, sadoqë ajo ishte e thurur me gardh, binte erë e rëndë.

Shokët e tij flinin. Ata gërhisnin. Ishin të lodhur, të lodhur e të pangrënë.

Në mbrëmje ishin kthyer nga misioni për mbledhjen e radiove e maqinave të shkrimit, të shpërndara në vende të ndryshme. Në këtë mision u ndeshën me një grup gjermanësh e ballistësh. Humbje në njerëz nuk patën, po kjo përpjekje u harxhoi thuajse krejt fishekët dhe bombat. Edhe ushqim s'kishin më.

Dhe dëborë filloi shtruar. Koha e qëndrimit në atë kasolle ish e pacaktuar. Mund t'u vinte urdhëri për t'u larguar që atë çast ose pas një

muaji. Ku dihet? Shpesh, në luftë, çasti ka rëndësi të madhe. E ç'nuk sjell koha! Po sikur t'i kishin diktuar e t'i sulmonin?

Pa bukë, pa municion...

Llambi shikonte thellë në mjegullën e dendur që, duke vrapuar, zbulonte drurët me degët e rënduara...

Në vështrimin e tij dallohej një ndjenjë frike për të tashmen, dhe sidomos për të ardhmen...

Ai psherëtiu dhe zgjoi komandantin.

— Shoku Hamit, ndodhemi ngushtë, dëbora...

Hamiti u ngrit shpejt dhe po aq shpejt e kuptoi si qe puna.

— Keq! — tha.

U ngritën edhe shokët e tjerë. Asnjë nuk fliste. Me sy pyesnin e bisedonin shumë, po me gojë heshtnin. Asnjëri nuk mund ta mendonte largimin pa urdhër. Po edhe qëndrimin e mëtejshëm s'e merrnin dot me mend.

Heshtja në çaste të tilla është e gjatë. Kaluan disa orë.

— Do qendrojmë këtu gjer në fund!

— Do të zëmë egërsira e me to do të ushqehemi!

Ata që i thanë këto fjalë dukeshin të gëzuar nga mendimet që shprehën. Po të tjerët as qepallat nuk lëvizën.

— Duhet vajtur në ndonjë katund...

— Më i afërti mban dy orë e me këtë kohë...

— Fshati im mban edhe më. Po unë do të vete! Shokët e njësitit do më gjejnë edhe municion. Çoku mbledhin e fshehin ata fishekë e bomba.

Këto fjalë i tha Llambi. Shokët e shikuan



drejt në sy dhe e kuptuan se ai ishte menduar mjaft para se të fliste.

— Mirë, — tha komandanti. — Po sikur ne të marrim urdhër për t'u tërhequr para se të vish ti?

— Do të di t'u gjej pas gjurmëve. Ose do të më lini një pusullë këtu, ku të më tregoni drejtimin që do të merrni.

— Po sikur të të zënë?

— Do qendroj si partizan!

— Shko! Merr me vete edhe një shok.

— Jo, shoku mund të jetë më i nevojshëm këtu. Për të vajtur, do bëj si të bëj. Kur të kthehem, do marr ndonjë nga shokët e fshatit.

— S'thua keq. Udhën e mbarë!

Llambi shtërngoi lidhkat e këpucëve, mbërtheu pallton, u përqaftua me shokët, dhe u nis me hap të vendosur prej guximtari.

Mjegulla ikte e ikte me shpejtësi mbi majat e ahishteve. Megjithatë, ajo s'kish të sosur.

Llambi shkante tatëpjetë. Dëborë i vinte gjer në gju. Vende-vende futej gjer në mes. Ai ecte gjithnjë në një drejtim. E kish menduar mirë këtë drejtim që te kasollja. Po të shkante gjithmonë në jugë, do të dilte pa tjetër në rrugën e malit, prej nga fshatarët rrëzoheshin me dru.

E, si të vinte atje, pastaj e kish lehtë. Në atë drejtim që po ecte ai, kish edhe përrenj, edhe vende të pakalueshme. Ai u vinte rrotull pengesave, po drejtimin nuk e ndryshonte. Si bëri një dy orë rrugë, iu duk sikur kish mbetur fill vetëm në një vend të shkretë. I dukej sikur kish bërë shumë udhë e sikur s'kish bërë hiç. Ndërsa lodhja që ndjente në trup, ish e pamatshme. Bënte dhjetë

hapa dhe ndalonte për t'u mbushur me frymë. Në këto ndalesa, zemra i rrihte me vrull. I ngrinte dhe i fundoste këmbët në dëborë se, duke i hequr zvarrë, dëbora nuk çahej lehtë.

Prëzë një përroi i zuri këmba dhe.

Atë çast iu duk sikur dikush ja liroi këmbët. Psherëtiu dhe ndjeu se u lehtësua. Vetëm në atë çast e kuptoi se sa shumë e pengonte ecjen dëbora.

Vendi i pazbardhur shpinte në rrënjët si gufë të një shkoze të madhe. Kur po afrohej atje, dëgjoji një hungërimë egërsire.

Ai shtangu i habitur. Ç'të ishte vallë? Bëri gati automatikun dhe shikoi me kujdes. Atje, nën shkozë, dukej një diçka e murme, që po lëvizte. Pas pak para tij doli një ujk, duke skërmitur dhëmbët. Egërsira e uritur po vinte drejt tij. Partizani ja shkrehu automatikun mu në gojën e hapur.

Ujku u rrëkëllye në përrua. Një tjetër, të cilin më parë s'e kish vënë re, ua mbathi këmbëve duke uluritur.

Ai vajti te ujku i vrarë. I vuri duart mbi të. Ato iu ngrohën. Ai mbështeti faqet e veshët në trupin e ujkut të vrarë dhe i ngrohu edhe ato. «Një shenjë e keqe dhe e mirë njëkohësisht» — qesëndisi me vete.

Ai eci më tej më me nxitim, se së shpejti errej.

Iu desh të bënte edhe një pjesë të mirë të këtij udhëtimi të vështirë. Në një ndalesë të zakonshme vuri re se mjegulla ish shpërndarë. Para tij ngrihej me madhështi një korie me drurë të përzier. Në mes të saj ish një sërë me ahe të mëdhenj e, më lart se ato, dy pisha të vogla.



Kjo ish koria e fshatit të tij. Atij i rrahu zemra. Qe ende mjaft larg prej fshatit, po tani shpejt do ta gjente rrugën, të cilën, sipas shenjave që i mbante mend mirë, shpresonte të mos e humbiste më. Po, kur dolli në rrugë, mjegulla u shtri prapë, këtë radhë më e dendur.

Tanimë s'merrej vesh në ish ditë apo natë. Veç, sa më poshtë vinte, aq më e hollë bëhej shtresa e dëborës...

Llambi arriti në fshat pas mesit të natës. Hyri vjedhur pas lumit dhe, kur u ndodh pranë shtëpive të para, vuri vesh. Atë çast zemra iu lëndua: në fshatin e tij po vinte si hajdut!

Pas pak ndodhej midis njerëzve të familjes. Ata e përqaftuan dhe e shikonin në sy, po ai s'ish në gjendje të fliste...

Si u ngroh dhe hëngri bukë, tregoi se përse kish ardhur.

— Thirreni Petron e Kocit. Thuajini të vijë këtu, — tha.

Këtij pastaj i tha shkurt:

— Shokët në mal janë pa bukë e pa fishekë. Unë e mora përsipër këtë detyrë... Do gjejmë dot?

— Mirë, — tha Petrua, — ca vetë e ca pionierët, kemi mbledhur plot bomba e fishekë. Për bukë është lehtë. Po për t'i shpënë?

— Më duhet ndonjë shok, domosdo.

— Do ta rregullojmë edhe këtë.

Petrua shkoi të plotësonte këto nevoja.

Partizani nuk e mposhti dot gjumin, i cili ja kish rënduar tërë trupin, e sidomos qepallat.

Llambi flinte. E ëma i rrinte mbi kokë. Druhej ta zgjonte. Ai i kish thënë të mos e linte shumë, po asaj i vinte keq. «Vallë, ku më fle atje në mal?» — mendonte ajo dhe tundte kokën me dhembje.

Dikush hyri në dhomë dhe tha me zë të dridhur:

— Gjermanët e ballistët e kanë rrethuar fshatin që natën...

— Po Llambi? E zeza unë!

Ai u zgjua dhe u hodh në dritare. Mjegulla e murme ja kish lëshuar vendin qiellit të kaltër, nëpër të cilin dielli shëndriste qartë.

— Ah, nënë! Pse nuk më zgjove më parë?

«Po shokët, ç'u bënë? Do kenë menduar të më lenë të çlodhem, eh!» — mendoi.

Ai i tha së jëmës të fshihte automatikun, që i kish mbetur pa fishekë. Vetë futi revolverin nën pallto dhe dolli.

— Ku vete, o bir?! Do të të vrasin! Rri këtu, fshihu në tavan...

— Jo, nënë, ashtu është më keq. Do dal njëherë, pastaj prapë shohim. Do dal sa për të shikuar.

Partizani shkoi në anë të fshatit. Ecte sikur bënte shetitje, si pa i dhënë rëndësi asgjëje. Rreth fshatit, nëpër kodrat, dukeshin gjermanët e ballistët grupe-grupe.

Atij i thirri njëri prej tyre. Llambi bëri sikur nuk dëgjoi dhe u kthye e mori rrugën në mes të shtëpive të dendura, të cilat e fshihnin nga pamja e tyre.



Provoi të shihte edhe nga ana tjetër, nga kisha.

Te ura takoi dy vajza, që i njihte, të cilat ktheheshin prej çezmës.

Vajzat ndaluan para tij.

— Ku vete, Llambi? I ke mentë?

— Duhet të shkoj pa tjetër!

— Ne duallëm këtej me shkakun e ujit, që të shihnim... Na tha Petrua...

— Ku është ai?

— Vajti të shohë nga ju.

— I thoni: në mbrëmje te Korja e Hajdutit...

Mirupafshim, çupa!

Vajzat e ndalën duke e zënë për krahu me rrëmbim. Ai u trondit. Eh, sa i afron lufta njerëzit! Në kohë të qetë, sa turp do të ish që vajzat të bënin një gjë të tillë...

Po kujdesi i tyre edhe e preku, edhe e trembi.

— Mos më pengoni dhe mos harroni ç'ju thashë! Thuajini edhe nënës që ika.

— Llambi, këtej pas lumit shko... Edhe ruaju, o i zi!

S'do mend që do të ruhej. Jeta është e shtrenjtë, sidomos kur mendon se do ta gëzosh ashtu si duhet...

Me kujdes se mos diktohej, ai shkonte anës lumit. Si kaloi nja pesëqind metra larg fshatit, u hodh në një vend të zbuluar. Atje e diktuan që nga kodra e Shën Thanasit.

I thirrën dhe, mbasi nuk ndaloi, filluan ta qëllonin.

Ai u përkul dhe vrapoi duke u futur herë nëpër ujë e herë pas shelgjeve e mbrojtjeve të natyrshme të lumit.

Plumbat i vinin si breshër mbi kokë. Ai s'u ndal.  
Pas pak u duk sikur e harruan.

Llambi shikoi anash e prapa i trembur. Jo, askush nuk e ndiqte. Mirëpo ndodhej në një vend ku ujët flinte dhe kish thellësi të madhe. Nga njëra anë e lumit vithima ish thikë. Në anën tjetër delte në shesh të hapur. Duhej të kalonte përmes pellgut.

E çau akullin dhe u fut në ujë. Uji i ftohtë i vajti gjer në sjetull. Trupi iu drodh, po kaloi. Tani edhe ish larguar mjaft nga ata që e kishin diktuar. Tha se kish shpëtuar dhe kjo shpresë e gëzoi pa masë.

Po ja, përpara përsëri një pengesë si ajo e mëparshmja. Këtu duhej të kish ujë më shumë.

Ai provoi të kalonte. Që në fillim vuri re se këmbët i zunë tinë, prandaj i bënte hapat të shkurtëra e të kujdesshme.

S'kish vajtur as në mes të lloimit, kur uji i vajti gjer në sup. Bëri edhe një hap tjetër dhe iu duk sikur dikush ja kapi këmbën dhe ja tërhoqi poshtë me fuqi.

— Ah, ta marrë djalli! Shpëtova nga gjermanët dhe do të mbetem në tinë! — tha i dëshpëruar, ndërsa uji po i ngjitej më lart dhe këmba po i fundoste akoma më poshtë.

I dha njëherë trupit përpjetë dhe u kthye prapsht.

— Jo, s'mund të kalonte aty. Do ish budalla-llëk të mbetej në atë pellg.

Doli nga ana e zbuluar dhe eci me kujdes pas një hendeku.

Kur hodhi sytë përpara, ç'të shihte! Rruga e fushës nxinte.



Llambi u kthye me rrëmbim për t'u futur sërish në lumë. Po atë çast u ndodh në duart e atyre që e ndiqnin. Dhe s'pati kohë të bënte asnjë lëvizje.

Gjermanët e lidhën dhe e muarën me vete. Bashkë me të kaluan përmbi fshat, që t'i tregonin disa djem, të cilët qenë vrarë kur deshën të iknin fshehurazi për në mal.

Po, ai i njihte ata djem. Njëri prej tyre ish Petrua i Kocit. Ai kish rënë përmbys dhe në dorë shtërngonte një torbë të rëndë.

Llambi i gëlltiti lotët. S'ish koha për ta lëshuar zemra. Shok e kish Petron. Shumë e desh atë. Disa orë më parë kishin biseduar për kryerjen e detyrës së përbashkët. Petrua ish vënë në rrugë...

Dhe tani, ja tek ish pranë tij, i shtrirë, i palëvizur, pa jetë!..

Ai mësoi se Petrua ish me shokë. Dhe shokët kishin shpëtuar... Ata shokë e prisnin atë, Llambin, te Korija e Hajdutit...

Llambin e lanë nën kujdesin e një ballisti, i cili kish hedhur krahëve një çantë të mbushur dinga me plaçka.

Ballisti i shikoi me zili disa herë këpucët e reja të partizanit. Lambi e vuri re. Atij zuri t'i punonte mendja te plani për të shpëtuar. Ballistin mund ta godiste me shkelm në bark dhe, gjer të vinte në vete, t'ua mbathte këmbëve. Mirëpo nëpër fshat kudo kish gjermanë e ballistë të tjerë.

Pastaj duarve të lidhura, ç't'u bënte atyre? «Sidoqoftë duhet të shpëtoj!» — tha me vete. Një fjalë goje është të thuash se s'të dhimbset jeta. Jo, atij i dhimbsej! Mosha e tij ishte e tillë,

që priste nga jeta çaste fatlume. Sidomos kur kish luftuar për këtë qëllim. Mosha e tij desh jetë, jetë!

«Duhet të shpëtoj! Po si?»

Iu kujtua dita kur e kishin kapur italianët. Atëhere s'kish dalë ende partizan.

Punonte fshehurazi, në fshat, me njësitin.

Tre italianë e shoqëronin nëpër rrugët e fshatit. Kur u ndodhën para një shtëpie, e cila kish edhe derickë nga ana e lumit, Llambi u kthye me rrëmbim nga italianët dhe thërriti me zë të çjerë:

— More, porco madona! Che cercare da me?!<sup>1)</sup>

Dhe sa të mblihdnin mendjen italianët e hutuar, ai e shtyu portën e madhe, e mbylli shpejt me lloz dhe dolli nga dericka, duke bërë një kërcim të habitshëm...

Kështu kish shpëtuar në atë rast.

Mirëpo matanë derickës nuk kish italianë të tjerë, kurse sot...

Gjermanët atë ditë arrestonin të gjithë burrat që gjenin.

Llambit i vinte turp kur kalonte nëpër fshat, ashtu me duar të lidhura, i arrestuar e i shoqëruar prej një ballisti.

Ende s'kish gjetur me mend ndonjë rrugë të saktë shpëtimi. Po duhej të shpëtonte pa tjetër! Jeta e tij, të paktën atë ditë, jeta dhe shpëtimi nga duart e armiqve, kishin një rëndësi të veçantë, sepse prej tij varej jeta e shokëve në mal...

— Duhet të shpëtoj! — i tha ballistit.

— Pusho, derr, se ta çava bullcinën!

---

1) More, ta hajë dreqi! Çfarë kërkuar nga unë?



— Më lësho!

— Jo, bre, si të lëshuakam?

— Duhet të iki, more, dëgjon? Duhet të shpëtojmë!

— Marsh, përpara!

Dhe ballisti ngriti vetullat.

Pas pak Llambi foli përsëri:

— Do të t'i jap këpucët, të betohem...

— Mos u ndalo, bre, të thonë...

— Do të t'i jap! — tha përsëri Llambi dhe një rreze drite e shprese ja përshkoi trurin.

Ndodheshin te një kthesë. Po t'ja mbushte dot mendjen ballistit që të tërhiqeshin anash për ti nxjerrë këpucët...

Ballisti shikoi me lakmi, pastaj hodhi një vështrim plot frikë në rrugë, para e prapa e tha:

— Qiti shpejt!

Llambi u hodh mënjanë dhe bëri sikur po qitte këpucët. I theri në zemër. Këto këpucë ja kish marrë një gjermani. Ato s'futnin ujë fare dhe këmbët ja mbanin ngrohtë, ngrohtë. Dhe tani t'ja jepte këtij ballisti të ndyrë? Ai qeshi me tallje. Mos vallë po vinte në kandar jetën me një palë këpucë? Ish kaq i kursyer? Jo, këtu s'ish puna për kursim! Po atij iu duk sikur po e poshtëronte veten shumë. A duhej ta ulte veten aq shumë sa, zbatuar, t'i lutej këtij plaçkitësi t'ja falte jetën? Kurrë, kurrë! Ai ndjeu se si gjaku i hipi në fytyrë, shtërngoi grushtat, por shpejt e mblodhi veten.

— Hë, o derr, ç'pret? — tha ballisti. — Dhe mos të shkojë mendja që për një palë këpucë më...

Llambit i erdhi ndoht prej tij dhe mezi e

mbajti veten pa e pështyrë në atë fytyrën e buhavitur.

— I kam duart të lidhura, — tha ngadalë, — nuk i shkopsit dot.

Ballisti shikoi përsëri anash me frikë dhe pastaj u ul t'i shkopsitte alpinet partizanit. Llambi këtë çast priste. E ngriti këmbën si për t'ja zgjatur dhe i dha një goditje në fytyrë. Ballisti klithi dhe vuri dorën në gojë, që iu mbush me gjak. Llambi i dha një tjetër goditje me shkelm në një vend që s'tregohet. Ballisti u shtri pa ndjenja.

— Kështu i nxjerr këpucët një partizan, o ndyrësirë! — thirri.

Ai deshi ta vriste fare ballistin, po koha s'priste. Llambi shikoi andej këtej. Ja, atje në qoshe u dukën dy gjermanë. Ata bisedonin me zë të lartë e s'e panë, po, pas pak, do të arrinin te kthesa. Llambi nxitoi në rrugën e lirë. Duke ikur pas strehëve, ai arriti, pa u diktuar, deri te udha e moçaleve. Këtu fillonin një sërë plevicash. Këtu ish edhe plevica e tyre. Ajo mbyllej me një çelës të madh, por, po ta shtyje me forcë, hapej, se rezja ku zinte ai ish vjetëruar e lëvizte. Partizani i dha një shqelm kësaj dere, që u hap vërtet dhe hyri brenda me nxitim, e mbylli prapë dhe me mundim të madh, duke e shtyrë me sup e me mjekër e vuri në vend llozin e bravës. Pastaj u mbështet në murin e ftohtë dhe mbajti vesh: ra një bilbil, të cilin e pasuan ca thirrje në gjuhë të huaj.

«Këtu mund të më kapin, — tha partizani. — Ata me siguri do t'i kontrollojnë plevicat».

Truri i tij punonte me vrull. Ai i kish duart të lidhura. Së pari duhet t'i zgjidhte ato. Si t'i zgjidhte? Vërtet ja kishin lidhur me litar, po, ama,



ja kishin lidhur prapa. Ai nuk i lëvizte dot fare. Edhe për të vrapuar e kish patur shumë zor. Si ta këpuste litarin e trashë? E provoi njëherë duke i hapur krahët dhe ndjeu dhëmbje në kyçet. Por truri i tij ish në veprim. Dhe njeriut me vullnet gjithnjë i pjell mendja: ai gjeti në mur një gur të mprehtë, iu afrua atij së prapthi e tereziti te litari dhe filloi t'i fërkonte duart pas tij me të keq, po me forcë. Disa herë shtërngonte dhëmbët nga dhembja, sepse guri i mprehtë fërkohej edhe pas duarve dhe hynte thellë në mishin e butë, po ai s'ndaloi. Dhe ja, kur i hapi përsëri krahët me forcë, litari i ngrënë prej gurit u këput. Llambi i fërkoj duart e çliruara e fërkoj vendin e gjakosur dhe qeshi i gëzuar.

«Tashti shpëtova!» — tha me besim të plotë dhe shikoi në gjysmëerrësirën e plevicës, ku sytë i ishin mësuar tashmë. Ndjeu erën e bykut që të shpon hundët, sa të vjen për të teshtirë, pa koshin e kashtës dhe cfurkun aty pranë dhe një mall e dëshirë e zjarhtë për diçka të njohur e të largët e pushtoi të tërin. Iu kujtua aq qartë koha kur rrinte vetë aty e merrte kashtë për bagëtinë, duke hapur shpesh monopatin me dëborë; iu duk aq e ëmbël ajo kohë, aq e ëmbël dhe e largët, si një lumtëri që ka marrë fund njëherë e mirë, sa që zemra iu ngashërye. Po shpejt e mblodhi veten. S'ish koha e kujtimeve tani! Tani duhej të fshihej diku. Të futej në kashtë? Jo, atë do ta kontrolloinin, ose mund ta digjnin. Ai hodhi sytë lart dhe psherëtit i lehtësuar: në një anë hatulla ish shumë e gjerë. Atje do të futej! Në mbrëmje, edhe sikur ta rrethonin plevicën, ai do t'i hiqte me kujdes qeramidhet aty, sa për të bërë një vrimë

prej nga mund të delte. S'priti më, kërceu në një tra e u zvarit gjer te hatulla e gjerë. Aty u shtri dhe priti në heshtje. Dikur dëgjoi që kish lëvizje përjashta. Bile njëherë dikush u ndal para derës së plevicës. Llambi mbajti frymën. Nxori ngadalë revolverin dhe priti në heshtje, gjakftohtë. Po dera s'u hap. Ai dëgjoi njëherë:

— Kontrollove këtu?

— Hë... po, si të them.

— Lere, s'ke kontrolluar. Po si të bëjmë? Apo mos hamë ndonjë plumb sa të hapim derën?

«Këta janë shuramanë, ballistë» — tha me vete Llambi dhe u qetësua. Pak më vonë dëgjoi se si njëri prej tyre foli me zë të lartë:

— Këtu s'ka gjë, kontrolluam ne!

Llambi s'lëvizi gjersa u err. Atëhere hapi me kujdes disa qeramidhe dhe zgjati kokën: nuk dëgjoi asnjë zhurmë. Hoqi edhe disa qeramidhe të tjera, doli i tëri në çati, u var pas një kumbulle që ish rritur pas murit të plevicës dhe zbriti poshtë. Arriti me revolver në dorë gjer te lumi dhe mori përpjetë përruan. Kur po delte fare nga fshati, dëgjoi një zhurmë hapash e pastaj një «Alt!».

Ai e kish gishtin në këmbëz; e shkrepiti disa herë revolverin në drejtimin nga erdhi zëri dhe iku me vrap përpjetë. U dëgjuan përsëri thirrje e krisma; po, pas pak, Llambi ndodhej jashtë rrezikut dhe qeshte duke thënë:

— Shikoni mirë, se mos ju ikë!

Pastaj mori frymë i lehtësuar dhe vrapoi për te Korja e Hajdutit, ku i gjeti djemtë e njësitit, që po e prisnin.

Disa minuta më vonë djemtë po ngjiteshin



përpjetë malit. Dy prej tyre do të rrinin përgjithnjë me partizanët, kurse i treti u kthye në fshat të njoftonte se kjo detyrë e zakonshme ish kryer me sukses.

## MBARIMI I FROSINËS

Vite të shkuara një mëngjez, ende pa rënë dielli, kambanat e kishës filluan të bien me tërsëllëmë e pojaku i fshatit e shkrehu pushkën për alarm.

Fshatarët shkonin te mulliri lart. Ata vështronin ujin që rridhte jashtë kadeve. Si e zunë ujin dhe zbërthyen dërrasat, në fund të boçkës gjetën Frosinën e Kolës, të fryrë e të mavijosur.

Të mbyturës nuk i bënë shërbimet e zakonshme. Madje, prifti i fshatit nuk pranoi as ta mbulonin në vorrezat e kishës, se ajo ja kish dhënë shpirtin djallit!

Nuk e shpunë në kishë dhe as në shtëpi. Hapën një varr tutje dhe e mbuluan, pasi një plakë i futi një peronë në bark, që të mos ngrihej lugat!

Kështu ndodhi me Frosinën. Gratë e fshatit bënin kryq e qanin, po asnjë se dinte të vërtetën, e cila u kuptua më pas...

\* \* \*

Frosina kish mbetur me tre fëmijët e saj ende të parritur. I shoqi, Stefani, kish shkuar në kurbet dhe, jo vetëm që nuk ish kthyer, por ajo nuk dinte asgjë të saktë për të. Sa shumë e mundonte kjo!



— Ah, ai mot i mallkuar që e detyroi Stefanin të ikte nga shtëpia!

Ata kishin një copë arë e, veç asaj, punonin për Donen e Vasos, të parin e fshatit.

Ai mot qëlloi i thatë. Ara e tyre nuk dha as farën, që i hodhën. Edhe haka prej Dones, si thajtësirë që ish, u bë më e pakët. Ishte ende tetor; kur në shtëpi s'u kish mbetur veç një shinik me misër e një me elb. Duhej përpjekur që pa u mbaruar edhe këta. Stefani iu lut Dones që t'i jepte ca drithë hua. Donia nuk kish pranuar t'i huante. Ranë në ujdi kështu: për një shinik misër, që Donia do t'i jepte tani, brenda vitit Stefani t'ja kthente një e gjysmë. Po të mos ja kthente, do të detyrohej t'i jepte arën.

Stefani mori disa shinikë me misër.

Po atë natë nuk e zuri gjumi. Si do t'ja lante këtë borxh Dones? Ku do t'i gjente? Ara e tij, edhe sikur kushedi sa të bënte, nuk plotsonte dot nevojat e shtëpisë, jo të mbetej për të larë borxhin. Veç një rrugë mbetej: të vente në kurbet.

Ashtu bëri. Shkoi në Greqi.

Vitin e parë dërgoi një letër e ca para që nga mali Athos. Pastaj u harrua fare. Asnjëri s'e dinte se ku ish e çfarë bënte.

Thoshin e ç'nuk thoshin poshtë e përpjetë, po veç një gjë ish e vërtetë: ai s'u kthye më e as shenjë jete dha.

Frosina priti e priti një letër a një lajm prej tij, po pastaj i humbi shpresat fare: i gjalli nuk mund të heshte kështu, kudo që të ish.

... Fëmijët sapo i kish zënë gjumi. Ajo ish shtrirë pranë tyre dhe qëndronte si e ngurosur, pa lëvizur fare. Po kalonte mesi i natës. Gjumi nuk

kish patur fuqi t'ja mbyllte qepallat dhe, tashti që ai i ishte larguar, sytë e saj ishin mbërthyer në tavanin e errët, sikur atje të gjenin një fije shpresë.

Kish fshirë këndin e hambarit dhe, me miellin e përzier me tallash dërrasash të krimbura, që kish mbledhur atje, mezi kish bërë një kaçamak. Në një cep të shtëpisë kish gjetur edhe nja dy koçanka misri e ca patate. Edhe ato i kish zier. Tashti në atë shtëpi të hallakatur nuk kish mbetur asgjë. Dhe ish ende vjeshtë...

Atë vit nuk kish mundur të punonte dot si ngahera. Një ditë e zuri shiu në arën e Dones, ku punonte. Shiu ish i rrëmbyer, si shi behari. Ajo ish e dërsitur e nga kjo i hyri një e dredhur prej të ftohtit, sa që mezi vajti në shtëpi. Natën pati shumë të nxehtë e trupin s'e urdhëronte dot.

Kur e ndjeu veten më mirë, vajti përsëri në punë. Po tashti nuk e kish më fuqinë e parë. Të tjerët lidhnin duaj, ajo jepte pallogje. Që në mëngjez e kish patur trupin aq të rëndë, sa që i vinte të dergjej atje, në mes të arës. Po, më në fund, gjunjët iu prenë, këmbët nuk e mbajtën dot më dhe ra. Koka i digjte si furrë. Në ijë ndjente një sëmbim të madh...

Sëmundja e mori për prapë. U dobësua shumë e që nga ajo ditë nuk punoi më.

Si do ta nxirrnin atë dimër? Ku të mbahej? Kujt t'i kërkonte? Nga njerëzit e saj në fshat i kish mbetur vetëm një teto. Tetua i kish dhënë ca thekër të përzier me misër e një shportë me patate. Ja, do t'i kërkonte prapë dhe ajo do t'i jepte sa për të shkuar një ditë, dy tre, shumë-shumë pesë. Pastaj? Për katër-pesë ditë mund t'i jepte



edhe Fota, që e kish bërë motër. Pastaj? «E dhëna e botës, e gënjyera e gojës, thotë një fjalë.

Ish ende vjeshtë. Sikur tërë miqtë që kish në fshat ta ndihmonin, prapë nuk ja arrinte dot, se edhe ata hiqnin keq vetë. Vetëm Donia i Vasos kish. Po atij nuk mund t'i kërkonte, se, si do t'ja lante? Për të punuar, ajo nuk ish më e zonja. Dhe nuk kish më asgjë që të vinte peng. Pastaj, mos duhej vetëm bukë?

— Zot, përse më dënove kështu? — pëshpëriti një natë teksa shikonte ikonën e shenjtit të martirizuar. Faqet e zbeta iu lagën nga lotët. Koka zuri t'i dhimbte, sikur ta qëllonte njeri. Një kollë e madhe e shkëputi nga mendimet. U ngrit shesh që të mos i zgjonte fëmijët. Dollu jashtë. Iu duk sikur po i shkallmohej kraharori. U koll me mundim. Fyti i gërvishi e diçka e ngrohtë i lagu gojën. Mori kandilin që ta shihte: ish gjak. Gjak?! Kandili i ra nga dora, mendja iu rrotullua e për pak do të binte. U mbajt pas gardhit dhe, për një copë herë, mbeti si e ngurrosur. Gjak?! Ajo u tremb nga vetja e saj.

Nga t'ja mbante tani?!.. Errësira e natës iu duk ngushëlluese. Ajo deshi të shkonte e të shkonte, të futej në të, pa ditur se ku, veç të mos mendonte, të mos mendonte!..

Befas, sikur dëgjoi një zë. Vuri veshin: një nga fëmijët e saj po qante. Duhej të kthehej. Ajo që kish në trupin e saj atë gjë të frikshme, duhej të kthehej te fëmijët.

U kthye. Ish zgjuar Vani, më i vogli. Ai qe ngritur e po fërkonte sytë me duar.

— Mami, babi erdhi dhe na solli një hejbe me

bukë. Unë mora një e po e ndaja me Sofikën e me Ligorin. Kush na e mori?

— Cilën, more bir?

— Bukën, moj mami, kush na e mori bukën?

— S'ka kush ta ketë marrë; kur të bëhet ditë, do ta gjejmë.

Ç'ti thoshte tjetër? Edhe ai nuk pyeti më e të dy mbetën pa folur.

— Bukë!.. — pëshpëriti Ligori në gjumë dhe u gëlltit.

Heshtje.

— Mami, sa më hahet bukëëë!..

— Fli, bir; në mëngjez do të të jap, se tashti është natë e, po të hash, të vdes mamaja. Do ti të vdes unë?

— Jo, mami, po nuk më zë gjumi. Më hahet shumë.

— Fli, tani, bëhu i mbarë, se në mëngjez mamaja do t'ju bëjë bukëvale.

— Sa mirë! Edhe me gjalpë?

— Po, edhe me gjalpë...

— Plot do ta mbushësh tepsinë, mami?

— Po, bir, plot do ta mbush...

— Sa e mirë që je ti, mami!

Dhe djali i vogël iu hodh në qafë. Frosina mbeti si e ngrirë. Ndjeu dëshirën ta shtërngonte fort, ta puthte të birin, po një gërvishje tjetër i kujtoi gjakun që kish pështyrë dhe sëmundjen e rrezikshme. E tmeruar, ktheu kokën mënjanë, që fryma e saj e helmuar të mos e prekte të birin dhe e largoi atë ngadalë. Pastaj shoi kandilin, që Vani të mos ja shikonte lotët, të cilët nuk i mbantë dot.

Vani fjeti përsëri. Frosina vajti në anën tjetër të dhomës dhe ndënji në rrogöz. U mbështet në



mur. Muri ish i ftohtë e ajo u rrëqeth. Era frynte nëpër hatullat e shtëpisë dhe rrëzonte ashkla e pluhur prej tavanit të coptuar. Nga dritarja e vogël dukej një copë qiell mbushur me yje të vegjël, si shkëndija plot vezullime. Hëna kish perënduar dhe errësira ish e njëllajtë kudo.

Heshtje, një heshtje e frikshme. Ajo rrinte si e mpitë. Gjuha i qe tharë e buzët nuk i mblidhte dot ngaqë i ishin shkrumbëzuar. Trupin e kish fare të dërmuar.

Disa çapa më tej flinin fëmijët e saj; frymëmarrja e tyre e thellë prishte monotoninë e asaj nate të kobshme. Shpesh i dukej sikur nuk dëgjonte asgjë. Atëhere i hynte frika dhe vinte vesh. Ato tri gërhitje të lehta sikur i gërvishnin kraharorin dhe pastaj i futeshin si gjilpëra të nxehta në tru e ja trazonin mendjen. Si kalonte një copë herë kështu, frymëmarrjet e tyre dëgjoheshin si zakonisht.

Edhe këtë radhë i kish gënjyer. Si mund t'i gënjente më? Çdo t'u thosh në mëngjez? Ç'i mbe-tej më?

Mbuloi fytyrën me duar, u mbështet mbi gjunjë dhe kujtimet e shpunë larg...

Ish koha kur mblidheshin misrat. Frosina me Stefanin i punonin arat bashkë, se njëllajtë ishin nga gjendja e të dy familjet kishin rregulluar një pendë. Ajo e shikonte vjedhurazi djalin punëtor. Dhe çdo fjalë e tij me zë të ulët e bënte ti skuqeshin faqet e t'i përpëllitej zemra.

Sa turp kish kur mbetej me të! Po dhe sa dëshirë! Në mbrëmje, sapo ndaheshin, ajo mendonte për të nesërmen. Gjatë ditës, në punë, qëllonte që Stefani ta prekte pa dashur. Asaj ja pëc-

shkonte trupin një drithmë e ëmbël. Jo vetëm ditën, që e kish mendjen te ai, po edhe natën e shihte në ëndërr.

Një ditë Stefani i tha:

Pleqtë e mi të lëvdojnë shumë, Frosinë. «S'gjëndet çupë si ajo. Është nikoqire e me terbiet! Apo nuk është e punës. E sa vjen më e bukur bëhet! Ja, si atë ta kemi nusen e Stefanit» — thotë nëna.

Djali kish heshtur një hop, pastaj kish shtuar: — Vërtet, ti, Frosinë, je e mirë. Unë të dua e do të të marr!

Asaj iu duk sikur do t'i çahet zemra, aq shumë iu hodh.

Po djali s'e la punën me kaq. Ai e zuri për dore dhe e shtrëngoi pas vetes. E Frosinës iu duk, atëhere, sikur do të fluturonte, aq e lehtë dhe e lumtur ish.

Sa shpresa ngritën krye në ato çaste!..

Edhe më vonë, sado fatkeqësi që e goditën, ajo shpresoi. Ajo shpresonte se një ditë do t'i qeshte lumtëria edhe asaj. Gjithmonë vuajtje do të kish për të? Jo, një ditë duhej të mbaronin edhe vuajtjet e saj...

Po jeta u tregua e pamëshirshme.

Stefani nuk u kthye. Në shtëpi nuk kish gjë prej gjëje. Sëmundja e kish marrë poshtë e po e shpinte në varr. E Frosinës shpresat, dëshirat dhe ëndërrat iu zhdukën, si zhduket mjegulla në një mëngjez vjeshte me diell...

Me sy të zgurdulluar, ajo mati me mend largësinë që e ndante nga fëmijët. Një, dy, tre hapa! Dhoma ish e vogël, fare e vogël. Edhe ata merrnin frymë atje; ndoshta frymën e saj... Bobo! Sikur t'ua ngjiste sëmundjen edhe atyre?!



— Khu! Khu!..

Lëngu i ngrohtë iu ngjit përsëri në fyt. Frymëmarrjet e fëmijëve nuk po i dëgjonte. Ato sikur u vagëlluan e humbën tej. U ngrit, mori kandilin ta ndizte, po gjaku desh të delte dhe ajo u sul drejt derës si furtunë.

Jashtë ish freskët. Shtrëngoi dorën te kraharori dhe shkoi pas një udhishteje të njohur. Ajri i lagët e filladitë, po ajo nuk ndjente gjë, veç ikte e ikte sikur e ndiqte njeri.

Ajo nuk ish më e nevojshme për fëmijët. Ajo s'kish ç't'u bënte më atyre. Jeta e saj s'vlente më për ta, bile ish e dëmshme. Ajo nuk duhej të rrinte më pranë tyre. Fëmijët ishin të dobët, të pangrënë... Dhe sëmundja e saj ish ngjitëse...

Vuajtja, dëshpërimi sikur ja mpinë trupin. Frosina nuk mendonte më për asgjë. Ecte, ashtu në tym, pa ditur për ku e përse.

Udhishta e njohur e nxori te jazi, atje ku lante plaçkat. U ul në plloçën e lumit dhe futi duart në ujë. Uji ja merrte me vete dhe ja ledhatonte. Frosina sikur gjeti rehat. Pak më tej fillonte korita. Atje uji rridhte me nxitim. Kur binte në kade, bënte një zhurmë të frikshme dhe monotone. Asaj i pëlqeu kjo zhurmë. Me duart të futura në ujë, shikonte andej nga vinte buçima.

Për një çast iu duk sikur, në mes të errësirës, pa Vanin e saj që ish ngritur e qante dhe dy të tjerët tek flinin nën këmbët e tij. Po ata qëndruan pak, shumë pak, para syve të saj dhe u zhdukën aq shpejt, sa edhe duallën. Aq e zbetë ish kjo dukje sa që Frosina nuk lëvizi fare nga vendi.

Errësira ish bërë më e dendur. Era kish filluar të ftohej. Frosina nuk ndjente të ftohtë e as

frikë. Sytë i mbetën të ngulura në një vend, po asgjë nuk dallonte. Nuk dëgjonte më as buçimën që delte nga kadet. Uji ja tërhiqte e ja tërhiqte duart si me lutje. Nga pengesat që haste në ato duar, ai gurgullonte ëmbël.

Veç këtë gurgëllimë dëgjonte ajo. Dhe, sa më tepër e dëgjonte, aq më e ëmbël i bëhej dhe sikur shkrihej një me të.

Papritur ndjeu dëshirën të shkiste si uji. Ajo lëshoi trupin e, me duar përpara, rrëshqiti në koritë...

Trupi i saj, duke rënë nëpër kade, prishi vetëm një çast monotoninë e kësaj nate vjeshte. Pastaj çdo gjë mbeti si më parë: errësira po ajo, zhurma po ajo. Uji rridhte i qetë e pagurgullimë në koritën e lëmuar.



## REZERVUARI

Shiu s'kish të pushuar. Ish një shi i imtë e i ngadalshëm, por i pandërprerë. Toka e ngopur s'pranonte më dhe ujrat e tepërta, duke dredhuar nëpër pengesat e shumta, gjenin shteg dhe rridhnin tatëpjetë në mënyrë monotone, po ashtu, pa ndërprerje. Ato bashkoheshin te përroi i potershëm, që çante pllajën e vinte duke u zgjeruar sa më poshtë zbriste. I fryrë buzë më buzë, ai turrej me rrëmbim, sikur sulej në ndonjë betejë. Dhe vërtet. Atje poshtë, para se të delte në vend të hapur, i kishin zënë pritë. Atje ish fusha e betejës. Si në një betejë të vërtetë, ai mernte hov që lart, duke buçitur për llahtarë, sulej tatëpjetë me furi, po në vendin që duhej e liniu fuqitë, shkrihej e pipatej<sup>1)</sup>, duke i shpërndarë valët e turbullta tërë shkumë në një sipërfaqe të madhe e të sheshtë uji, që sa vinte zgjerohej. Ajo sipërfaqe e madhe uji ish një rezervuar për vaditje dhe armiku i përroit mburravec qe diga e këtij rezervuari. Pasi nuk e shkatërronte dot këtë digë me valët e furishme, që i thërmoeshin që larg, ai ish i sigurtë se do ta shembte me peshën e ujit.

---

1) Pipatet — hesht.

Këtu ai kish të drejtë. Tërë fshatarët që ishin te diga tamam këtë frikë kishin. Pa përfillur shiun që s'kish të sosur, duke dyshuar se diga nuk do të qëndronte dot, ata përpiqeshin të bënin diçka. Disa mundoheshin ta shponin pengesën duke futur nga jashtë hunj të gjatë në tubin e shkarkimit. Por tubi, duket, ish zënë shumë thellë, ndoshta afër ujit, dhe hunjtë nuk mund të arrinin deri atje. Ca të tjerë grumbullonin dhë e gurë për ta forcuar digën nga jashtë. Por askush nuk besonte se një gjë e tillë do ta shpëtonte atë nga rreziku.

Nga çasti në çast vinin fshatarë të tjerë. Dukej sikur po shkulej i tërë fshati. Rrinin mbi digë ose anash sikur të bëheshin gati t'i vinin gjoksin për ta mbrojtur. Fytyrat e tyre të vrëjtura si qielli i sterosur tregonin pikëllimin e madh që ua ndrydhte zemrat. Jepnin mendime të ndryshme, mundoheshin të bënin diçka. Por uji në rezervuar shtohet gjithnjë e më shumë.

Erdhi duke rendur edhe një djalë i gjatë, me fytyrë të përskuqur nga nxitimi. E shikoi me vëmëndje të përqendruar ujin, pastaj digën e njerëzit dhe tha i merakosur:

— Si t'ja bëjmë, o shokë?

— Tubi i shkarkimit është zënë nga tina, ujët po ngrihet me shpejtësi. Pas pak do të arrijë këtu. A mund ta ndalojmë dot? — iu përgjegj njeri.

— Ta ndalojmë! Duhet ta ndalojmë!

— Ama «duhet»! — qeshi me pahir një tjetër.

— Ujit dhe zjarrit, mor djalë...

Skënderi, djali i ri që sapo kish ardhur, s'ua vuri veshin këtyre fjalëve.

Ai shikoi vetullvrëjtur ujin e turbullt, sikur ta maste forcën e tij. Ja, edhe nja dy metra i



mbeteshin. Pastaj do të rridhte prej digës. Nga ana e jashtme diga nuk qe shtruar me gurë. Uji do ta gërryente me shpejtësi dheun e ngjeshur, pastaj do të shpërthente diku dhe... Ai mbylli sytë kur përfytyroi gjithë atë ujë duke vërshuar tatë-pjetë. Do të mbyteshin disa shtëpi, tërë lagja e lumit, do të përmyteshin të mbjellat në luginë, do të prishej rezervuari... Jo, kjo nuk duhej të ndodhte! Skënderi shtrëngoi dhëmbët nga inati.

— Shokë! Të bëjmë diçka! — klithi.

— Ja edhe ne po mundohemi, po ç'të bëjmë? Thikës me grusht s'i bihet, — tha një plak.

— Jo, s'është ashtu. Pa luftë nuk duhet të dorëzohemi. Ne të bëjmë ç'të na vijë për dore, pastaj, po s'mundëm...

Këto fjalë sikur u dhanë zemër fshatarëve. Ata i dëgjonin ato dhe e shikonin djalin e ri sikur ta pyesnin. Ai e vuri re këtë, shikoi anembanë, u përqendrua ca më tepër tek ujjat e turbullta dhe pas pak tha:

— Po sikur të bëjmë kanale në të dy anët e digës?

— Kanale shkarkues?

— Po.

— Këtë e menduam edhe ne, — tha njëri duke tundur kokën me mosbesim. — Por... si të rrjedhë në kanalet shkarkuese, si në digë që lart, uji do të bëjë të njëjtën gjë: do ta gërryëjë dheun, — shtoi ai.

— Kanalet t'i shtrojmë me gurë. T'i bëjmë kalldrëm!

— Kjo të ish bërë më parë, pa tani...

— Akoma s'është vonë. Gjithë këta që jemi ne këtu, ehu! Kërdinë bëjmë! Ti, ti, edhe ju atje,

hapni kanalet! Të tjerët sillni gurë! Gurët ja ku janë, atje tej. Kanali duhet shtruar me gurë se gërryhet. Shpejt! — tha Skënderi e u sul vetë i pari.

Kjo ish vërtet një rrugëdalje e mirë!

Fjalët e tij ishin tamam si të një komandanti të zot dhe fshatarët iu vunë punës me besim.

Një burrë i moshuar pëshpëriti:

— More, po ne si s'na shkoi ndërmend kjo? Ej, ç'na rodhën mëntë, për besë!

Atë çast dikush iu afrua Skënderit, që po i udhëzonte fshatarët ku të hapnin kanalën dhe i tha:

— Skënder, kjo është punë me mend, po shiko: nuk do të kemi kohë. Më mirë të bëjmë kanal vetëm nga njëra anë.

Skënderi shikoi me vëmendje ujin në rezervuar dhe pohoi me kokë. Vërtet, s'kish kohë për të hapur dy kanale.

— Eeej! Të gjithë këtu! S'arrijmë dot, po të paktën të bëjmë vetëm njerin kanal, — thirri ai.

Ata që kishin vajtur në anën tjetër të digës, u mblodhën aty. Disa minuta më pas puna ish vënë në vijë. Të gjithë i jepnin kurajo njeri-tjetrit e të gjithë punonin me nxit. Djersët bashkoheshin me pikat e shiut, që binte pa pushim, po askush s'ua vinte veshin atyre. Vetëm të shpëtohej rezervuari.

Në atë çast vetëm për këtë mendonin të gjithë. Ndoshta më tepër nga të tjerët për këtë mendonte, Skënderi.

...Tërë verën kish punuar ai në këtë rezervuar. Që sa filluan punimet e deri në fund ai s'u nda prej tij. Atje punonte, atje e kish mendjen, për atë bisedonte. Diga rritej e bashkë me të rritej shpirtërisht edhe Skënderi. Sa më tepër lartësohej ajo,



aq më shumë hov merrnin gëzimi e shpresat e tij.

Kur mësoi se do të bëhej një rezervuar i madh, që do të vadiste pesëdhjetë hektarë tokë, ai u gëzua si gjithë kooperativistët e tjerë. Po, kur i thanë që e caktonin si përgjegjës për traktoristët e punëtorët që do të bënin digën, ai e ndjeu veten krenar e të lumtur: veprën që do t'ja shtonte prodhimet kooperativës, ja kishin besuar atij!

Atë natë s'e kish zënë gjumi fare. Nga gëzimi? Nga shqetësimi?! Nga shpresat për të ardhmen, që gëlonin në fantazinë e tij të ndezur? Ndoshta nga të gjitha bashkë. Truri i tij kish aq shumë punë atë natë, sa që nuk ja kish ngenë gjumit. Dhe gjumi, sikur ta dinte, nuk u mundua aspak, s'vajtj fare tek djali i ri asaj nate. Ai i përfytyronte buldozerët e fuqishëm duke shtyrë dheun në përrua, punëtorët duke sjellë gurë a duke bërë ndonjë punë tjetër, digën duke u rritur e rritur. Përfytyrimi shkante më tej: ja një liqen i vërtetë me ujë të kulluar e të bollshëm. Prej tij delnin dy kanale që e merrnin në mes fshatin e tij të bukur. Uji gurgullonte e rridhte me gëzim, duke u shpërndarë në vijat e shumta si gjaku në dejet e një trupi të gjallë. Gjaku vete e vjen e trupi shëndoshet e gjallërohet. Tamam kështu ndodh edhe me ujin. Ai shpërndahet nëpër arat e mbjella dhe misrat e panxhari, me fletë në ngjyrë të gjelbër të errët, plot freski, duken sikur i krekosen diellit përvëlues, prej të cilit s'duan t'ja dinë më.

Ky përfytyrim e mbushte me gëzim zemrën e djalit fshatar. Po mos vallë ëndërronte si shumë? Mos vallë i shtrinte këmbët më tepër nga jorgani? E ku kish bërë ndonjëherë një punë të tillë? Bile

edhe kur kish parë një rezervuar, ai qe mahnitur e kish thënë: «Ama punë, ë!»

Dhe atë natë që kish ndenjtur pa gjumë nga gëzimi e shqetësimi ai kish menduar se për të qe e vështirë, shumë e vështirë të drejtonte një punë të tillë. I pat thënë të nesërmen kryetarit:

— Ore shoku kryetar, ku ja di anën kësaj alamet pune unë?

— U trembe? — kish qeshur kryetari. — Djalë i ri ti dhe të kesh frikë?

— Jo, more, po... është koskë e madhe kjo për mua.

— Edhe dhëmbin të fortë e ke! — ja priti kryetari.

Djali mendohej. Kryetari kish shtuar me seriozitet:

— Për këtë punë do të vijë një gjeometër. Ai nuk do të rrijë gjithnjë këtu. Ti do të kujdesesh që puna të mos reshtet, për të tjerat do të të udhëzojë ai.

«Kështu po», tha me vete Skënderi.

Përsëri nuk mund të thoshe se qe punë e lehtë: s'i thoshin shaka, një punë të madhe si kjo, që në fshat askush s'ja dinte radhën. Pastaj ata traktoristët. Janë shejtanë ata! Sidoqoftë... djali i ri qe i vendosur dhe do t'ja arrinte qëllimit.

Puna kish filluar menjëherë. Gjeometri, një djalë i gjatë, paskej qenë i urtë e i thjeshtë. Edhe pesë traktoristët vërtet ishin shejtanët vetë, por qena të punës, ama! Gdhihej e ngrysej Skënderi atje, te diga. Punonte, udhëzonte, mësonte edhe vetë. Kjo punë e madhe nuk reshti asnjë ditë. Dhe kjo sepse ai merrte masa për të siguruar me kohë çdo gjë që nevojitej.



Djali ja kish marrë radhën punës dhe punëtorët e quanin me shaka «shoku përgjegjës» ose «shoku gjeometër i dytë». Atë e brente merakun se mos zinte ndonjë shi i rrëmbyer para se ta mbaronin. Po edhe kjo kaloi. Diga u mbarua. Nga brenda u shtrua me gurë, nga jashtë u mbuall me bar.

Kur u mbarua fare, kur pa se si zuri të formohej një si liqen i vogël, Skënderit i dukej vetja sikur ish bërë me krahë...

Këto mendonte në ato çaste kur diga ish në rrezik të shembej. Kanali u hap e po shtrohej me gurë, po atij s'i flinte mendja. A do ta merrete dot gjithë ujin e tepërt kanali që kishin bërë? Dhe shiu s'kish të pushuar.

Ai shikonte herë pas here me shqetësim. Tani aty ish edhe kryetari, brigadierët, sekretari i organizatës së partisë, kishin lajmëruar lokalitetin e rrethin dhe prisnin të vinin njerëz edhe që anej. Po ai s'qetësohej dot. I dukej sikur ish i ngarkuar me një barrë të rëndë, sikur ai kish përgjegjësi më tepër nga të gjithë. Apo i vinte keq më tepër nga të gjithë, sepse ai pat jetuar për një kohë të gjatë me digën dhe se për të qe puna më e madhe që kish bërë në jetë?

Ai s'kish kohë të mendonte të tilla gjëra. Në ato çaste ndoshta ish gati të hidhej në rezervuar, po të qe se kjo e shpëtonte atë. Edhe t'i vinte gjoksin ish gati!

Kur pa ujin e turbullt, pothuaj të fjetur, tha me vete:

«Pse nuk provuam njëherë ta shpojme rërën, që ka zënë tubin?»

Ky mendim i rastit e bëri për vete. E tërhoqi

mënjane kryetarin dhe ja tha. Kryetari tundi kokën.

— Mendimi është i mirë. po si ta shpojme?

— Do të hyj unë! Më lidhni me litar.

Kryetari e shikoi me habi.

— Kjo s'bëhet, — tha.

— Unë kam qenë polombar. e di ti, apo jo?

— Kjo s'bëhet, të thashë njëherë! — tha kryetari rrerë.

Skënderit i vinte inat që kryetari s'i besonte. Shqetësimi i tij po arrinte kulmin.

Sekretari e vuri re dhe iu afrua. Skënderi i tha edhe atij, po edhe ai s'pranoi. Aty u mbloodhën edhe ca të tierë.

— Po ndonjë rrugë tjetër s'ka? — pyeti njëri:  
— Sikur të merrnim një hu të gjatë?

— Po s'ke që nga e shpon me të, — shtoi kryetari shpresë-humbur.

— Prisni! — tha befas një nga fshatarët. — Sikur të provoimë kështu: govatën e madhe të furrës ta bëjmë si varkë. Të marrim një gjëmb plehu e bishtin e tij ta zgjatim me hunj të mbërthyer njeri pas tjetrit.

— Mendim shumë i mirë! — tha Skënderi.

— Kështu po, kjo mund të bëhet, — tha kryetari.

Sekretari i shikoi me përgjërime dhe tundi kokën në shenjë pohimi. Sano dëgjuan këto fjalë, dy diem vranuan në furrë dhe e suallën govatën e madhe të bukëve. Ca të tierë suallën një gjëmb plehu dhe e zgjatën bishtin e tij duke mbërthyer hunj njëri pas tjetrit. Govatën -varkë e lëshuan në ujë.

Në të kërceu i pari Skënderi. Govata u lëkund



sikur do të përmysej, po ai s'desh t'ja dinte. Ajo shkau më tej.

— Duhet edhe një tjetër, — tha dikush, — se nuk do të qëndrojë ajo djall govatë, kur të mundohet për të shpuar me gjëmb.

Skënderi pohoi me kokë. Ai e afroi varkën e çuditshme te diga dhe ja dha dorën sekretarit që i qe afruar. Edhe ky kërceu brenda. Të dy shkuan deri atje ku me sy matnin drejtimin e tubit të shkarkimit. Pastaj muarrën gjëmbin. Skënderi e futi në ujë dhe u mundua një copëhere të gjente tubin. Varka lëkundej e shkiste më tej. Gjëmbi, me atë stërbisht, ish shumë i pavolitshëm. Mundimi qe i madh.

Nga bregu të gjithë po i ndiqnin me sy.

— Më djathtas! Më këtej! — thërrisnin shpesh që andej.

Skënderi s'dëgjonte asgjë. Ishin minutat e fundit. Edhe pak, ndoshta jo më tepër se disa minuta, dhe ose shpëtohej ose gremisej ajo vepër aq e madhe. Një pjesë e fshatit dhe një pjesë e fushës përmyteshin. Diga, krenaria e punës kooperativiste, do të shembej. Atij i dukej sikur do t'i shkëputej zemra prej trupit, sikur, pasi të ndodhte një gjë e tillë, jeta për të s'do të kish fare kuptim, sikur... Jo, s'do të bëhej kjo!

Dhe ai nxitonte e përpiqej me të gjitha fuqitë. Sekretari mbante drejtimin e varkës e me një dorë edhe e ndihmonte. Pas pak ai tha:

— Skënder, ma jep njëherë mua!

Skënderi e shikoi me përdëllim. Sekretari qe trupvogël, as që kish notuar e vozitur kurrë me varkë e, megjithatë, s'desh t'ja dinte fare. Kish ardhur me të në mes të këtij pellgu, që po u mbu-

rrej t'i përpinte, dhe kërkonte të ndihmonte. Kjo i dha guxim atij.

— S'është nevoja, — tha, — unë s'iam lodhur.

Vërtet s'qe lodhur? Ai kish punuar shumë në baltë e në shi e me vrull. Po a mund ta shkonte ndërmend lodhjen në ato çaste? Jo, kurrë!

Si e pa se s'pranonte t'ja linte këtë punë atij, sekretari shtoi:

— Dëgjo, Skënder. Po sikur ta rrëshqasësh gjëmbin pas kalldrëmit?

Skënderi e pëlqeu këtë mendim dhe sakaq e nxori gjëmbin prej ujit.

— Hej, të rrijë njëri në drejtim të tubit! — thirri ai.

Dikush e plotësoi në çast këtë kërkesë. Skënderi e drejtoi aty gjëmbin dhe, duke e shtyrë govatën më tej, e la të rrëshqiste poshtë e më poshtë në pjerrësinë e murit të digës. Pas nja dy provash, gjëmbi nuk gërvishi më; ai kish zënë në vend të butë. Djali e shtrëngoi fort. Sekretari që i ndiqte me vëmendje lëvizjet e tij, u mundua ta ndalte varkën. Skënderi e shtyu gjëmbin dhe ai u fut më thellë.

— E gjetëm tubin! — thirri djali.

I gëzuar ai i mëshoi fort e më fort gjëmbit. Në këtë punë e ndihmoi edhe sekretari. Pastaj e tërhoqën me kujdes nga prapa.

— O burrani, se doli ca ujë! — thirri një që nga diga.

Ata të dy, Skënderi e sekretari, e shpuan dhe e tërhoqën edhe disa herë gjëmbin me bishtin e stërmadh. Dhe gjithnjë që nga diga vinin zëra që tregonin se po delte gjithnjë e më tepër ujë prej tubit të shkarkimit.



— Tani mjafton, — tha sekretari. Sa e gjeti rrugën, uji pa e gërryen vetë rërën.

— U shpua! U shpua! — thërritën fshatarët.  
— Hajdeni tani!

Lundërtarët e afruan govatën deri te diga dhe kërcyen njeri pas tjetrit, pasi ua zgjatën shokëve gjëmbin e pavolitshëm që i pengonte shumë.

Kur u ngjitën tek të tjerët, psherëtinë të lehtësuar. Skënderi fshiu nga fytyra djersën e përzier me pika shiu dhe zemra i gufante nga gëzimi. Prej tubit të shkarkimit delte me presion një sasi e madhe uji. I turbullt e i shkumëzuar, ai nxitonte tatëpjetë, sikur të kish frikë nga njerëzit që e ndiqnin me sy rrugën e tij.

4394

REVOLUTERA E SHETIT  
1950

### PASQYRA E LËNDËS

Dritat nuk u shuan .....	3
Në udhëtim .....	17
Dashuria për tokën .....	29
Mbeturinat e fundit .....	37
Gjahu .....	49
«Çilimiu» .....	62
«Fshatarja» .....	87
Ditari i një partizaneje .....	101
Një detyrë e zakonshme .....	117
Mbarimi i Frosinës .....	132
Rezervuari .....	141